

LËKUNDJET QË SOLLI

SHEKULLI 3

PËRMBAJTJA

1. Thuhet se Islami është në përshtatje me mendjen dhe logjikën. Mirëpo Islami mbështetet mbi dogmën dhe, për pasojë, kërkon nënshtrim. A mund ta shpjegoni?
2. A ka ndryshim mes dashurisë së profetit tonë ndaj bashkësisë së vet dhe dashurisë së profetëve të tjerë ndaj bashkësive të veta? Veçanërisht, a ka dallime në dashurinë e tij ndaj individëve të bashkësisë së vet? A mund ta sqaroni?
3. Si mund t'uua edukojmë njerëzve tanë shprehinë e të lexuarit?
4. Thuhet se feja është një gjykim i propozuar nga detyrimi për të maskuar çështjet që njerëzit nuk mund t'i shpjegojnë. Përparimi i qytetërimit a e zhduk nevojën përfenë?
5. Si ka ndodhur kalimi i njerëzve në Amerikë?
6. Në fund të kaptinës Lukman, koha e të rënët shi dhe gjendja e fëmijës në barkun e nënës konsiderohen nga pesë të fshehtat. Si e shpjegoni?
7. Si duhet të jetë kuptimi ynë përvellazërinë? A mund të bëni një vlerësim me gjendjen ku ndodhemi?
8. Ç'hotë feja në lidhje me pyetjen e më të madhit, udhëzimit të të cilit i besojmë e të cilin e dëgjojmë, për të gjitha çështjet tona? A duhet ta pyesim atë përveshjen, mbathjen e gjer përpajisjet që marrim përshtëpitë tona?
9. A bëhet fjalë përvashim niveli mes emrave dhe atributeve të Zotit? A mund ta shpjegoni?
10. Cilët janë profetët e Vendosmërisë së Epërmë dhe pse u është dhënë vetëm atyre ky emër?
11. A mund të na tregoni se si duhet t'i mbrojmë besimtarët përballë veprimit shkatërrues të frontit të mohimit?
12. A po na tregoni përpjekjet dhe zellin e Profetit dhe myslimanëve të parë përshtetimin e besimit të të tjerëve?
13. Si mund të mbrohem i nga rreziqet që vijnë prej pasioneve të jetës e të rinisë?
14. Cila është pozita jonë përballë intrigave të kohës së mbrame dhe si mund të mbrohem i prej tyre?
15. Në lidhje me profesionin tonë, kemi patur një ideal që e kemi dashur shumë. Hidhërimi i humbjes së tij na ndikon në aspektin tonë shoqëror. Si mund t'i bëhem pengesë kësaj dukurie?
16. Shumë mëkate të bëra, megjithëse kanë kaluar vite, nuk na hiqen aspak nga mendja, për më tepër, bëhen nxitës për të njëjtat mëkate. Sot rrugët janë pushtuar prej pamjesh që të kujtojnë kësi lloj mëkatesh. Nuk dimë se ç'duhet bërë. Vetëm lutemi të biem dëshmorë, duke gjetur, kështu, rrugën e pastrimit prej mëkateve.
17. Ç'na këshilloni për t'iu ridrejtar idealit duke e ndaluar lëshimin e mëtejshëm të tensionimit tonë metafizik?
18. Thuhet se shokët e Profetit, fëmijët dhe gratë e tyre, kur kishin për të qarë përdëshmorët e vet, më parë qanin përfi Hz. Hamzain. A mund të na e thoni shkakun?
19. A mund të na jepni njohuri të hollësishme mbi Gurin e Zi?

20. A thuhet "Bismil'lah..." kur bëhet lutje? Si duhet të bëhet lutja?
21. Si duhet vlerësuar këshilla e Profetit për t'i rrahu gratë?
22. Në ditët tona është i përhapur shpjegimi i Islamit me çështje përkatëse të shkencës dhe teknikës. Si e shihni këtë?
23. Pse Kurani bën fjalë për njerëz si Ebu Lehebi? A mund ta sqaroni urtësinë e kësaj? Si përshtatet kjo me stilin e Kuranit?
24. Tema e haremit te osmanët është bërë një nga temat më të kritikuara. A mund të na ndriçoni rrëth kësaj çështjeje?
25. A është i përshtatshëm Islami për t'u dhënë zgjidhje të gjitha çështjeve?
26. Ç'është xhihadi? Flitet për xhihadin e madh e të vogël. A mund t'i përkufizoni dhe shpjegoni?

1. Thuhet se Islami është në përshtatje me mendjen dhe logjikën. Mirëpo Islami mbështetet mbi dogmën dhe, për pasojë, kërkon përunjësi. A mund ta shpjegoni?

Po, ashtu është. Islami edhe është në përshtatje me mendjen dhe logjikën, edhe kërkon domosdoshmërisht përunjësi. Sepse mendja dhe logjika me përunjësinë nuk janë të kundërtë. Diçka mund të jetë logjike e mund të kërkojë edhe përunjësi. Përballë një specifike që kërkon një gjë të tillë, askush nuk mund të arrijë në përfundimin se "kjo s'është logjike." Edhe logjika nuk e pranon një mendim të tillë. Dhe tani le të përpinqemi ta shpjegojmë këtë çështje përsëri brenda kornizës së mendjes dhe logjikës.

Së pari, Islami i ka trajtuar çështjet, besimi i të cilave është i domosdoshëm, me librin ku lexohet gjithësia dhe na i ka shpjeguar mendërisht e logjikisht. Pasi na e ka provuar në këtë mënyrë madhështinë dhe kujdestarinë hyjnore¹ të Providencës Hyjnore, është trajtuar profetësia në cilësinë e domosdoshmërisë reciproke, domethënë të nevojës së paevitueshme për njëri-tjetrin dhe kjo domosdoshmëri është mbështetur me argumente mjaft bindëse. Për të lajmëruar këtë madhështi, ndihet nevoja e profetëve, kurse të gjitha argumentet që sjellin si konkluzion pushtetin e Tij, janë mjaft mendore e logjike.

Pas vdekjes, njerëzit duhet të ringjallen e të fitojnë një jetë të amshuar në mënyrë, që ndjenja e përjetësisë që u është dhënë, të mos jetë ose të mos mbetet diçka e kotë. Sipas asaj që Providencia Hyjnore është e pastër nga kotësirat, një jetë të tillë do t'u dhurohet njerëzve. Gjithashtu, Ai që e krijoi qenien për herë të parë, do të bëjë edhe krijimin e dytë.

Kurani është fjala e Zotit. Sikur të gjithë njerëzit dhe xhindet të bëhen bashkë, nuk mund të sjellin diçka të ngjashme, qoftë edhe me një ajetin e vetëm të tij. Meqë ai është fjala e Allahut (xh.xh.), atëherë edhe Teurati, Ungjilli, Zeburi si dhe gjithë shkrimet e kaluar nën vërtetimin e Tij, me identitetin e tyre original, janë fjala e Allahut (xh.xh.)...

¹ Në origjinal: Rububijet

Këto çështje që i kemi trajtuar imtësish t dhe gjërisht një e nga një në vendet përkatëse dhe me tematikën përkatëse, nuk do t'i shtjellojmë këtu. I preka vetëm për të dhënë një mendim. Tani, pasi të gjitha çështjet përkatëse të dogmës të cilat duhen besuar, të jenë provuar me argumente të tillë mendore e logjike, vjen një cak pas të cilit njeriu nuk mund të ecë vetëm me argumente. Kuptimet mbi të vërtetën, që perceptoi me ndërgjegje dhe që ndjeu me zemër, janë aq të qëndrueshme, saqë argumentet aty mbeten krejt të zbehta. Kjo është një çështje niveli (shpirtëror) dhe është mjaft normale. Puna shkon gjer atje sa personalitetë të mëdhenj, si Imami Rabbani, pasi kanë plotësuar *sejir minallah*, kanë pohuar se përsëri njeriu do të ndjejë nevojë për argumente, në një kohë kur ngjarja e sipërpermendur është një situatë e posaçme për njerëzit që kanë plotësuar miraxhin në atë nivel dhe s'kanë të bëjnë me shumicën tjetër të njerëzve.

Çdo punë dhe veprimtari e Providencës Hyjnore është e mbështetur në mendjen dhe logjikën. Si të mos jetë, kur Ai është i Ditur dhe Zotëruar, nuk bën gjëra të kota.. Me anë të ligjeve të fizikës, kimisë, astronomisë dhe astrofizikës ne vërtet arrijmë një pjesë parimesh të qëndrueshme dhe shohim se para kësaj veprimtarie, bëmat e njerëzve më të aftë mbeten shumë të zbehta. Kurse në çdo punë të Allahut (xh.xh.) ka një urtësi. Dhe kjo urtësi, mendore dhe logjike, zhvillohet plotësisht në këtë vijë.

Ja pra, ajetet e krijimit të botës së ndryshueshme, që i kemi sjellë me argumente të tillë objektive e subjektive, na shtrëngojnë t'i besojmë Providencës Hyjnore me një besim që i shkon për shtat madhështisë dhe lartësisë së Tij. Fjala pra, është për mendje e logjikë tërësisht përunjësie. Meqë iu përunjëm dhe i përunjemi Atij, atëherë duhet edhe të bëjmë ato që thotë Ai. Natyrisht, këtu na dalin përpara çështje të adhurimit, të gjitha specifikat e namazit, agjërimit, zekatit dhe haxhit, të tillë që kanë të bëjnë me njeriun si rob të Zotit...

Nga një këndvështrim, plotësimi i këtyre është përunje. Por është gjithmonë e mundur që midis këtyre të ecim sérish me mendje dhe logjikë, si dhe t'i kushtëzojmë me një vlerësim për nga urtësia që përbajnjë.

Sigurisht që ka shumë urtësi në detyrimin e namazit në pesë kohë të caktuara pa lejuar kapërcimin e kohëve. Pa asnjë dyshim, nuk është i rastit një detajim i tillë i veprimeve të namazit. Urdhri i larjes së gjymtyrëve në abdes sigurisht që e ka një dobi. Sa rol të madh ka në ndërtimin e jetës shoqërore falja e namazit në bashkësi! Sa dobi ka marrë përsipër detyrimi i zekatit për ruajtjen e raportit të varfér-të pasur! Dobitë që i sjell shëndetit të njeriut agjërimi, janë pa numërim. Madje, mrekullia marramendëse e vendimeve përkatëse të Kodit Penal të Islamit dhe sa e sa urtësi të tjera që, po të shqyrtohen e analizohen sipas mendjes dhe logjikës, do të na çojnë sérish në të njëjtën pikë, në përunjësi.

1) Po e shqyrtojmë haxhin, sa për shembull. Le të themi se e kemi pranuar qysh në fillim detyrimin e haxhit, sepse Providencia Hyjnore thotë: ...*Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është detyrim...* (Ali Imran, 97) si dhe ia ka bërë të detyruar këtë çdo mysliman burrë apo grua që ka mundësi. Një vështrim i tillë është fillimi i përunjësisë. Në emër të përunjësisë, themi si urdhëron! dhe vrapojmë për në haxh. Pas kësaj, nisemi të shqyrtojmë premtimet që na janë dhënë nga haxhi brenda botës Islame. Haxhi është një kongres i Botës Islame ku pjesëmarrin njerëz të çdo niveli. Dhe ndodhen në fazën themelore, më të shkurtër e të garantuar, të sjelljes së myslimanëve në një trup të vetëm. Po ta vështronim çështjen nga këndvështrimi i drejtësisë shoqërore, mbledhja në një vend e njerëzve pa dallime të pasur-të varfér, të ditur-të paditur, me mendimin vetëm për të kryer detyrën e robit ndaj Zotit duke u trajtuar vetveti secili në të njëjtat kushte e në të njëtin nivel, do të na afronin më shumë me faktin se çfarë sistemi mbarënjerëzor është Islami; kjo do të na bëhej mbështetje për vendosmërinë tonë të besimit.

Po deshët, le të fillojmë të ndjekim rrugën e mendjes dhe logjikës, ta trajtojmë çështjen dhe, në përfundim, të arrijmë të vendosur në pikën e përunjësisë; po deshët, le ta ndjekim pra udhën e përunjësisë, t'i përdorim si mjete mendjen dhe logjikën e mandej, të arrijmë sërish në të njëjtën pikë. Këta faktorë nuk do të ndikonin te përfundimet.

Për pasojë, Islami, nga njëra anë, është mendor dhe logjik. Nga ana tjetër, baza e tij është përunjësia. Aty zë fill me mendjen dhe logjikën dhe mbaron me përunjësinë, dhe po aty, nisur nga përunjësia, mbërrin tek mendja dhe logjika, të cilat, nga ana e tyre, përsëri e kthejnë njeriun tek përunjësia. Në fund të fundit, nuk mund të janë ndryshe rregullsia dhe sistemi i Allahut (xh.xh.) që na ka vënë përparrë këtë gjithësi në formën e një libri...

2. A ka ndryshim mes dashurisë së profetit tonë ndaj bashkësisë së vet dhe dashurisë së profetëve të tjerë ndaj bashkësive të tyre? Veçanërisht, a ka dallime në dashurinë e tij ndaj individëve të bashkësisë së vet? A mund ta sqaroni?

Pyetja përmban disa nënçështje. Fillimisht, duke shënuar tërë profetët e tjerë, ndryshimi midis dashurisë dhe afërsisë së tyre ndaj bashkësive të veta, nga njëra anë, dhe dashurisë së Profetit tonë (s.a.s.), nga ana tjetër; pastaj kërkohen njohuri mbi afërsinë dhe dashurinë e ndryshme të treguar ndaj individëve të veçantë nga KryeProfeti i të dy Botëve.

Çdo profet e do bashkësinë e vet. Me këtë kuptohet herë dashuria vetë, herë koncepti i dhembshurisë. Të dyja këto ekzistojnë tek të gjithë profetët në nivelin më të lartë. Veçse, siç diskutohen ndryshimet në gradët e Profetëve, po ashtu këto ndryshime vihen re edhe në ndjenja e mendime. Mbështetur mbi këtë të vërtetë, dashuria dhe afërsia, që janë të pranishme tek të gjithë profetët, janë të pranishme në nivelin më të lartë tek Profeti ynë i nderuar, në mënyrë që, Providencia Hyjnore (xh.xh.), me synimin vetëm për të treguar këtë dashuri dhe afërsi tek Profeti, ia ka kushtuar atij emrat e vet duke e quajtur të Dërguarin e Vet Mbrojtës, Mëshirues. Ja, pra, para besimtarëve një monument i tillë dashurie dhe dhembshurie është Ai! Përsëri, tek Ai ka një dashuri dhe dhembshuri të tillë që, kur lindi, pati thënë njerëzit e mi, bashkësia² dhe, aty ku të gjithë profetët e të gjithë prijësit do të thonë vetë³, ai do të thotë njerëzit, njerëzit e mi!

Shihni ç'është kjo dashuri dhe dhembshuri: nga ajo majë ku pati arritur me anë të miraxhit dhe nga ajo pjesë përfitimi e lartë, e pamundësuar për askënd tjetër, që kthyer prapa për të gëlltitur vuajtjet dhe ankthet e kësaj bote, vetëm e vetëm për ta shpëtuar bashkësinë e tij, duke i kapur për dore njerëzit e tij, për t'u bërë të mundur edhe atyre shijimin e një udhëtimi të tillë.

E tija është një dhembshuri e tillë që, kur engjelli, i zemëruar në kulm ndaj atyre që e qëllojnë me gurë Profetin dhe e lënë me trupin tërë gjak, i thotë: "Më lejo t'u hedh këtë malin mbi kokë!" Ai i

² Në origjinal: Ummeti

³ Në origjinal: Nefsi, nefsi

përgjigjet: "Jo, nuk dua, po qe se gjer në kiamet qoftë edhe një nga barku i tyre do të futej në bashkësinë time..."

Ja, pra, në këtë kuptim, dashuria dhe dhembshuria e tij janë aq të larta, sa të mos krahasohen me asnjë profet tjetër. Jeta e tij historike është si një copë e qëndisur me qindra shembuj dashurie dhe dhembshurie. Kurse aspekti hyjnor i çështjes është diçka pamundësishë e konceptueshme prej nesh.

Këtu, pa kaluar në dallimin e dashurisë midis pjesëtarëve të bashkësisë së vet, të Profetit tonë, të flasim për një rregull të vlefshëm për të gjithë profetët. Çdo profet do midis bashkësisë së vet ata që janë më të lidhur mbas çështjes së tij profetike. Ky është një rregull i përgjithshëm nga i cili nuk përjashtohet as i Dërguari i Allahut, sepse qëllimi i ardhjes në botë i të gjithë profetëve, është identiteti i shpalljes dhe i përhapjes së ideve të profetësisë përkatëse. Ata nuk u lënë trashëgim pasardhësve as pasuri e as pozitë. I vetmi trashëgim janë feja e shpallur dhe bazat e saj, kështu që, së pari, sipas radhës, për profetin do të janë më të dashur ata persona që do t'i dalin për zot fesë së tij.

Zotëria i Gjithësisë, në një porosi të tij, urdhëron kuptimisht kështu: Po ju lë dy gjëra: Kur'anin, librin e Allahut, dhe familjen time⁴. Kjo zgjedhje nuk është vetëm kah afërsia e krushqisë. Në të ka një të fshehtë të hollë dhe i Dërguari i Allahut e nxjerr në pah familjen e tij mbi këtë të fshehtë. Sepse familja profetike është ajo që, në mënyrë të natyrshme, po i del për zot Librit të Allahut, të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe atyre çka solli ai. Është pikërisht kjo arsyja që, në periudhat e mëpasme, t'u dilje për zot këtyre, ishte njëloj si t'i dijle për zot fesë. Ja, pra, mbi bazën e kësaj urtësie ai e nxjerr më shumë në pah familjen e tij.

Nga ana tjetër, trashëgimtarët që përfaqësuan kauzën e të Dërguarit të Allahut dhe që i dolën për zot idesë së profetësisë, qenë persoalitete të tillë, si Hz. Ebu Bekri, Hz. Omer, Hz. Osman dhe Hz. Ali (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!). Këta janë trashëgimtarët e vërtetë të Profetit tonë.

Nisur nga kjo pikë, ata që i dolën zot në plan të parë kauzës profetike të Profetit tonë, janë Pasuesit e nderuar të tij⁵. Edhe më vonë, në periudha të ndryshme, kanë qenë të afërmit e rrjedhur nga ai brez i dlirojë ata që, duke e përfaqësuar Islamin në formën më të lartë, u kanë fryrë jetë ndjesive me teqet dhe qoshket.

Në çdo periudhë që të jetë, ata që i dalin për zot trashëgimit të vërtetë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), konsiderohen si më të afërtit e tij dhe njerëz të familjes së tij.

Kjo është arsyja që, njerëzit e një bashkësie, e cila në ditët tona u del për zot këtyre shërbimeve, konsiderohen trashëgimtarët e profetit. Dhe kjo është e drejtë, përderisa ata janë trashëgimtarë të kauzës profetike.

Po qe se çështja do të vështrohej nga ky pozicion, nuk do të ekzistonte ndonjë ndryshim midis Hz. Ebu Bekrit dhe një pasuesi, sepse të gjithë do të ishin trashëgimtarë të kauzës profetike. Mirëpo, në fakt, në virtytin personal specifik, sikur të bëhej një e gjithë bashkësia, s'do të barazohej dot me Hz. Ebu Bekrin (r.a.)!

Kjo do të thotë se, kush jetoi brenda shekullit dhe periudhës së Profetit ose në shekujt e mëvonshëm, i del për zot kauzës profetike në ato përmasa që t'i ketë dalë, do të jetë i denjë për dashurinë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), po në ato përmasa.

⁴ Në original: Ehl-i bejt (arab.)

⁵ Në original: As'habe (arab.) Shih në fund

Ashtu sikurse me të fshehtën “*Ve mā ala Rasuli il’le'l belâg*”, detyra që u takon profetëve është vetëm shpallja, po ashtu, në të njëjtën formë, atyre që do t'i vinin supet kësaj pune pas tij, do t'u përkiste vetëm detyra e shpalljes, njoftimit. Po ashtu, çka do të na përkiste neve në këtë moment, do të ishte që, duke lidhur duart pas tij me përulësi, të thoshin detyra jonë është vetëm njoftimi! Si pasojë e lidhjes pas Tij me pozicionin e një forme të tillë, mund ta pranojmë se jemi ndër më fatbardhët e kësaj bote.

Dhe tani, ju lutem të drejtoni vëmendjen tuaj në një aspekt tjetër të çështjes.

Gjendja e personave trashëgimtarë, të bërë të tillë, duke parë dritën profetike të Profetit tonë (s.a.s.) dhe duke u formuar në atmosferën e tij të përshtndritshme, është shumë e ndryshme nga e të tjerëve. Kjo është mjaft normale. Sepse ata e panë personalisht Profetin tonë (s.a.s.), përfituan nga dituria e tij, u njohën me të gjitha situatat që kaloi ai; me klimën e reshjeve rrëke të Revelacionit; freskinë drithëruese të Revelacionit e ndjenë gjer në palcë. Dhe u përgatitën nga ai mësues dhe mjeshtër i famshëm. E po qe kështu, edhe afërsia e ushqyer ndaj tyre nga ana e Profetit tonë (s.a.s.), si kujdesi i treguar për ta, duke i trajtuar të vyer, lavdërimi e dekorimi me shprehje të tilla si “kush i shan pasuesit e mi, s’është nga të mitë”; “pasuesit e mi janë si yjet në qiell”, - të gjitha këto janë forma më e mirë e sjelljes dhe e shprehjes, që i kanë hipe një përmendoreje mirësie si Ai. Mes njerëzimit ishin ata që e deshën Atë më shumë. Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) iu përgjigj kësaj dashurie: Ai i deshi ata të gjithë.

Veçanërisht me këto sjellje e veprime, Profeti u jepte mësim urtësie e metode atyre që do të vinin pas tij dhe do të udhëhiqnin bashkësitë.

Në çdo periudhë e në çdo epokë, duhen trajtuar me përparësi ata që qëndrojnë në plan të parë, që përpinqen e luftojnë, që s’duhen parapëlqyer të tjerët para tyre.

Ky është një borxh besnikërie. Edhe në këtë aspekt, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) qëndron mbi të gjithë njerëzit. Nuk mund të tregohet një tjetër njeri më besnik se ai.

Pasuesit që i kishin shkuar dhe e kishin pyetur “kë do më shumë”, kishin marrë përgjigjen: “Aishen”! “E pata fjalën për burrat”, - kishte vazhduar pasuesi. Dhe ai ishte përgjigjur: “Tim ate”!

Ma merr mendja, se s’është e nevojshme të shpjegoj këtu ndryshimin ndërmjet dashurisë dhe ngarkesës me detyrë. Ai zotëronte një zgjuarsi të paparë në përdorimin me vend të çdo dhuntie. E dinte shumë mirë se si t'i përdorte këto dhungi për çdokënd. E dinte në atë mënyrë, sa nga historia nuk njohim të jetë provuar e kundërtta. Njeriu që zgjidhte për një punë të caktuar, ishte njëri nga ata që, midis të tjerëve, pa diskutim, e përfaqësonte më mirë çështjen në fjalë.

Sic ishte Kryeprofeti i të dy Botëve një njeri me krijim të porositur, edhe personat që iu bënë pasues, në përmasat e tyre, ishin me krijim të porositur. Kjo ka këtë kuptim: Profeti ynë (s.a.s.) kishte ardhur në botë si profet qysh në lindje. Sepse, përfshirë edhe periudhën e fëmijërisë, gjithë sjelljet e tij janë cilësisht të tilla, që do të mbështesin periudhën e mëtejshme. Për shembull, në një kohë kur njeriu i injorancës shëtiste lakuriq, sic qe lindur prej nëne, përveç një rasti të vetëm, ai s’qe zbuluar mbi gju. Edhe në atë rast të vetëm, i pati ardhur engjëlli dhe i kishte tërhequr vërejtjen. Prandaj, edhe pa iu komunikuar ende detyra profetike, në rrëthinat e Mekës, kur bëhej fjalë për virtyt, nder e turp, emri i parë që u vinte ndërmend njerëzve, qe emri i tij. Ishte mishërimi i dëlirësise. Nuk kishte rënë kurrë në mëkat. Nuk kishte tjetër mbi të në mbajtjen e premtimit, në besnikëri, në drejtësi, në mbajtjen e fjalës dhe në të qenit i sigurt në amanet. Një emër tjetër i tij ka qenë Emin⁶. Jetoj një jetë krejt të pastër. E la

⁶ Emin (arab.) i qetë, i pafrikë, i besuar, i sigurt, i padyshtimtë

këtë botë duke qenë krejt i pastër. Sa kuptimplotë janë fjalët e fundit që i drejtoi miku më i afërt, Ebu Bekri, i ardhur nga Medina, me të dëgjuar për vdekjen e tij: "Edhe jetën të pastër e të ndritshme, edhe kufomën të pastër e të ndritshme i pate, o i Dërguar i Allahut"? Në të njëjtën kohë, këto fjalë karakterizonin, në një fjalë të vetme, jetën e të Dërguarit të Allahut nga fillimi në fund. Ai i pati hapur sytë në këtë botë me pafajësinë e një fëmije; me jetën e lartë që pati jetuar, ia pati arritur pafajësisë së një engjelli dhe, nga lartësia marramendëse ku qe ngjitur, pati fluturuar tutje.

Kjo është arsyja që, midis gjithë atyre shpifjeve që i bënë të Dërguarit të Allahut, politeistët e Mekës nuk mundën të fusnin qoftë edhe një fjalë të vetme qortuese për moralin e tij të kulluar, ndërsa vazhduan të bëjnë shpifje që nuk do t'i pranonte një njeri me mend në kokë; i thanë magjistar, i thanë poet, por askush nuk mundi ta akuzonte për gënjeshtar, për të lëkundshëm ose të ngashëm me këto. Në një aspekt, Providenca hyjnore (xh.xh.), moralin e tij të kulluar e përdori si shpullë për t'u mbyllur gojën politeistëve, për t'i detyruar të heshtin.

Ai kishte ardhur për të përfaqësuar një kauzë të madhe. Edhe ata që do të bëheshin bashkësia, pasuesit dhe shokët e tij, si njerëz, do t'i vinin supet të parët një kauze të tillë. Providenca hyjnore (xh.xh.), i krijoi posaçërisht, me cilësinë dhe përgatitjen për t'ia dalë mbanë kësaj pune. Po, ata ishin njerëz të posaçëm, të porositor.

Mendoni se kur Halid b. Velidi mori pjesë në luftën e Mu'te-s, s'kishte as dy muaj që ishte bëreë mysliman. Ishte futur në luftë si luftëtar i thjeshtë. Atë ditë emri i tij nuk ndodhej midis emrave të komandantëve. Ishin përmendur Zejd b. Harithe, Xhafer b. Ebu Talib dhe Abdullah b. Revah dhe ishte thënë: 'Po qe se edhe atij i ndodh gjë, flamurin ta marrë një shpatë ndër shpatat e Allahut'!

Në Mu'te, numri i myslimanëve ishte tre mijë, kurse armata bizantine ishte 66 herë më e madhe, domethënë dyqind mijë vetë. Të kthehem i në Medine! Veçse Zejdi iu ngul para atyre. Ashtu siç nuk ishte kthyer prapa gjatë gjithë jetës, edhe këtu s'do të kthehej. Ajo ishte një bindje që kishte marrë formë. Kryeprofeti i të Dy Botëve i kishte thënë që të martohej me Ummi Ejmenin, një grua në moshë të s'ëmës dhe ai kishte pranuar pa u lëkundur. Në Taif iu bë mburojë Profetit para gurëve që e qëllonin dhe trupi i qe larë në gjak. Atë ditë ishte komandanti i një ushtrie. Edhe nëse çështja ndryshonte në përbajtje, thelbi i saj, jo. Ai vazhdonte të tregonte bindje. Bulëroi si luanët. Sado i madh të ishte numri i armiqve, nuk do të kthehej pas, sepse kishin marrë urdhër nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.)!

U luftua për gjashtë ditë rresht. Në ditën e gjashtë kishin rënë dëshmorë të gjithë komandantët. Kur flamuri do të binte në tokë, e kishte kapur një ushtar që kishte filluar të kërkonte të zotin kujt i takonte dhe ia kishte zgjatur Halidit. Por Halidi s'kishte dashur ta merrte, duke i thënë: "Ti je bëreë mysliman para meje, je më i denjë se sa unë"? Pastaj, pas këmbënguljeve të ushtarit, e kishte marrë. (Të gjitha këto ngjarje i Dërguari i Allahut ua tregonte pasuesve ne Medine. Po, qante me ngashërim dhe ua tregonte.)

Halid b. Velidi pat bëreë atë ditë një punë të madhe. Edhe pse disa thonë që Mu'te nuk është fitore, ajo është fitore, është legjendë. Dhe këtë fitore e pat mundësuar Providenca Hyjnore (xh.xh.) me dorën e Halidit (r.a.).

Atë natë e pati ndarë ushtrinë në 7-8 pjesë. I pati ndërruar krahët në të djathët në të majtë, të djathët në të majtë. Paravijën e kishte nxjerr prapa, prapavijën-përpara. Disa grupe i caktoi me detyrë të veçantë. Do të shkonin fshehurazi drejt Medinës dhe, të nesëermen, kur të ktheheshin, duke u rënë dajreve e trumpetave, të jepnin përshtypjen e një force të re të ardhur nga Medina.

Ajo çka thotë ai, zbatohet. Të nesërmen, armiku habitet me sa po ndodhët. Para seçilit armik kishte dalë një fytyrë e re e panjohur. Sidomos të ardhurit nga ana e Medinës me zhurma e klithje, i demoralizojnë krejt armiqtë, që dorëzohen psikologjikisht.

Halidi i hipën kalit dhe sulmon në qendër të armikut. Syri s'i sheh më asgjë. Vini re: ka vetëm dy muaj që është bërë mysliman; as diti gjë, as mësoi gjë dhe, në një kohë kaq të shkurtër, arriti këtë lartësim!...

Strategjia e tij zbatohet plotësisht; njerëzit që kishte vendosur pas, vijnë pa pushim, valë-valë. Armiku ishte frikësuar aq shumë, saqë tërheqjen e tij e pandeh për një taktkë lufte dhe, për pasojë, nuk merr guximin të vihet në ndjekje.

Unë mora si shembull Halidin. Ju shtojini këtij gjithë kapacitet e mëdha, kalifët që pas profetit do të qeverisnin botën, të ngjashmit me Amr b. As-in⁷ të pranuar nga të gjithë si gjeni politik, komandantët ushtarakë ose ata që vraponin nga një shesh lufte në tjetrin, si ushtarë të gatshëm për të dhënë jetën; asketët e zhytur në devocion natën e luftëtarë të nesërmen, dhe mendoni: edhe ata qenë një nga një njerëz të porositur ashtu si edhe profeti, dhe do të pranonin konkretisht e do të shpallnin se qe e pamundur që dikush nga pasardhësit t'u ngjante atyre.

Ja pra, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), këtë bashkësinë e tij, me të cilën erdhi nga bota tjeter këtu, dorë për dorë e krah për krahu, e trajtoi mbi të tjerët dhe i pati si trashëgimtarë të vërtetë.

Po ajo përmendore besnikërie nuk e kishte harruar pjesën tjeter të bashkësisë së tij. Ai njeri që nuk harronte as gurët e dheut që i kishin hapur gjirin, si do të mund të harronte bashkësinë, e cila edhe shekuj më vonë do ta kishte për nder të bëhej bashkësia e tij? Çdo të shtunë vizitonte Kuba-n, sepse ai ishte vendi që i kishte bërë konak për herë të parë. Kur ishte ndarë nga Meka, e para kishte qenë Kuba që i hapi zemrën e i tha: "Qëndro këtu, o i Dërguar i Allahut"! Edhe ai, duke shkuar çdo javë, paguante borxhin e asaj besnikërie. Edhe Uhudin e vizitonte në kohët që ishin bërë traditë dhe derdhët lotë për miqtë e tij, që preheshin në varrezat e atjeshme. Në vizitën e fundit kishte thënë: "Përshëndetja qoftë mbi vëllezërit e mi"! Pasuesit i kishin thënë: "A s'jemi ne vëllezërit e tu"? Kurse ai kishte urdhëruar: "Ata ende s'kanë ardhur! Ja, pra, ju jeni ata që ai i quajti atëherë vëllezërit e mi! Pasuesit qenë shokët e tij. Bashkë me të patën jetuar. Ata që erdhën më pas, që iu bindën pa e parë dhe që i vunë gjoksin çdo lloj vuajtjeje e shqetësimi, duke u përpjekur natë e ditë në interes të kauzës e që treguan në këtë mënyrë se qenë trashëgimtarë të kauzës profetike, vëllezërit e tij qenë. Sepse i Dërguari i Allahut, duke u dërguar përshëndetje, i kishte quajtur "vëllezërit e mi". Ndoshta mes këtyre shprehjeve si diçka të posaçme kishte një kompliment të veçantë për anëtarët e bashkësisë së tij, që e pranojnë njeri-tjetrin për vëlla dhe e bëjnë simbol sakrifikimin për vëllanë. Duke bërë kompliment, duke treguar dinjitetin e tyre, duhet të sillen e të veprojnë brenda një vetëdijeje detyre që do t'u kishte hije. Kurse tablloja e kundërt e ndrydh çdo rast atë shpirt të madh.

Detyrën përkatëse që u shtroi koha, ata e çuan në vend me bindjen karakteristike për ta; kurse tanë, ne na bie për ta çuar në vend të njëjtën detyrë me të njëjtën vetëdije...

⁷ Amr. B As: shih në artikujt paraardhës

3. Si mund t'ua edukojmë njerëzve tanë shprehinë e të lexuarit?

Meqë e thotë çdokush e meqë edhe pér dëgjuesit éshtë bërë shprehi e janë familjarizuar me të, éshtë një fjalë që tanimë nuk mund të ndikojë në ndërgjegje po aq sa kuptimi i saj e që, më së fundi, éshtë bërë klasike: “Urdhri i parë i Islamit: Lexo”!

Lexo! Lexo të vërtetën njerëzore⁸, librin e gjithësisë dhe Kuranin, interpretuesin e tyre! Hulumto pér jetën e të Dërguarit të Allahut! Bëj sinteza gjithnjë të reja dhe rilexoji përfundimet e arritura! Bëj kërkime rrëth të gjitha shfaqjeve që argumentojnë Njësinë e Zotit⁹; ftillo çdo çast një hap më tej në etapat e aftësimit tënd, me etjen tënde të pashuar thuaj: *Hel min mezid*, a s'ka më? Dhe lexo pa pushim! Një njeri që përpinqet të lexojë brenda shprehjeve të ndritshme të të Dërguarit të Allahut, qoftë librin e gjithësisë, qoftë tërësinë e veçorive të njeriut, që janë si një katalog i atij libri, thellohet kësosoj në botën e tij ndjesore, saqë edhe oqeanet mbeten të cekët përballë asaj thellësie. E pikërisht aty, në atë thellësi, perceptohet, duke u kuptuar qartë njëherë e mirë¹⁰ e vërteta. S'të njo'hëm dot me të vërtetë, o i Famshëm! Dhe arrihet në etapën njo'hëse të njo'hjes së mangët.

Sipas opinionit tim modest, bota jonë ndodhet e larguar nga ky urdhër i Islamit. Duke thënë bota jonë, të mos pandehet se me këtë po shënoj atdheun tonë. Unë pranoj si bota jonë, në horizontin e së cilës hapi krahët shpirti Muhamedan, Egjiptin, Sudanin, Marokun, Tunizinë, Algjerinë, gjithë vendet e Magrebit, pastaj gjithë vendet e Lindjes së Mesme se Buharaja, Samarkandi, Tashkenti, bota jonë, pra, éshtë gjithë ajo botë e madhe që përfshin brenda saj sa e sa vende të tjera si këto. Ja, pra, njeriu ynë, kjo dituri e hapur ndaj kulturës në botën tonë që, në krahasim me njerëzit e botës tjetër, ngriti froni në majë e që i bëri të tjerët të mahniteshin pas saj, éshtë një bashkësi njerëzore e bekuar.

Këto vende, të cilat në fillim u pushtuan nga kryqëzatat, ranë më vonë nën sulmin dhe pushtimin e mendimeve imperialiste. Ndoshta një kohë më vonë edhe ato i shpartalluam e i përzumë nga vendi ynë, vetëm se (ata) përgatitën njerëzit tanë karakterdobët, që i patën vjedhur, pér sa kohë patën qenë këtu dhe na i hodhën mes nesh, si nga një damaz mendimi më vete. Këta, pastaj, përgatitën breza që do të mund të vazhdonin veprimtarinë përçarëse të armiqve tanë të përjetshëm. Dhe, duke bërë këtë, u sollën në mënyrë aq të vetëdijshme, saqë veprimtaria pasuese ndiqte paraardhësen si domosdoshmëri e saj; kështu, hallkat e zinxhirit dhe pasojat shkatërruese ndiqnin njëra-tjetrën. Ndërkaq, u krijua, doli në shesh një botëkuptim tipik i tyre, me të cilin dolën fitues ndaj iniciativave individuale e të fragmentuara të frontit tonë. Kjo shkoi gjer aty sa sot, më së fundi, meqë nuk mund t'i eliminojmë totalisht këta, duket shumë e vështirë, madje e pamundur, që të kthehem i në botën tonë shpirtërore, të bëhem i një me të. Njëra nga goditjet më të rënda që na dhanë, qe ajo që, me rrugë të caktuara, na larguan nga e kaluara jonë dhe na bënë si të huaj përballë rezultateve të arritura ndër shekuj. Por puna s'mbeti me kaq; duke lëshuar kolonën e pestë (të tyre), i mbushën ndjesitë e të rinjve me subjekte epshore dhe i katandisën që të mos mendojnë tjetër gjë. Brezat u zunë në lakun e mendimit bohem dhe u mbytën në vorbullën ku ranë. Dhe askush nuk mundi të tregonte guximin pér të dalë e pér t'i thënë ndal kësaj fatkeqësie ose, ata që në pozicionin e miratimit të asaj çka bënte shumica, e ndjenin veten të kënaqur, pér pasojë, nuk thanë gjë.

⁸ Në origjinal: Mahijet-i insanije

⁹ Në origjinal: Vahdanijet

¹⁰ Në origjinal: Ajneljakin

Siç i pati soditur në miraxhin¹¹ e tij Profeti ynë (s.a.s.) disa mëkatarë se si e vuanin ndëshkimin, edhe ne, krejt ashtu e shihnim ato ditë shoqërinë brenda një tabloje të tillë. Breza të zhytur në pije, kumar, adulter, ryshfet, akaparim, faiz e në ç'gjëra të tjera, me mendime të zeza si zift brenda boshllëkut shpirtëror, vërtiteshin mes tonë me një tjetër personalitet, sikur të ishin një qenie tjetër. Këtyre brezave të mbajtur pezull me botën shpirtërore, ndërsa çdo gjë ishte bërë gati për t'ua bërë fli anarkisë dhe terrorist, turmat që lëkundeshin majtas-djathtas si lavjerrës, këtyre brezave pra, të zhytur mes dëfrimit, u bënин thirrje për të qenë të virtytshëm krejt si ai që i thërret "kujdes, mos u lag"! dikujt të hedhur në det me duar e këmbë lidhur. Po, po, këshillat ndaj brezit të atëhershëm, ji i moralshëm, mos krijo anarki, duaje vatanin, mbroje popullin, mbaje të shenjtë flamurin, edhe nëse në përbajtje ndryshonin, në formë ishin e njëjtë gjë. Por ishte e pamundur që këta të bëhen në virtytshëm!

Më vonë mbiu një pikëpamje tjetër. Kjo lloj logjike që s'ishte e qartë me ç'mendje shërbente dhe që prirej të hapte gjer në fund të gjithë kanalit dhe digat e epshit me qëllim për ta shpëtuar rininë nga anarkia, me këto pikëpamje të çuditshme donte t'i shpëtonë të rinjtë nga disa ide fikse, të dëmshme, t'i bënte që të mos mendonin diçka tjetër. Mirëpo edhe anarkia aktuale në një mjedis të tillë ishte përgatitur dhe ishte shndërruar në një lugat.

Brezat e plagosur rëndë nga të gjithë këto ndikime të jashtme e të brendshme, çdo ditë e më shumë largoheshin nga të lexuarit e nga të menduarit dhe ktheshin vërtet në turma të marrësh. Me ç'pandeh unë, ky largim dhe kjo kllapi vazhdon edhe sot. Në këtë mes, edhe grumbulli i fjalëve të pafisme¹² që kërkohej të futej në gjuhën tonë, u bë një goditje më vete për të penguar kuptimin e asaj që lexohej. Ne u bëmë që të mos e kuptojmë të folurën e tyre dhe, po ashtu, ata tonën. Edhe sot, njerëzit e të njëjtit brez e kuptojnë me vështirësi njëri-tjetrin. E po s'u pengua kjo dukuri, edhe kjo do të bëhet shkatërruese për botën tonë mendore, të paktën aq sa të tjerat.

Po, sot ne nuk lexojmë dhe përfundimet turpndjellëse të mungesës së leximit duken sheshit. Të cekët në mendim, u bëmë një turmë që s'është më e aftë të bëjë sinteza të reja. Shumë prej nesh nuk janë vetëm pa oreks përballë leximit, por ndjejnë edhe neveri ndaj tij. Kurse një pjesë e lexuesve tanë pothuajse çdo gjë e lexon në sipërfaqe, duke u munduar të prodhojë diçka të re në emër të mendimit.

Shpirrat e errët, mendjet e errëta të së djeshmes, që e patën mësuar prej nesh edhe të lexuarit, ashtu siç patën mësuar më parë virtytet, lexojnë sot, kuptojnë dhe vihen të mendojnë. Në shtëpi, në makinë, stacionin e autobusit, hapin librin që bartin me vete në çantë dhe lexojnë dhe e vlerësojnë në formën më të mirë kohën për kriteret e tyre.

Po qe se do ta studionim çështjen në një kornizë pak më të ngushtë, të mëdhenjtë (etërit) tanë që kanë hapur brazdë para nesh, thonë se disa nga veprat që i patën shkruar vetë, i patën rilexuar tetëdhjetë herë, disa të tjera njëqind herë, duke na treguar kështu domosdoshmërinë e të lexuarit.

Dhe pasi i ka rilexuar kaq shumë veprat-produkte të forcës së vet mendore që i foli natyrshëm, u rri në kokë nxënësve dhe u thotë lexoni! E kështu, në kohën tonë, i vë gishtin plagës më të vështirë e të pashërueshme, duke treguar rrugën e mjekimit. Ata që ndjekin këtë brazdë, duhet të lexojnë. Të pajisur me kulturën e epokave, duhet të shpupurisin njohuritë që kanë marrë përpara dhe duhet të shkojnë tek nevojtarët me një të tillë bagazh kulturor, gjersa të pranohen shpjegimet e tyre duke bërë që, në të njëjtën kohë, të mos u lihet mundësi në dorë armiqve.

¹¹ Në origjinal: Miraxh: shih në fund

¹² Në origjinal: nesepzis, i (e) pafisme, ilegal, kopil: figurativisht flitet për ato fjalë të sajuara të futura përdhunisht në gjuhën turke në emër të pastrimit të gjuhës.

Po të mos lexojmë, do të thotë se mashtrojmë dhe tradhtojmë. Duke u përsjellur vetë në boshllëk, si mund t'i shpëtojmë brezat nga rrymat negative?! Mirëpo ky është qëllimi i jetës sonë dhe detyra jonë e parë. Po qe kështu, para çdokujt tjetër ne jemi nevojtarë, që duhet t'i përgjigjemi urdhrit të parë të Islamit, më të drejtpërdrejtit: Lexo!

4. Thuhet se feja është një gjykim i propozuar nga detyrimi për të maskuar çështjet që njerëzit nuk mund t'i shpjegojnë. Përparimi i qytetërimit a e zhduk nevojën për fenë?

Armiqtë e fesë pretendojnë se kuptimi i fesë është i sajuar nga njerëzit si një shprehje dobësie ose mirënjojheje. Gjykimi i tyre mund të përmblidhet kështu: Në gjithësi ekzistojnë disa dukuri që s'ua kuptojmë të fshehtën, që s'i zgjidhim dot me ligjet e kimisë dhe fizikës. Ja, pra, për t'u gjetur një zgjidhje këtyre dukurive të pazgjadhura, ashtu si në kohët e vjetra, edhe sot, i vishet një krijuesi. Në mënyrë të veçantë, njerëzit i kanë shenjtëruar qeniet nga të cilat kanë patur më tepër dobi dhe më vonë i kanë pranuar si nga një zot më vete. Shenjtërimi i Gangut për indianët dhe i Nilit për egjiptianët, duke filluar nga këta popuj gjer në ditët tona, kushtimi i shenjtërisë lopës, janë si pasojë e dobive që u kanë sjellë njerëzve ato. Edhe qëndrimi i njeriut ndaj frikës nuk ka qenë i ndryshëm nga kjo. Frika e madhe e ka çuar njeriun në nderim si dhe në mendimin se me këtë nderim, do të sigurohet nga frika e tij. Pranimi në disa fe i dy zotave të veçantë për të mirën dhe të keqen, nga një aspekt, ka kuptimin e ndarjes së këtij nderimi dhe frike në dy zota të veçantë. Edhe xheneti dhe xhehenemi (parajsa dhe ferri) janë produkte të mendimeve të buruara nga e njëjta situatë shpirtërore. Në të vërtetë, feja është një kënaqësi mediokre:¹³ është një mjet shfrytëzimi i sajuar nga njerëzit e fesë, një opium i sajuar për të vënë njerëzit në gjumë... e të tjera, e të tjera. Vërtet, ashtu siç thonë ata, feja qenka sajuar më vonë? Vërtet qenka kriuar për të shpjeguar dukuritë e papërballueshme, duke shërbyer si një burim qetësimi e ngushëllimi? Jo, jo! Kurrë! Në asnje mënyrë!

Fjala “din” (fe), një fjälë arabishte, ka kuptime të tillë si bindje, ndëshkim, rrugë. Në thelb, këto tri fjälë janë edhe në përkufizimin e fesë. Feja është një rrugë, një rrugë kryesore, një rrugë e madhe. Në të, në rend të ditës, është bindja ndaj Providencës Hyjnore. E prapë në të ka një sanksion të tillë si shpërblimi për të bindurit dhe ndëshkimi për të pabindurit.

Përkufizimi legal¹⁴ i fesë është ky: “Feja është tërësia e ligjeve hyjnore që e çojnë drejt të mirave personalisht njeriun që ka mendje.”

Feja u drejtohet zotëruesve të mendjes. Në këtë mënyrë, njerëzit krijojnë bindje me vullnetin e vet. Feja e jep të drejtën e vullnetit, nuk e paralizon atë. Dhe pika ku i bart njerëzit ajo, është e mira absolute. Bëhet fjälë jo për të mirën që e pranojnë disa, sipas kuptimit dhe konsideratës së këtij apo atij, por për orientim kah e mira vetë.

Këtë, së pari, feja e trajton nga aspekti i besimit. Ndoshta njeriu mund ta konceptojë ekzistencën e një krijuesi që e ka kriuar atë vetë dhe gjithësinë, vetëm me mendjen e vet. Mirëpo, kur të ketë dëgjuar përmendjen e Zotit nga zëri gurgullues i një profeti dhe me një zë që mbështet pranimin në ndërgjegjen e vet, do të jetë bërë zotëruesi i një dijeje kategorike, i një besimi në formën e

¹³ Në origjinal: Burjuva tesellisi (turq.)

¹⁴ Në origjinal: Sher'i tarif (osm.)

domosdoshmërisë, që duhet besuar. Në të njëjtën kohë, ai Profet është sjellë me dokumente që tregonjë, se ai është ngarkuar me detyrë nga Providenca Hyjnore. Po qe se pranë sa e sa mrekullive që tregon, do të ketë sjellë edhe një libër, mrekullia e të cilit do të vazhdojë gjer në kiamet, katastrofë, do të thotë se, më së fundi, nuk ka vend për dyshim. Në sajë të atij libri, ky njeri do të mësojë se si i duhet besuar ahiretit dhe kaderit, kushtin për t'u besuar edhe sa e sa gjëra e tjetra dhe se çështjet e ardhura aty të paqarta, do t'i shpjegojë dhe praktikojë personalisht ai Profet.

Kurse mundësia që një besim i tillë të mbetet përherë i freskët ndër zemra dhe të mos vyshket e të zhvoshket, ka lidhje me adhurimin. Në sajë të adhurimit, besimi mund të mbetet përherë i ri, pa u vjetruar fare. Ndryshe, tek njeriu pa adhurim, një kohë më vonë, besimi në emër të dashurisë dhe ngazëllimi mbetet vetëm me mburrjen e të parëve atje nën dhe. Edhe për ta flet se kanë qenë hoxhë ose haxhi. Në të vërtetë, ai krenohet me të parët, në krahasim me atë që flet me gojën mbushur plot sharje, gjithsesi, konsiderohet se bart përbrenda një margaritar, sado të vogël, veçse është e paqartë nëse një margaritar i këtillë do të durojë apo jo gjer në çastin e fundit.

Audienca e Allahut ku paraqitemi duke vrapiuar pesë herë në ditë, do të na japë vrull në çdo çast dhe pothuajse do të na shtyjë drejt një betimi dhe premtimi të ri ndaj çështjeve që besuam. Po qe se në çdo namaz, madje në çdo rekat të namazit me anë të Kur'anit dhe apoteozave¹⁵ nuk arrihet të merren mesazhe të reja, kjo është shprehje e zbehjes së shkaktuar nga zakoni, domethënë se ai namaz quhet një pagesë borxhi pa qenë i vetëdijshëm e pa iu bërë prezent fshehtësisë së tij. Edhe po qe se me kryerjen e një namazi të tillë do të ishte kryer detyrimi, në fakt, produktet shpirtërore që priten nga namazi, nuk mund të arrihen.

Kjo është arsyaja se pse të mëdhenjtë tanë të përjetojnë një situatë të tillë në sexhde, saqë thonë: sikur të mund të falja një rekat namaz të tillë! Dhe pastaj shprehen: Ja, kështu ishte namazi i pasuesve! Çdo pjesë e namazit u sillte atyre mesazhe nga Providenca Hyjnore. Në adhurimet e tyre s'kishte veprime të kryera për zakon. Edhe adhurimet e tjera (përveç namazit) ishin në funksion të cilësisë, që t'u jepnin atyre të njëjtën situatë shpirtërore.

Nisur nga kjo, çdokush që shkon në haxh, që jep zekat, që agjeron sipas parimit *zbato urdhrat, ruaju nga ndalimet*¹⁶, sipas llojit të adhurimit të bërë, duhet t'i vlerësojë mirë forcat shpirtërore nxitëse dhe fuqizuese që priten nga ai adhurim, në mënyrë që ta gozhdojë besimin plotësisht.

Një aspekt tjetër i fesë sheh nga praktika. Tregu dhe tregtia e besimtarit duhen rregulluar në përputhje me miratimin e Providencës Hyjnore. Morali dhe parimet e tregtisë duhen të sillen në përshtatje me kriteret e Kur'anit dhe Traditës Profetike. Edhe kjo është një nga specifikat që forcojnë besimin, sepse në sajë të tyre njeriu, duke braktisur dëshirat dhe kërkesat e nefsit, egos së tij, u nënshtrohet urdhrave dhe kërkesave të Providencës Hyjnore.

Le të themi se një besimtar do të shesë një mall për të cilin duhet të thotë të metën që ka. Mirëpo, po ta bëjë një gjë të tillë, do t'i pakësohen fitimi ose do të dëmtohet. E ja pra, njeriu që megjithatë, e tregon të metën e mallit, ndjen në vetvete një lehtësim, një kënaqësi që buron nga bindja ndaj Zotit të vet. Pak më pas, kur të drejtohet në namaz, në audiencën e zotit të tij, ky lehtësim në vetvete do të ndikojë pozitivisht mbi begatinë, që do të përfitojë në namaz e kështu, edhe ai vetë, do ta ruajë freskinë e gjallërinë e besimit të vet. Ja, këto janë pretekste që na çojnë tek Zoti. Fundja, vetë Ai Personalisht është

¹⁵ Në origjinal: Tesbih (arab.), përmendja e Zotit me shprehje të larta të denja ndaj famës së tij.

¹⁶ Në origjinal: Emri bilma' rûf, neħji anilmunker (arab.)

kah urdhëron që të kërkojmë pretekste. I Dërguari i Allahut, duke përshkruar gjendjen e tre vetëve të mbyllur në shpellë, na tërheq vëmendjen për rëndësinë e preteksit.

Njëri syresh ka bërë pretekst për vetë sjelljen e njerëzishme ndaj prindërve, tjetri virtytin dhe i treti respektimin e së drejtës; janë lultur e kështë është hapur edhe guri që mbante mbyllur gojën e shpellës. Jo vetëm në veprime e sjellje, por po të na vijë për dore, ne përpinqemi t'i ngajmë të Dërguarit të Allahut duke nisur që nga ndërtimi ynë fizik. Po kush nuk dëshiron të zotërojë si ai syrin, veshin, hundën, gojën! Po qe kështu, duke kaluar nga forma pamundësisht për t'u përngjarë tek forma mundësisht për t'u përngjarë, do t'i hyjmë zellit për t'ia përshtatur plotësisht atij moralin tonë dhe mënyrën tonë të jetesës. Do të përpinqemi të hamë si ai, të vishemi si ai, të biem si ai, të ngrihem si ai, edhe detyrën tonë si rob i Zotit ta kryejmë si ai.

Po i pati thënë Providenca Hyjnore faizit (kamatës) haram, e keqe, e ndaluar, edhe sikur mbi një *kurush*¹⁷ të jepej një mijë *kurush* kamatë, ne do t'i ruhemë asaj e do të ikim. Përballë gjithë mëkateve të mëdha e të vogla që do të na dalin nesër përpara në formën e një flake e të një thëngjilli të ndezur, qëndrimin tonë do ta kemi të njëjtë.

Nga të gjitha këto, del qartë se: feja është një e tërë, ajo s'pranon ndarje në pjesë e copëtim. Ose, me një shprehje tjetër, nuk i thuhet fe asaj që pranon pjesëtim e copëtim. Feja është si një pemë. Çështjet përkatëse të besimit janë rrënjet e saj, veçoritë lidhur me besimin-degët dhe filizat, veprimet-lulet e saj, ndëshkimet-mbrojtësi, veçori të tillë si lutjet dhe këndimet-elemente që e ushqejnë atë pemë nga poshtë e nga lart. Ja, pra, feja që aspiron një tërësi dhe unitet të tillë, është vënë nga Allahu dhe është njoftuar e zaptuar nga profeti.

Ndërgjegjja e çdokujt, duke kaluar në marrëdhënie me Zotin e vet, mund ta merrte shpirtin e fesë prej Tij pa ndërmjetësim. Mirëpo është e pamundur që çdokush t'ia arrijë atij purifikimi shpirtëror, për ç'shkak edhe Providenca Hyjnore zgjodhi Profetin e Madh. Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzve... (Haxh, 75). Detyrën e shpalljes Allahu e realizon me anë të një grupi të zgjedhur prej engjëjsh ose prej njerëzish.

Ndërsa ekzistonin engjëjt, që qysh nga krijimi adhuronin në këmbë në ruku e në sexhde dhe numri i të cilëve mund të dihej vetëm prej atyre vetë, Providenca Hyjnore ia kishte ngarkuar Xhebrailit Besnik Revelacionin, jo për ndonjërin nga engjëjt, por për të Dërguarin e Tij. Dhe ishte Xhebraili Besnik ai që kishte siguruar për 23 vjet lidhjen me Profetin. Ai solli Revelacionin, kurse Profeti e dëgjoi me edukatë dhe urtësi dhe e përvetësoi me të gjithë qenien e tij. Një të tillë vëllazëri dhe miqësi kishte ngritur dhe siguruar me Xhebrailin brenda kësaj kohe 23-vjeçare, saqë ardhja e fundit e tij e kishte thyer më dysh dhe e kishte bërë të qante. Ja, pra, njerëz të tillë zgjidhë Allahu (xh.xh.) për detyrën e shpalljes. Edhe profetët e tjerë kështu ishin zgjedhur, ata ishin njerëz të shndërruar në kajmak. Edhe minerali i atyre të gjithëve prej floriri ishte. Po, ata ishin njerëz të porositur. Allahu siç ishte i zgjedhur i Dërguari i Allahut, edhe ata që kishin siguruar denjësinë për të qenë pasuesit e tij, të zgjedhur ishin. Dhe feja ka ardhur te ne me pasimin e atij zinxhiri të artë.

Profeti ynë dhe të gjithë profetët e tjerë qenë të detyruar të duronin çdo lloj vuajtjeje e shqetësimi në shërbim të shpalljes së fesë dhe, natyrisht, që në duar s'patën asgjë që i përkiste kësaj bote. Madje, Profeti ynë, po të hiqte dorë nga kauza e tij, edhe shumë i pasur do të bëhej, edhe do t'i shtoheshin përpara të gjitha ato gjëra që i dëshironin e u shkonin prapa të tjerët. Do të martohej me femrën më të bukur të zonës dhe do të bëhej udhëheqës i Mekës - ndërmjet gjithë premtimeve të tjera. Tani lërini

¹⁷ Kurush: Këtu qindarkë

këto, ai kishte hipur në miraxh. Të gjitha yjet i ishin rreshtuar ndër këmbë si parket dhe ai, duke ecur përmbi to, kishte arritur te Zoti i tij. Kishte soditur të gjitha bukuritë që mund të shiheshin dhe kishte shëtitur e ishte përsjellur një për një në ato vende, që një tjetër kurrë nuk do t'i linte e të kthehej, e ishte kthyer prapa për t'ia mundësuar edhe bashkësisë së tij atë spirale. E ç'ishte ai vend ku u kthye ai në atë kohë? Ai po kthehej në ato rrugë ku kishin shtruar gjemba, atje ku, i qëlluar me gurë, ishte braktisur me këmbë tërë gjak, atje ku ishte tallur e sharë, kthehej në vendin ku ishte ofenduar e përbuzur. Ç'nevojë vallë kishte i Dërguari i Allahut t'i shihte e të pajtohej me të gjitha këto? Duke lajmëruar fenë, ç'përfitim apo frikë e vinte në lëvizje atë? Po qe se një njeri edhe vetë Parajsa ta magjepsë e të mos mund ta marrë brenda tërheqjes së saj, e po qe se ai njeri të bëjë një sakrificë të tillë kthimi tek bashkësia e tij, duke e parapëlqyer këtë gjë para çdo gjëje tjetër, gjithë këto shpifje të hedhura a s'ia thyejnë shpifësit atë kokën e tij të trashë?

Allahu (xh.xh.), ndaj të cilit ne jemi robër, është i plotësuar me gjithçka. Ai s'ka nevojë përfenë dhe punë tonë fetare. Ne jemi ata që kemi nevojë përfenë robër të Tij.

Ai u kërkon mëkëmbësve të Tij mbi tokë të jetojnë në përshtatje dhe drejtpeshim me qeniet e tjera e, përkëtë, na detyron që të veprojmë në vijën e Kur'anit, mishërimi të jetesës së përshtatshme e të drejtpeshuar. Thënë ndryshe, si pasojë e pamundësisë sonë për t'u vetëqeverisur, përfenë mos punuar shtrembër dhe përfenë mos u shmangur rrugëve të shtrembra, por përfenë mbetur në rrugë të drejta, na favorizon me një rrugë të ndriçuar siç është feja. Dhe na urdhëron të shohim te Kurani që na dha në dorë dhe ta përshtasim veten sipas kriterieve të Kur'anit, gjersa edhe ne të mund të ngjitemi katë më kat drejt yjësive të qillit të njerëzimit dhe, duke i vënë në punë dhunxitë dhe aftësitë përkatëse të kompleksit tonë cilësor, të mund të rrahim krahët drejt pikave të horizontit.

Po, ne kemi nevojë përfenë. Po qe se njerëzit do të mund të dinin nevojat e tyre të vërteta, po qe se do të bëheshin të vetëdijshëm se janë kandidatë për lumturinë e amshuar e po të arrinin në pikën e aktivizimit të të gjitha ndjesive sublime, ndonëse do të shpreheshin ndryshe, me kërkesën e njëjtë, do të thoshin kështu, Allahu ynë: Na dërgo një sistem, na qeveris me sistemin tënd, na shpëto pa ecur nëpërvende të gabuara, pa mbetur larg (Teje), pa shkuar andej-këtej të turbulluar!

Edhe filozofët më të mençur kanë ecur bjer e ngrihu, kanë rënë e mbetur diku dhe të vërtetës nuk kanë mundur t'ia arrijnë. Mirëpo edhe më i padituri ndër ne, nën rrezet ndriçuese të rrugës së Muhamedit, nuk ka hedhur bosh asnë hap dhe në çdo fushë të jetës ka jetuar si njeri dhe ka respektuar të drejtat e njerëzve të tjerë. Në perspektivën e tij është miratimi i Allahut, kurse përpara ka një pararojë të tillë si i Dërguari i Allahut e kështu, ai çdo çast të jetës e përdor si një kalli që jep njëmijë kokrra për një.

Feja nuk është produkt i mendjes së njeriut si pasojë e rrethanave shtrënguese ose, siç thonë ata, diçka e sajuar. Dukja e saj si diçka e detyruar, është në natyrën e fesë dhe në ekzistencën e ndjenjës së fesë në krijimin e njeriut. Njeriu është krijuar mes nevojave ndaj urdhavrave fetare dhe ai është gjithmonë nevojtar ndaj fesë.

Vetëm në sajë të fesë njeriu e mëson të drejtën dhe të vërtetën, në besimin e tij, adhurimin dhe aktivitetin e tij, dhe prapë në sajë të fesë sillet në gjendjen e një qenieje të merituar për Parajsen. Njeriu i formuar, duke shkrirë e duke u shkrirë në pocën e fesë, përfoton një cilësi të tillë që, pas kiametit, katastrofës, nën Flamurin e Profetit, të njihet nga Profeti e të kapet përdore.

I Dërguari i Allahut, i pyetur se si do ta njojë bashkësinë e vet, përgjigjet se do ta njojë nga shkëlqimi i gjymtyrëve të abdesit nga pastërtia. Dhe vazhdon: Siç e njihni ju kalin tuaj mes kalorësisë

prej ballit të stolisur me nishane, edhe unë ashtu i njoh njerëzit e bashkësisë sime. Prandaj ne jemi nevojtarë për frymëmarrjen që na jep feja.

Feja ka ardhur me parimet më pozitive që e përbledhim gjithë jetën. Quajtja e saj si e pamjaftueshme është shprehje e qartë e pamjaftueshmërisë së njohjes. Ata që përpilen ta vënë në raft fenë, një ditë do ta kuptojnë gabimin e tyre me tërë tmerrin e vet dhe do të pendohen njëmijë herë për ç'kanë bërë.

Ka ardhur dita, më në fund, që të pohohen këto gabime të bëra në Lindje e Perëndim. Feja ka një metodë, ka edhe një degëzim.

Në metodë kurrë nuk mund të diskutohet për ndryshime. Nga pikëpamja e metodës, midis fesë së kohës së Hz. Ademit dhe fesë së sotme, nuk ka ndonjë ndryshim.

Në të gjitha fetë qiellore, fundamentet njerëzore janë të njëjta. Megjithëse ngurroj për të dhënë një konkluzion të prerë, pasi për çka do të flas nuk ekziston ndonjë dogmë, mund të them vetëm kaq, që në metodën fetare, edhe urdhrat ndaj engjëjve janë po ato. Sikurse ne, edhe engjëjt të gjithë u besojnë atyre që u besojmë ne. Edhe ata i besojnë Allahut, engjëjve, librave, profetëve, fatit të paracaktuar, ringjalljes; ndryshimi është vetëm në dimensionet e krijimit e të lartësimit shpirtëror.

Si në besim, edhe në adhurim, fetë janë të njëjta. E thënë ndryshe, nuk ka asnë fe të vërtetë pa adhurim. Ç'e do se forma e adhurimit ka aspiruar ndryshime në çdo epokë. Njeriut të çdo epoke Providencia Hyjnore i ka ngarkuar një adhurim sipas vetëdijes së epokës dhe kapacitetit të njeriut përkatës. Forma mund të ndërrojë, vetëm prania e adhurimit, si metodë, nuk ndryshon.

Për shembull, në të gjitha fetë është besimi i jetës së përtejme, gjë që është e domosdoshme. Pavarësisht nga ndryshimet në parashtim dhe në thelb, çdo profet i ka folur për jetën e përtejme bashkësisë së vet. Fundja, po të mos ishte një besim i tillë për jetën e përtejme që të pengonte të keqen e të nxiste të mirën, feja do të mbetej vetëm një ndër sistemet shoqërore-ekonomike ose, me një shprehje tjetër, do të mbetej një identitet i tyre. Duke u nisur nga një pjesë e madhe e feve, feja i ngre urdhrat mbi parimin e ringjalljes pas vdekjes.

Po të mos ishte besimi në jetën e përtejme, nuk do të kishin asnë dobi për njeriun as adhurimet, as vuajtjet e hequra, ankthet dhe sakrificat, madje as një lloj besimi. Po të mos ish ai besim, njeriu do të zhvishej, nga një pikëpamje, edhe nga të gjitha virtytet që ka sot në vetvete. Sigurisht, është besimi në jetën e përtejme ai që na shtrëngon të jemi të virtytshëm, sepse besojmë pa u lëkundur fare se një ditë do të na dalin para gjithë ç'kemi bërë qoftë e vogël edhe sa një molekulë.

Veçanërisht e presim me padurim atë çastin kur do të shohim Zotin tonë që nuk do të na kundërshtojë t'ia sodisim Bukurinë qoftë edhe një herë të vetme gjatë gjithë jetës Parajsore dhe, duke marrë vrull të nxitur nga dëshira e nxeh të në vetvete, pa ngurruar aspak, përpinqemi të ecim në rrugën që do të na çojë në atë përfundim.

Në lidhje me hollësitë e çështjeve, profetët, duke anulluar një ligj paraardhës, mund ta shfuqizojnë atë. Ndryshime të tillë kanë ndodhur gjithmonë. Kjo ka lidhje edhe me pjekurinë dhe përsosjen e njeriut. Në epokën e Hz. Ademit, njerëzimi jetonte fëmijërinë e vet. Kurse Pejgamberi ynë ia përngjan veten diellit të pasdites. Kjo do të thotë se njeriu i epokës së tij jetonte moshën e pjekurisë e të përsosjes. Në atë epokë dallohej qartë bestytnia nga e vërteta dhe njerëzit i lidheshin ngushtë të Vërtetës që vinte pas bestytnisë. Edhe hollësitë e fesë së ardhur ishin përshtatur në përmasat e këtij mendimi dhe kësaj logjike. Në fakt, prapë Allahu është Gjykatësi që e bën këtë. Në të gjitha format e adhurimit të kësaj feje

ka me qindra synime. Si të thuash, forma e adhurimit te ajo është në përshtatje me një bashkësi njerëzish të formuar. Kurse fetë e tjera, në periudhat e mëpastajme janë korriguar dhe i kanë humbur cilësitë origjinale. Edhe sikur të kishin ruajtur gjendjet e para, nuk mund të ishin të vlefshme për sot, sepse Allahu ka përcaktuar si fe atë ndaj së cilës do të miratonte dhe këtë e ka quajtur Feja Islame.

Dua të përbledh çështjen me një fjali.

Ashtu siç feja nuk është një sistem i lindur nga shtrëngesa e njeriut prej presionit të përbysjes apo rrufesë, nuk është as edhe një sistem i parashtruar për të siguruar gjendjen shoqërore-ekonomike të njeriut, për t'ia siguruar asaj qetësinë. Prapë, ajo është tepër larg të qenit e lindur prej natyrës së njeriut siç kanë thënë Rusotë. Feja është një revistë ligjesh hyjnore, një komunikim hyjnor; ajo përfaqëson lumturinë materiale dhe shpirtërore të njerëzve.

Qetësia dhe lumturia e këtushme janë të lidhura me të.

Mbetja lidhur ndaj kuptimit të së drejtës është e mundur vetëm me të. Edhe në jetën e pastajme, arritja e Parajsës dhe e Bukurisë së Zotit, do të jetë në sajë të fesë.

Sado të përparojë qytetërimi, nuk do të jetë i mjaftueshëm për ta lumturuar as jetën e kësaj bote për njeriun. E ku mund ta zërë ajo vendin e fesë!

5. Si ka ndodhur kalimi i njerëzve në Amerikë?

Një temë aktuale. Dhe bie pak erë dialektikë. Pyetja është e thjeshtë, por në fakt, synimi dhe qëllimi, jo. Me një fjalë, ne kërkojmë të na thotë kështu: Ju pyesni se si të gjithë njerëzit të krijuar nga të njëjtit prindër, kaluan në Botën e Re? Po të jetë siç thoni ju, kalimi i tyre është i pamundur. Kjo do të thotë se njerëzit e çdo zone kanë dalë po aty dhe vetveti.

Pra, është fjala për një evolucion.

Ja tek fle një logjikë mosbesimi e ateizmi nën pyetjen që duket si e thjeshtë. Po, ne themi se njerëzit kanë prejardhjen nga Hz. Havaja. Dhe jo ne, por këtë e thotë drejtpërsëdrejti Providanca Hyjnore. Dhe e pranojmë me gjithë zemër se kështu është.

Prej vitesh bota e shkencës, me pikëpamje e teorira të ndryshme, përpinqet të shkatërrojë thëniet e Kuranit lidhur me krijimin. Por thëniet e tyre janë shpërbërë një nga një dhe drejtësia e thënieve të Kuranit është vërtetuar edhe një herë tjetër, madje në gjuhën e shkencës. Tani nuk do të përqendrohem i në këtë pjesë të tematikës duke e lënë me ato që kemi trajtuar në pyetje të tjera, vetëm do të themi kaq, që njerëzit janë shumëzuar me prejardhje nga Hz. Ademi dhe Hz. Havaja. Darwinizmi që pretendon të kundërtën, po merr çdo vit qindra plagë. Në fund të fundit, ai është vetëm një teori. Dhe përballë një teorie të tillë të kalbur e pa bazë, përqendrimi i frontit tonë, në pamje të parë, duket si

i tepërt. Mirëpo blasfemia dhe ateizmi i frikshëm apo aq tinzar që fshihet pas kësaj teorie, bën pothuajse të detyruar një përqendrim të tillë. Peizazhi është ky: që në fillimet e veta, Darwinizmi ka qenë një kadavër. Në asnjë kohë nuk ka gjallëruar. E, ja, kundër kësaj kadavre, gjer më sot, me qindra dhe mijëra shkencëtarë besimtarë kanë marrë nishan dhe kanë derdhur një breshëri plumbash. Pesëdhjetëmijë herë është plagosur, po aq dënuar, është varur në litar kjo kadavër; ky sulmi ynë serioz kundër saj është për shkak se disa njerëz banalë në pamje dhe, me sa mundin, të thjeshtë, naivë, madje mistikë të blasfemisë, të shtënë pas zellit për ta mbajtur gjallë këtë teori, përpiken ta mashtrojnë rininë.

E tani le t'i kthehem i çështjes sonë kryesore.

Bota jonë, disa herë gjer më sot është vënë përballë ndryshimeve. Për shembull, gjeologët thonë se dhjetë mijë vjet më parë, Deti Mesdhe ka qenë truall, kurse ato vende që janë truall sot, atëherë kanë qenë detra. Nëse thëniet e tyre janë të drejta, kjo do të thotë se aty ku shtrihet sot Deti Mesdhe, ka pasur qytetërimë dhe shtete. Në këtë rast, të njëjtën gjë mund të themi edhe për Amerikën dhe Australinë. Me fjalë të tjera, edhe ato vende, ndoshta, në kohë tepër të hershme, kanë qenë fqinje me kontinente të tjera të botës, ndërsa detrat dhe oqeanet midis tyre kanë qenë tokë. Pasi çështja pranohet në këtë formë, kalimi i njerëzve në Botën e Re apo ndonjë kontinent tjetër, paraqitet i mundur.

Ndërkaq, gjithashtu historia njerëzore mbështetet në një kohë më të vjetër nga ç'pandehet. Për shembull, pak më parë u botuan shkrimet që flisin për skeletin e një njeriu që ka jetuar 270 milionë vjet më parë. Kurse skeleti më i vjetër i majmunëve, i gjetur gjer tani, mbështetet në 120 milionë vjet më parë. Domethënë, midis tyre ka një interval hershmëri mëse gjysmë për gjysmë. Algat e fundit të detit ndodhen sot në atë gjendje që ishin 500 milionë vjet më parë. Shkencëtarët që thonë se hojet e bletës janë po në atë gjendje si 500 milionë vjet më parë, me këto shifra pohojnë se historia e krijimit dhe shfaqjes së ekzistencës, mbështetet në një kohë shumë përgjithësisht asaj që është pandehur gjer më sot. Po qe kështu, historia mund të zgjatet dhe kategorikisht nuk është e drejtë të konkludohet për periudha para asaj që njojin historianët. Edhe thëniet tona duhet të pranohen në kuadër të mundësisë dhe s'i duhet hyrë një vlerësimi të atillë. Ata që thonë të kundërtën, nuk kanë ndonjë bazë që do t'i shpërbënte pikëpamjet tona.

Kur francezët u takuan me Majatë, dëgjuan këtë gjë prej tyre: Sipas shkrimeve, në historinë tonë, një herë e një kohe, tokat kanë qenë fqinje me pjesët e tjera të tokës. Në përfundim të një tufani dhe shtrëngate, ne mbetëm në këto maja, kurse shumica e njerëzve u mbytën e u zhdukën bashkë me tokat që u shndërruan në dete...

Edhe në historinë e indianëve takohet i njëjtë variant: ...Doli një tufan i madh. Shumë pjesë toke fqinje me ne u ndanë dhe në mes hyri oqeani...

Mundet që Australia të jetë copa e tokës për të cilën bëhet fjalë. Kjo do të thotë se në kuadër të këtyre mundësive, vajtja për në Amerikë dhe Australi nuk duhet të ketë qenë aq e vështirë sa ç'është pretenduar.

Si të fundit, mund të them edhe këtë: Sikur ta pranonim gjendjen e truallit të botës në gjendjen e sotme, prapë s'do të ishte e vështirë. Sepse kur ngushtica e Beringut ngrin dhe rrighthohet me akuj, edhe sot është i mundur kalimi nga Rusia në Amerikë. Gjithashtu, një distancë ujore e tillë mund të kalohet, madje, edhe me trapet më primitivë. Me të vërtetë, në një periudhë kur nuk ekzistonin anijet moderne, para Kristofor Kolombit, udhëtarët arabë me anije ku patën ngarkuar edhe kuaj, patën kaluar në Amerikë duke e zbuluar atë. Kjo është një e vërtetë e hapur e pranuar nga shumica e madhe e kërkuesve të sotëm. Kjo do të thotë se nuk dihet nevoja e një ndodhie të jashtëzakonshme për kalimin

atje të njerëzve autohtonë në krahasim me brezin e sotëm. Ç'ndodh me ç'ka ndodhur, janë mjaft të ngjashme...

Sa për shkatërrimin e darvinizmit, edhe janë thënë shumë gjëra lidhur midis pyetjeve që përbëjnë përgjigje ndaj lëkundjeve, edhe në këtë tematikë, veçanërisht kohët e fundit, janë botuar një numër i madh librash dhe kërkimesh shkencore...

Ua rekomandoj kureshtarëve t'i lexojnë këto libra.

6. Në fund të kaptinës Llukman, koha e rënies së shiut dhe gjendja e fëmijës në barkun e nënës konsiderohen nga pesë të fshehtat. Si e shpjegoni?

Më kujtohet se mbi këtë çështje kemi qëndruar edhe më parë dhe se jemi përpjekur ta bëjmë të qartë temën me shpjegime. Vetëm se sa herë dhe kudo që të më pyetet një çështje e tillë lidhur me Kur'anin, me shtypjen e ndërgjegjes, përsëri do të tregoj me zell për të dhënë përgjigje, sepse edhe çështja më e vogël që i përket Librit të Allahut, është e madhe sa malet. Ja pra, nisur nga kjo ndjenjë, prapë do të tregoj me zell ca gjëra.

Në ajetin e fundit të kaptinës Llukman, thuhet kështu:

S'ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë kiameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç'ka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çka do t'i ndodhë (çka do të punojë) nesër dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç'vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i dijshmi, më i njohuri. (Llukman, 34)

Vetëm Allahu e di se në ç'kohë e kur do të shpërthejë kiameti. Pasi Kurani i Madhnueshëm ta ketë parashtruar këtë si një të vërtetë dhe parim, pa thënë Allahu e di, askush nuk ka mundësi të thotë ndonjë fjalë ose të shfaqë ndonjë mendim në këtë subjekt, ashtu siç është bërë e qartë edhe në ngjarjen e Xhebrailit. Ky i vjen të Dërguarit të Allahut me një veshje prej udhëtarë, por që në trup nuk i dukeshin shenja udhëtarë, i bie në gjunjë dhe i bën disa pyetje, si ç'është besimi, Islami, i thotë saktë, drejt fole. Në fund e pyet: Kur do të shpërthejë kiameti? Dhe i Dërguari i Allahut i përgjigjet: i pyeturi nuk di më shumë se sa ai që pyet. Pastaj i numëron si shenja disa ngjarje që do të ndodhin afér kiametit. Ja se si, i Dërguari i Allahut, me edukatë prej profeti, jepte përgjigje për një çështje nga të fshehtat¹⁸.

Një njohuri të përbashkët kishin me Xhebrailin. Edhe për atë, vetëm Allahu e dinte kohën se kur do të shpërthente kiameti.

Sa për temën e kiametit, aq shumë gjëra ka nga këndvështrimi i shkaqeve, saqë realizimi i vetëm njërit prej tyre do të ishte i mjaftueshëm për të shkaktuar kiametin: goditja e tokës nga ndonjë kometë; shpërthimi i diellit ose, sipas ligjit të termodynamikës, shuarja e tij; realizimi i reaksioneve zinxhir nga

¹⁸ Në origjinal: mugajebât-i hamse, pesë të fshehtat: a. Koha e kiametit, katasrofës; b. Koha e të rënët shi; c. Gjendja e fëmijës në barkun e nënës; d. Ç'do t'i ndodhë njeriu të nesërmen; e. Koha dhe vendi i vdekjes së njeriu.

ndonjë gabim i njerëzve dhe, për pasojë, shpërndarja e sistemit diellor... Sot, në kuadër të mundësive, është e mundur të radhiten edhe mjafat shkaqe të tjera.

Çështja e dytë e numëruar në ajet, është: shiun e lëshon Allahu. Kjo është edhe një nga specifikat që kundërshtohet më shumë. Me fjalë të tjera, kundërshtarët thonë kështu sipas mendjeve të veta: Sot, në bazë të vrojtimeve meteorologjike, mund të thuhet se kur do të bjerë shi. Po qe kështu, ta quash këtë si të fshehtë, s'ka kuptim...

Natyrisht, qëllimi i atyre që këtë pyetje e pririn kah blasfemia, s'është kjo. Qëllimi i vërtetë është të prodhojnë lëkundje dhe dyshime mbi Kuratin. Edhe ndjeshmëria jonë në dhënien e përgjigjes nga kjo buron.

Sot, çështjet që thuhet se ata i dinë me anë të teknologjisë moderne, në ç'shkallë janë të lidhura me të fshehtën, vallë? Në të vërtetë, parashikimi i rënies së shiut për të cilin kanë filluar të shfaqen në botën e dëshmisë, nuk ka asnje lidhje të afërt apo të largët me të fshehtën.

Le të përpinqemi ta sqarojmë çështjen me një shembull shumë të thjeshtë. Le të mbushim një dhomë me dioksid karboni. Pastaj, me anë të aparateve që mbajmë në duar, të provojmë praninë e dioksidit të karbonit dhe të themi: Pas dy orësh, ata që ndodhen këtu brenda, do të ndjejnë dhimbje koke dhe rëndesë. E tani, duke bërë këtë parashikim, pasi kemi siguruar të dhëna për shkaqet, mos vallë kemi njojur të fshehtën? Kjo s'është e fshehtë! E fshehta është çështje, njojen e së cilës Providencia Hyjnore ia ka rezervuar vetëm Vetes. Le të themi se vitin e ardhshëm ose pesë-dhjetë vitet e ardhshme ne e dimë se ku do të bjerë shi ose sa do të bjerë me të gjitha hollësirat përkatëse; kjo do të ishte njojje e të fshehtës. Por parashikimi se ku do të bjerë shi nesër, nuk është njojje e të fshehtës. Veç kësaj, në këtë parashikim ndodh që disa herë s'del ashtu siç thuhet ose ato që thuhen, gjë që tregon se edhe kaq gjë s'njihet mirë, prandaj edhe quhet parashikim... Pastaj, lëreni vitin e ardhshëm, a mund të thuhet që dihet se sa shi do të bjerë nesër?

Veçanërisht, për të ditur për rënien e shiut, shenjat e të cilit kanë filluar të shfaqen në botën e dëshmisë, nuk ka nevojë as për vegla, as për pajisje. Midis popullit ka aq shumë vetë që i njojin ato shenja me anë të përvojës dhe të aftësimit në vëzhgim, saqë thëniet e tyre jo vetëm nuk ndryshojnë nga ato të pajisjeve, por s'mbeten pas edhe nga saktësia. Meqë erdhi rasti, do ta tregoj rishtaz një kujtim që e kam treguar edhe më parë.

Disa shkencëtarë amerikanë vijnë në Turqi dhe vizitojnë një fshat. Merren me ca kërkime. Në këtë mes, takohen me një çoban që po kulloste dhitë. Një çast, çobani mbledh dhitë e drejtohet për nga vatha. Kur e pyesin për shkakun, u thotë se pas pak do të bjerë shi. Shkencëtarët habiten sepse në qill nuk shohin asnje shenje që të paralajmëronte shi. As barometri që kishin me vete s'tregonte gjë. Por, me të vërtetë, pas njëfarë kohe fillon të bjerë shi. Shkencëtarët vrapijnë për në vathë dhe e pyesin fshatarin se si e kuptoi që do të binte shi. Sipas përvojës sime shumëvjeçare, para se të bjerë shi, dhitë e mbledhin bishtin. Nga kjo e kuptoj se do të bjerë shi. Shkencëtarët i përplasin për tokë aparatet duke thënë: S'paskemi vlerë as sa bishti i këtyre dhive!...

Një person i njojur thotë se, me anë të reumatizmës, e ndjejnë shiun 48 orë përpara. Në fshatrat tona është i përhapur parashikimi i shiut dhe borës duke u bazuar në disa shenja. Mirëpo, të dish se do të bjerë shi me këto mënyra dhe kritere ose dimensione, nuk do të thotë se e njeh të fshehtën. Parashikimi i shiut me llogaritje të njoitura, i një shiu që është nisur përrugë me shenja sheshit si retë e ngarkuara, presioni atmosferik, frontet atmosferike, e me këtë dije të nisesh për të asgjësuar një argument, një konkluzion të Kurantit, kjo s'mund të jetë veçse një model injorance!

Gjithashtu, dua të flas për një deklaratë-mrekulli të Profetit (s.a.s.) që sot pranohet edhe nga kërquesit shkencorë. I Dërguari i Allahut urdhëron: Asnjë vit nuk është më me reshje si vitin tjetër. Nga kjo kuptohet se në sipërfaqe të tokës bie e njëjtë sasi reshje. Veçse nuk dihet se ku dhe sa. Ja, kjo është e fshehta dhe kjo nuk dihet.

Edhe specifika e tetë e treguar në ajet, është midis pikave që kundërshtohen: vetëm Allahu e di ç'ka në mitra. Thuhet se sot njihet gjendja e fetusit në barkun e nënës me anë të rrezeve roentgen. Madje, kohët e fundit, me njohjen edhe të seksit mashkull ose femër të spermës, mund të përcaktohet gjendja e fetusit edhe në këtë nivel.

Më sipër folëm për një rregull ose kusht. Ai është i vlefshëm edhe këtu. Të dish për diçka shkaqet e të cilës janë sheshit, nuk do të thotë se di të fshehtën.

Nëse është përcaktuar se sperma është mashkull, në çfarëdo forme që të jetë bërë prova, në mitër apo në inkubator, pasi të shfaqen shkaqet, kjo s'përbën njohje të së fshehtës. Midis deklaratave të ndritshme të Profetit (s.a.s.) zë vend edhe kjo specifikë: Po pati epërsi mashkulli, fëmija do të bëhet mashkull, po pati epërsi femra, fëmija do të bëhet femër. Disa këtë porosi, si pasojë e të moskuptuarit, e kanë kushtëzuar ndaj interpretimit dhe komenti të gabuar. Me fjalën mashkull kanë kujtuar burrin dhe me fjalën femër, gruan. Një epërsi e tillë s'ka asnjë kuptim. Ndoshta kuptimi duhet të jetë kështu: Nëse në vezë futet spermatozoidi mashkull, fëmija do të lindë mashkull, nëse futet spermatozoidi femër¹⁹, fëmija lind femër. Kjo është një porosi e pranuar si një nga mrekullitë diturore të Profetit dhe shkencëtarët e ditëve të sotme e pranojnë këtë çështje në formën siç është shprehur. Ata që e quajnë veten se dinë të vërtetën pse njohin një çështje pasi shkaqet e saj të jenë bërë kaq të qarta, gënjejnë vetveten.

Edhe Kurani i Madhnueshëm, kur e trajton këtë çështje, thotë kështu: *Ve jalemu mâ fil- erhâmi, Ai e di se ç'ka në mitra; fajla mâ do të thotë gjë, domethënë se në ajet flitet për një gjë e nuk thuhet se vetëm Ai e di në se është mashkull apo femër(!).*

Providencia Hyjnore, ashtu siç e di se fëmija është mashkull ose femër, di edhe gjithçka do t'i ngjajë në jetë atij²⁰, karakterin, dobësitë dhe aftësitë dhe ç'do të bëhet më në fund, i lartë, a i poshtë²¹. Ja pra, njohja e gjithë këtyre është e posaçme vetëm për Providencën Hyjnore. Ato që përbëjnë të fshehtat, përmblidhen në gjerësinë e kuptimit të fjalës gjë. Ato të fshehta s'janë vetëm të qenit mashkull apo femër. Kurani e sheh çështjen përgjithësisht dhe komplet. Po të dish ato që hyjnë në përkufizimin që bën ai, atëherë do të thotë se njeh të fshehtën. Pretendimet pas kësaj, quhen shtrembërim i çështjes²² dhe dialektikë.

Këtë temë mund ta përqasim mendërisht më tepër me një shembull të tillë. Ta zëmë se pate një dru molle. Rrënjet dhe trupi i pemës të jenë nga ana juaj, kurse degët dhe gjethet të jenë të varura në anë të kundërt, pas një pengese që t'i bëjë të padukshme ato. E tani, nëse ju në pranverë ngriheni e thoni se degët e padukshme janë plot me mollë, mos vallë me këtë konkluzion tregoni se njihni të fshehtën? Apo po lajmëroni për diçka që e dinë të gjithë? Po të përballeni me një gjë të tillë, sigurisht që do të thoni se trajtuat alternativën e dytë. Në të njëjtën formë, edhe njohja e gjendjes së fetusit në mitër me anë të vërtetimit të shkaqeve konkrete, përbën një njohje të atij nivelit cilësor e nuk është njohje e të fshehtës. Nuk është njohje e të fshehtës të dish për degët e padukshme të një peme me rrënjet dhe

¹⁹ Spermatozoidi mashkull, spermatozoidi femër: këtu nënkuptohen spermatozoidet me kromozomet X ose Y.

²⁰ Në origjinal: Segyzeshti (persisht), aventurë.

²¹ Në origjinal: Said, shaki (arab.).

²² Në origjinal: Çarpëtmak (turq.), të shtrembërosh, të deformosh, ta bësh vëngër (syn).

trungun të dukshëm. Të ngrihesh për të shkatërruar konkluzionin²³ e Kur'anit me supozime dhe pandehma, s'është veçse kokëtrashësi dhe budallallëk.

E katërta, njeriu nuk e di se ç'do të fitojë. Këtë duhet ta regjistrojë vetëm me fitimin material. Edhe përfitimi i kënaqësive dhe i favoreve materialo-shpirtërore, përbëjnë një fitim më vete. Edhe ato që një shkencëtar apo dijetar u shton njohurive të tij, janë një fitim dhe madhësinë e kësaj e gjer ku do të shkojë kjo, vetëm Allahu e di. Disa herë lexohen vëllime të tëra pa marrë asnje rresht njohuri, disa herë një rresht njohuri i përfton njeriut mendime dhe gjykime sa një libër dhe i shpërthen burimet e fryshtimit të njeriut.

Bashkë me këto që thamë, edhe sikur çështjen ta trajtonim vetëm në planin material, do të thoshim se, përfshi njerëzit me të ardhura fikse, askush nuk e di se sa do të fitojë nesër. Veçanërisht esnafi dhe tregtari e kanë krejt të pamundur ta dinë një gjë të tillë. Sa për ata me të ardhura fikse, ashtu siç mund të ndodhë që të ndikojë mbi të ardhurat e tyre papritmas ndonjë gjobë apo shpërblim, ashtu edhe një fatkeqësi ose një ngatërrësë që mund t'u bjerë në kokë, mund t'u shkaktojë ndryshime të papritura në të ardhurat. Po mund t'u vijë nga ndonjë mik një pako me ndonjë dhuratë të çmuar pa e pasur fare në hesap një gjë të tillë që gjer pesë minuta më përparrë nuk e prisnin. Ndoshta këtë pikë do ta shtjellojmë më tej me shembuj të tjerë, por, për të mos e zgjatur fjalën, po them vetëm sa thotë Kurani: **Askush nuk mund ta dijë se sa do të fitojë nesër**²⁴...

Dhe e pesta, ku dhe kur do të vdesë. Edhe këtë vetëm Allahu e di. Për të gjithë ne është i panjohur casti kur do të vijë personalisht vetë Azraili ose me anë të ndihmësit të tij, do të na dalë përparrë e do të na thotë: Erdhi koha.... Fundja, këtë askush s'e kundërshton....

7. Si duhet të jetë kuptimi ynë përvellazërinë? A mund të bëni një vlerësim me gjendjen ku ndodhemi?

Pa i hyrë temës, kërkoj të térheq vëmendjen për një specifikë:

Në përkushtimin ndaj Providencës Hyjnore të çdo gjëje, gjer te veprimet tona që i kemi pranuar si të vullnetshme ose të lira dhe të gjitha bëmat tona në emër të së mirës, është e domosdoshme të sillemi shumë të ndjeshëm. Në këtë subjekt, njeriu duhet ta bindë veten kundër nefsit, egos së tij. Duhet të jemi të matur, madje, edhe në pikat që në dukje ngjajnë si konkluzion i vetë lëvizjeve tona dhe duhet ta shpëtojmë veten nga të dhënit pjesë e egos, duke thënë: Jo, edhe këto i përkasin Atij. Se mos ngrihesh e ia kushton vetes! Çdo njeri që beson, duhet t'i shmanget çdo lloj politeizmi²⁵, madje, në këtë subjekt, është i detyruar të bëhet ziliqar. Në të vërtetë, Allahu i Madhëruar zemërohet kur dikush adhuron dikë tjetër veç Tij. Në praninë e tij, asnjeri nga veprimet e pakryera totalisht për Të, nuk kanë rëndësi e vlerë

²³ Në origjinal: Hukum (arab.), konkluzion, vendim i prerë, kategorik nga pikëpamja e terminologjisë filozofike, ajetet-argumente të Kur'anit, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me cilësitetë dhe atributet e Zotit dhe dogmën, janë konkluzione të nivelit të postulatit.

²⁴ Perifrazim i vetë autorit.

²⁵ Në origjinal: Shirk (arab.) Zotit

sa një krah mize. Që rëndësia dhe vlera e të gjitha shërbimeve të kryera të zënë vend në lartësinë e Allahut, nën çfarëdo vendi që të jenë bërë, duhen bërë kujdes principialitetit²⁶ si dhe marrja e miratimit të Tij. Kurse specifika e dytë ku duhet bërë kujdes, është që kuptimi që përmban pyetja, duhet të jetë i vazhdueshëm e i përhershëm, me cilësinë e diçkaje që jetohet...

Vëllazëria e nivelit të sakrifikimit për njëri-tjetrin, është një nga faktorët me ndikim më të madh në botën e jashtme. Krenimi me virtute dhe meritat e tjetrit dhe pranimi i tyre sikur të ndodheshin tek vetja, do t'i lidhte fort me njëri-tjetrin individët e bashkësisë²⁷ dhe, duke nxitur shpirtin e vrullit brenda vetes së tyre, duke u fryrë zotësive dhe aftësive në gjendje shkëndijash, do t'i shndërronte ato në thëngjij të ndezur dhe do të bëhej shkak për zbritjen rrëke të mëshirës hyjnore. Zemrës dhe shpirtit të kësaj bashkësie të shndërruar në një trup të vetëm duke u bërë një me njëri-tjetrin përmes marrëveshjes dhe besëlidhjes, do t'i zgjatet dora e ndihmës dhe e sigurimit të fitores së Providencës Hyjnore, e cila do ta kthejë bashkësinë gjithmonë nga pozitivja, nga e bukura, nga ana e drejtë, për pasojë, mundësia e gënjimit të saj do të zbresë në nivelin më të ulët. Për shkak të nijeteve, qëllimeve të pastra, ndoshta rastet e gënjimit do t'u sjellin mirësi, bekim atyre. Por është e pamundur të thuhet e njëjta gjë për ata që, ndonëse janë në të njëjtën vijë, ndodhen të shkëputur nga njëri-tjetri. Sidomos po të nxirrin krye shmangjet në vijë e, për pasojë, mospajtimet, do të hyhej në një rrëth vicioz, dalja prej të cilit është e pamundur. Kurse hyrja në rrëth vicioz, ashtu si njeriu që vrapon pasi i ka kthyer shpinën synimit të vet, në çdo hap që do të hedhë, do ta largojë ca më tepër nga qëllimi dhe synimi themelor.

Ata që i vunë shpatullat kësaj pune një kohë, qenë i Dërguari i Allahut dhe ithtarët pasues të tij²⁸. Atëherë, po ta vlerësonin këtë çështje brenda parimit të proporcionalitetit kauzal²⁹, do të thoshim se ata që do t'ia vinin supet kësaj pune përsëri, duhet të zotëronin të njëjtën vetëdije dhe konstitucion. Mund të mos jetë e mundur të përsëritet qenia e tyre përsa i përket cilësisë, mirëpo ne nuk duhet të harrojmë që ndodhemi në situatën ku bëmat e tyre mund t'i përsërisnim vetëm në raport me sa do t'u ngjanim atyre. E njëjta situatë vlen edhe për vëllazërinë. Forma dhe mënyra e kuptimit të vëllazërisë tek ata, si dhe caqet e suksesit ku i çoi ky kuptim vëllazërie, do të mbeten edhe për ne parime dhe përfundime të pandryshuara.

Personalisht, e lexoj jetën e ithtarëve pasues qysh në vegjeli. Ndoshta pas një periudhe fillova edhe të flisja për ta. Mirëpo disa herë e shihja me habi dhe mahni tablonë e vëllazërisë që përfaqësonin dhe e vlerësoja si diçka të posaçme vetëm për ta si dhe një utopi, sepse praktikimi i saj në ditët e sotme ishte i pamundur. Më vonë shembuj të tillë që pashë tek disa shokë, më krijuar bindjen e plotë se një gjë e tillë mund të ripërjetohet. Madje, disa herë, çka shfaqnin këta shokë për njëri-tjetrin, shembujt e sakrifikimit për tjetrin, ushtruan një ndikim të tillë tek të tjerët, saqë një i jashtëm i ardhur pranë tyre, duke vëzhguar me mahnitje këtë vëllazëri, të thotë me një ton plot habi: Aman, o Zot! Ç'vëllazëri është kjo? Këtë e pata dëgjuar vetë personalisht dhe ende kjo shprehje me atë ton të ëmbël ruan freskinë e saj në kujtesën time. Natyrisht, kjo më gjëzoi jashtë mase. Por është e pamundur që këtë heroizëm ta gjejmë të mjaftueshëm së bashku me pohimin dhe nënshtrimin. Në këtë subjekt duhet të jemi ndër ata që vërtiten në rrëthin e urisë së pangopur. Sepse kjo vetëdije vëllazërie që mund të jetë e mjaftueshme për sot, nesër, përballë pengesave të mëdha ose të një reliivi të përthyer që ka mundësi të na ngulen përpara, mund të mos jenë në madhësinë e duhur për të na bërë t'i kapërcejjmë ato.

²⁶ Në origjinal: Ihlas, pastërtia, principialiteti i konceptit mbi Allahun.

²⁷ Në origjinal: Xhemaa: shih në fund të librit

²⁸ Në origjinal: As'habe.

²⁹ Në origjinal: Enasubu il'lje (arab.)

Lirimi i skllavit është një e përpjetë e vështirë³⁰ do të bënim një vlerësim në dimensione të gjera të skllavërisë që, me konceptin e sotëm konsiston në robërimin e njerëzve nga ana ideologjike dhe e sistemeve të ndryshme që zgjatet gjer te njerëzit e blerë, do të kuptohej më mirë, gjithsesi, se ç'pengesë, ç'ngjitet e vështirë e ç'majë është lirimi i robit, i skllavit.

Përkundër qenies vetë në vështirësi dhe shqetësim, parapëlqimi i vëllait në vend të egos vetjake, është, në vetvete, një lloj e përpjete e vështirë. T'i njohësh, t'u japësh përparësi vëllezërve edhe në ndjenjat e begative materiale e shpirtërore dhe të pranosh si detyrë tërheqjen pas përveten tënde, është një pengesë tjeter dhe një e përpjetë e vështirë para njeriut. Edhe kapercimi i kësaj pengese kushtëzohet nga sjellja si sahabet, pasuesit. Si ai pasuesi që, përvësia ngopur vëllanë e tij, e fuste lugën bosh në gojë e, që të mos kuptohej kjo, e shuanë qiriun duke e lënë dhomën në errësirë, që t'i linte të mahnitur edhe engjëjt në qiell para kësaj tabloje shpirtërisht të ndritshme. Dhe prapë si ai pasuesi që duke u përleshur me vdekjen në çastet e fundit, ujin e sjellë gjer te buzët e dridhura nga malli i një pike, do ta shtynte me orë duke i bërë shenjë njeriut që i kishte ardhur në ndihmë, përvësia vëllai aty pranë tek po thoshte ujë! Ashtu që të bëhej shkak përvësia revelacionin e mesazhit hyjnor: Megjithëse vetë janë nevojtarë, parapëlqejnë vëllain ndaj vetes...

Edhe ushqimi i jetimit është një e përpjetë e vështirë. Duke u zgjatur tutje me krahët e figuracionit, do të na dalin edhe sa e sa kuptime... sa e sa jetimë të një lloj vërtetë pasuar nga dukuria e privimit prej kulturës islame..., ja pra, përgatitja e çerdheve dhe e konvikteve përvësia këta, kapja përvësia dore dhe kërkimi i rrugëve përvësia t'i nxjerrë në majën e përsosjes dhe ushqimi i tyre në kahjen e këtij qëllimi, është edhe kjo një e përpjetë e vështirë dhe me majë më vete...

Objektivi që synova në këtë subjekt ku hymë, në pikëpamje të të qenit orientim vetëm përvështirësinë që mund të na ngulet përpëra, është ky: Sot kemi një vëllazëri që mund të duket si e mjaftueshme. Mirëpo, përballë kushteve në vështirësim e sipërvësia dhe në raport me shërbimin që po përhapet e zgjerohet, kemi vazhdimisht nevojën e ndjenjës së një vëllazërie që rritet edhe më. Ndaj dhe kontributi ynë duhet të jetë përherë e më i madh dhe duhet të themi vazhdimisht: S'ka tjetër?

8. Ç'thotë feja në lidhje me pyetjen e më të madhit, udhëzimit të të cilit i besojmë e të cilin e dëgjojmë, përvësia gjitha çështjet tona? A duhet ta pyesim atë përvësia, mbathjen e gjer përvësia pajisjet që marrim përvësia shtëpitë tona?

Çështjet tona nisin në vijën e besimit, vazhdojnë në rrugën e adhurimit, lartësohen në aktet dhe veprimet tona e pastaj zhvillohen në trajtën që do t'i përfshinte sjelljet dhe zakonet tona personale dhe ne jetojmë një jetë shumëdimensionale, ku secili dimension përbën një thellësi më vete. Është krejt normale që në të gjitha këto e në ato që s'dimë, të ndjejmë nevojë përvësia këshillë e udhëzim.

³⁰ Në original: E përpjetë, kalim i vështirë, hon, etj. Në të shumtën e rasteve përdoret me kuptimin e përpjetë e vështirë. Autori e përdor këtë fjalë duke vazhduar figuracionin e nisur pak më sipërvësia me relievin e përvësies.

Para nesh, në kuptimin dhe rrrokjen e thelbit të fesë e në sjelljen e saj në gjendje të jetueshme, ndodhet krenaria e njerëzimit, Profeti i të Dy Botëve! Edhe në këtë çast gjithashtu, na duket sikur ndjejmë e shohim mbi krye kompleksin shpirtëror të tij që na flet për qetësi! Kurse në zemrat e ndriçuara kjo veçanti ekziston në vazhdimësi si një fatmirësi e përhershme!

Pas të Dërguarit të Allahut, pothuaj në çdo shekull, pavarësisht prej veprimit rrafshues të kohës dhe ngjarjeve, kanë dalë ca njerëz të mëdhenj të cilët, me duart e tyre të nurshme, kanë fshirë e hequr ndryshkun dhe, duke e ringjallur fenë, e kanë rivënë në shesh shpirtin Muhamedan me tiparet e tij origjinale. Kjo punë, themelet e së cilës janë vënë me sahabet, shokët e Profetit (a.s.), me Ebu Hanifenë dhe njerëz të tjerë të lartë si ai, ka fituar një dimension të ri dhe pastaj, duke u rinuar çdo radhë me emra të tjerë si Gazali, Imami Rabbani, Abdulkadir Gejlani, Mevlana Xhelaleddin Rumi dhe halleshumi i shekullit tonë, Said Nursi, e ka ruajtur vazhdimisht aktualitetin dhe freskinë e vet. Ja, pra, në sajë të atyre duarve të nurshme ne i gjetëm krejt të freskëta dhe krejt të kthjellëta të gjitha çështjet islame gjer në hollësitë më të imta edhe në shekullin tonë, madje, pavarësisht pas kaq kohësh e pas kaq andrallash. Lavdia dhe falenderimi i pafund janë të posaçëm vetëm për Allahun që nuk na la larg favorit të Tij dhe jashtë vullnetit tonë e pamë veten në krye të një oazi të tillë drite e bukurie! Fakti që jemi zgjedhur ne ndërsa jashtë ka njerëz më të përshtatshëm se ne, është vetëm argument i mirësisë dhe bujarisë së Zotit e jo meritë e denjësi e jona. Pothuajse dhe shokët që me pretekste të vogla kanë hyrë në brendësi të kësaj pune, pandeh se ndajnë të njëjtin opinion me mua. Gjer më sot na janë treguar shumica e gjërave të domosdoshme për sot e për mbas sodi. Paraardhësit i ndriçuan rrugët e pasardhësve në një formë që nuk do të linte hapësirë për lëkundje. Kështu që në këtë rrugë të ndriçuar ne na mbetet vetëm të ecim.

Shembujt më duhet t'i jap nga subjekti për të cilin u pyeta. Për shembull, të gjitha aspektet në lidhje me ushqimin, shtrimin dhe rregullin e shtëpisë na janë treguar në mënyrë praktike. I Dërguari i Allahut flinte mbi një rrogoz që linte gjurmët e veta mbi trupin e tij të bekuar. Hz. Ebu Bekri, pasi pi një gotë ujë të ftohtë që ia sjellin, nis të qajë dhe, kur e pyesin për shkakun, thotë se i qe kujtuar se një ditë do të jepte llogari për të gjitha të mirat nga të cilat përfiton. Omeri i Madh, kur e bija i propozon të veshë një rrobë më të mirë, e qorton ashëpër pa marrë parasysh se ajo tashmë ishte bashkëshortja e Profetit! Një filozofi e tillë jete e ardhur gjer në ditët tona në trajtën e mijëra shembujve, me Hallemadhin e Shekullit tonë, me hallemëdhenjtë e tjerë e me ata që ecin në rrugën e tyre, edhe një herë të fundit përfaqësonte një përpjesëtim të saktë botë-amshim, një drejtpeshim të plotë trup-shpirt duke u rikujtuar edhe një herë tjetër...

Sa për ne, nuk mund të thuhet se e kemi përvetësuar me të tëra këtë thjeshtësi. Meqë mbrojtja, duke ruajtur masën për të mos u dukur e huaj, duhet të jetë pika më e fundit e lëshimit, kjo masë përdoret në fillim të çështjes. Disa herë gënjehemë dhe pandehim se do të ndikojë pozitivisht mbi bashkëbiseduesin. Mirëpo thjeshtësia jonë është në pozitën e dëshmitarit më të madh të vullnetarizmit tonë dhe pikërisht ajo do të ndikojë mbi bashkëbiseduesin. Njëherë, kur nuk e prisja, unë e pashë vetë një gjë të tillë dhe nuk e parashikoja se do të bënte një vlerësim të tillë, kur dikush u shpreh kështu mes njerëzve të shtresës intelektuale, duke e treguar si argument për bindjen rrogozin në shtëpinë e personit që rekomandonte: "Besojini dhe bindjuni këtij shoku. Sepse unë në shtëpi të tij pashë vetëm një rrogoz, edhe atë me vrimë në mes!" Ashtu siç nuk qe e mundur të rriteshim në madhështi e luks që s'njeh kufij, ashtu edhe nuk pandeh se do të ndodhë që t'i përftojmë ndonjë gjë shërbimit tonë në atë rrugë. Mund ta përdorim masën për të mos u dukur i

huaj vetëm si justifikim, edhe kjo gjer në një periudhë të caktuar se është e pamundur ta shohim të lejueshme për më tej.

9. A bëhet fjalë për ndryshim niveli mes emrave dhe atributeve të Zotit? A mund ta shpjegoni?

Po qe se emrat tanë do t'i merrnim jo duke na i vënë prindërit, por sipas mjeshtërise që do të përftonim më pas, kur të rriteshim, dikush do të quhej "Furrtar" ose "Bukëpjekës", dikush tjetër "Marangoz", etj.

Mirëpo emrat tanë na jepen jo sipas mjeshtërise që do të fitojmë më vonë, kur të rritemi, por sipas dëshirës së prindërve. Madje, nganjëherë, ndodh që të na vihen emra krejt të papërshtatshëm ose që s'kanë të bëjnë fare me ne.

Një paralelizëm i tillë me çështjen e emrave të Zotit, në pamje të parë mund të duket vulgar dhe i padëshirueshëm. Por ç'e do që për parashtrimin e të vërtetave abstrakte që në krye të herës është përdorur e njëjtë rrugë, konkretizimi dhe zbritja në nivelin e gjërave të thjeshta e të kuptueshme.

Emrat që i përkasin Zotit janë emra të vënë në përputhje me vëzhgimin tonë të akteve të Zotit në gjithësi, si dhe që na janë mësuar prej Tij përmes robërve të Tij të zgjedhur. Për shembull, në gjithësi ka një bukuri të përgjithshme që ne e shohim krejt hapur. Bukuritë, si të ishin një ylber, e kanë rrethuar ekzistencën gjithandej, ato janë në vetë ekzistencën. Në fushë e në mal, në lule e në pranverë, në sy e në vetull një valle bukurie sundon! Ka mijëra vite që mijëra poetë e shkrimtarë, duke parë vetëm shfaqjen e jashtme të këtyre bukurive, janë përpjekur, me anë të fjalës, të shprehin mahnitjen e vet e t'i legjendarizojnë ato, megjithatë, në raport me ç'mund të thuhet, prapë se prapë kanë mundur të thonë fare pak! Sigurisht, të gjitha bukuritë që nuk do t'i mbaronim dot së treguari, mbështeten në një emër të Zotit që e shpreh këtë realitet e që është "I Bukur".³¹

Gjithashtu, në gjithësi, brenda një rregullsie të hollë, bëhet një ndarje *racionesh*. Nga njëqelizori e gjer te rinoceronti, çdo gjallesë ushqehet me një *racion ushqimor*³² të përshtatshëm për të në lloj e në cilësi. Ndërsa adhurimet dhe refrenet³³ janë caktuar si ushqim për engjëjt, mishi është caktuar për njeriun, kurse kockat për xhindët. Ja, pra, kjo veprimitari ushqyesë për gjallesat, që e shohim me sy, vërteton emrin "Ushqyes" të Zotit.³⁴

Po qe se nuk do t'i dinim emrat "I Bukur" dhe "Ushqyes" të Zotit, pasi të shihnim veprimitarinë e Tij, do t'i drejtoheshim duke i thënë Ti je I Bukur, Ti je Ushqyes! Po kështu, edhe për emrat përkatës të veprimitarive të tjera. Por Zoti, pasi na ka treguar veprimitarinë e gjerë të Tij, për të na shpëtuar nga një lajthitje e mundshme, na i ka prezantuar vetë emrat e Tij. Kështu që emrat hyjnorë janë të caktuar dhe të dhënë një herë e përgjithmonë. Ne nuk mund të sajomë nga koka jonë emra për Individualitetin e Lartë!

³¹ Në origjinal: Xhemil.

³² Në origjinal: Rizk.

³³ Në origjinal: Tesbih, përsëritja e emrit dhe e atributeve të Zotit si një formë adhurimi e lartësimi për Të.

³⁴ Në origjinal: Rezzak.

Këto emra tek Zoti mbështeten, bazohen në atributë të caktuara nga të cilat lindin veprimitari të caktuara, sipas të cilave Zoti merr emra të caktuar. Duke iu rikthyer paralelizmit që bëmë në krye, nëse dikush nuk zotëron aftësinë për të punuar drurin apo dërrasën, përgjithësisht lëndën drusore, pra, aftësinë e marangozit, nuk mund të quhet "marangoz", etj.

Emri "I Bukur", që e pranojmë tek Zoti, i Cili e ka ngulitur këtë me bukuri të panumërtë në fytyrën e gjithçkaje e që disa njerëz të një niveli të lartë të caktuar janë në gjendje ta vëzhgojnë tek Ai, bazohet në atributin "Bukuri"³⁵ që është burimi i të gjitha gjërave dhe tipareve të bukurë.

Po kështu, të gjithë emrat mbështeten në atributë nga burojnë ata emra, kurse atributet mbështeten në Fenomenalitetin Hyjnor³⁶, që mund të vihet në analogji me mundësitë (kapacitetet), dhunitë dhe talentet e njeriut, analogji kjo që, në fund të fundit, është sa për lehtësi shpjegimi dhe jo e drejtë. Ndërsa emrat mbështeten në atributet dhe këto në Fenomenalitetin Hyjnor, ky mbështetet në Individualitetin e Zotit. Këtu ndalemi dhe, ashtu si i Dërguari i Allahut, themi: "Nuk të njohëm dot ashtu siç është e vërteta, o i Gjithëditar!" Dhe themi, po si Hz. Ebu Bekri, "Të jesh i paaftë për të të kuptuar Ty, do të thotë të të kuptosh Ty!" dhe përkulemi më dysh me drojë e edukatë!

Ai ekziston. Dhe ne e ndjejmë ekzistencën e Tij gjer në palcë! Por jemi të paaftë për ta perceptuar dhe njohur Atë. Nuk ka diçka që të jetë më i qartë se Ai, por Ai prapë është një qenie e panjohur!

10. Cilët janë profetët e Vendosmërisë³⁷ së Epërme dhe pse u është dhënë vetëm atyre ky emër?

Megjithëse nuk ka lidhje me temën tonë, dëshiroj vetëm të shënoj një ajet që na kujton³⁸ fjala vendosmëri. Shprehjes në formën *Atë s’ë gjetëm të vendosur* të ajetit përkatës (Taha, 110) mbi personin e Hz. Ademit, disa nga komentuesit (e Kuranit) i kanë bërë një koment të kësaj forme: nuk e gjetëm të vendosur për të mos hyrë në mëkat. Personalisht, nuk do ta pranoja një koment të tillë për një profet. Nuk më bën zemra ta pranoj një kuptim të tillë. Mua më vjen më me vend të komentojmë kështu: Ai hyri në mëkat pa e ditur, pa e planifikuar dhe vendosur që më parë. Për këtë nuk pati as edhe vendosmëri në kuptimin e këmbënguljes...

Sa për profetët e Vendosmërisë së Epërme, këta përshkruhen kështu në Kuranin e Madhnueshëm: Kujto se një kohë patëm marrë fjälë nga profetët: nga Sen-i, nga Nuhu, nga Ibrahim, nga Musai dhe nga Isai, biri i Merjemes... Prej tyre morën një fjälë të fortë. Me Sen nënkuptohet Zotëria i Zotërinjve, Hz. Muhamedi (a.s.), të tjerët janë Hz. Nuh (a.s.) Hz. Ibrahim (a.s.), Hz. Musa (a.s.) dhe Hz. Isa (a.s.).

Çdo profet është profet, por, në tregun e këtyre, çdo gjë është tepër e shenjtë dhe këta kanë kaluar nëpër prova tepër të vështira. Po qe se do të shqyrtoheshin mirë e mirë tregimet moralizuese³⁹ të Kuranit për këta profetë, do të kuptohej shumë mirë se përse thuhet për ta të vendosur. I Dërguari i

³⁵ Në origjinal: Xhemal.

³⁶ Në origjinal: Shuanat-i Ilahije.

³⁷ Në origjinal: Ulu'l-adham, zotëruesit e vendosmërisë së epërme, zotëruesit e seriozitetit dhe durimit, personalitetet e lartë; këtu, profetët.

³⁸ Në origjinal: Është përdorur fjala tedâi (arab.) që do të thotë të kujtosh diçka me anë të diçkaje tjetër. Shih tedai-i eskar: shoqërim idesh, asociacion.

³⁹ Në origjinal: Kissâ

Allahut (a.s.) jo vetëm që pranoi e iu nënshtrua çdo lloj mundimi e vuajtjeje të ushtruar mbi të, por nga goja e tij nuk pati dalë qoftë edhe një fjalë e vetme me kuptim ankesë apo që do të shprehte kritikë ndaj kaderit, fatit të vet. Vjen fitimtar Bedri, por Uhudi i hipën menjëherë si mal mbi supe. Duke u kthyer nga Uhudi, pasuesit që shkaktoi disfatën për shkak se nuk kishte përvetësuar mirë edukatën e të dëgjuarit të fjalës, nuk i hedh as edhe një fjalë në të cilën do të ndihej sadopak poshtërim. Rënia dëshmon e Hz. Hamzait e kishte acaruar keq, por ai kishte ditur edhe në këtë rast të groposte ankthin në zemër.

Ai ka një shqetësim, hyrjen e njerëzve në udhën e drejtë. Është shumë i dëshiruar në këtë çështje. Aq sa ka arritur në një gjendje që do ta shkatërrojë veten drejt këtij synimi. Ajeti ia tërheq vëmendjen kështu atij: Duke menduar se këtë Kuranin s'po e besojnë, nga mërzitja, gjithsesi, do ta shkatërrosh veten. (Kehf, 6)⁴⁰. Dhe na e paraqet atë në një tablo të tillë.

Ai jeton vazhdimisht në horizontin e konsumimit të plotë të vvetesës në synimin drejt së vërtetës. S'kanë të bëjnë me të zemërimi, hidhërimi ndaj dikujt ose diçkaje. Në pikën e durimit të çdo gjëje që i bie në kokë, ai me vendosmëri qëndron.

Për vite me radhë po qëndis një copë; vjen një dorë e panjohur dhe e bën copë-copë atë qëndismë... kurse ai, pa u ankuar aspak, fillon e qëndis nga e para...

Në thelb, kjo veçori është një cilësi e përgjithshme e profetëve. Vetëm se profetët, ashtu siç nuk janë të gjithë të një niveli, po ndryshojnë edhe për nga fatkeqësitetë dhe shqetësimet që u ranë mbi krye. Ata s'janë të njëjtë edhe për nga bashkësia që udhëhoqën.

Në këtë specifikë, sa kuptimplotë është një pamje që i Dërguari i Allahut pati mirësinë të sqarojë. Hapet perdja e të panjohurave dhe i tregohen Atij të gjithë profetët. Vazhdimin le ta dëgjojmë nga buzët e tij të bekuara me këto fjalë: Pashë profetë të tillë pas të cilëve nuk kishte qoftë edhe një ndjekës të vetëm. Pas disa të tjerëve qëndronin katër-pesë njerëz. Pashë tek po vinte një shumicë njerëzish. Dhe pyeta: Kjo është bashkësia ime? Jo, më thanë. Kjo është bashkësia e Musait. Pas pak, pashë një grumbull shumë më të madh njerëzish dhe mora lajmin se ata ishin bashkësia ime.

Mendoni: një profet përpinqet e lodhet një jetë të tërë dhe vdes pa mundur të gjejë qoftë edhe një fytyrë të njohur që do ta kuptonte. Disa i bëhen zotër një bashkësie vetëm prej disa vëtësh. Po të viheshim në provë në këtë mënyrë, nuk pandeh se do të mund të ngrinim krye. Hz. Ibrahim sillet me duar të lidhura për t'u hedhur me katapultë. Pas pak do të hidhet në zjarrin e tmerrshëm me flakët që zgjaten drejt qiellit si dallgë oqeanike. Engjëlli kërkon leje dhe përpinqet ta ndihmojë. Mirëpo ai, duke mos u shmangur asnjë grimë nga përkushtimi i tij, thotë: Allahu më mjafton, ç'dorëzanës i mirë që është Ai!

Hz. Nuhu, në përfundim të përpjekjeve që vazhdojnë me shekuj, mezi hipën në anije me një grusht njerëzish, duke mos mundur të marrë pranë as të birin e vet. Sa pamje mbresëlënëse për një baba që bart shpirt profeti! Ne e kemi tepër të vështirë ta kuptojmë këtë, madje të pamundur!

Hz. Mesih është ende tridhjetë e tre vjeç kur duan ta vrasin. Po të zgjasë kokën jashtë, do të shohë shpatat e mprehura për ta copëtar. Por ai qëndron vendosmërisht aty ku është dhe s'lëkundet qoftë edhe për një çast të vetëm!

⁴⁰ Interpretim i vetë autorit

Po, ata janë kapacitete të epërme të zgjedhur ndër njerëzit e merituar për të fshehtën Allahu jastafi...⁴¹ Ata janë si kajmaku në qumështin e poçes që qenies që e zjeu Allahu me mëshirën dhe bamirësinë e Tij. Fuqia dhe Vullneti i Providencës Hyjnore në këtë mënyrë është shfaqur tek ata. Përkushtimi i thellë dhe vendosmëria që s'njeh zbehje, janë nga vetitë e tyre të pandara. E për këtë u është thënë atyre Vendosmëri e Epërme. Sipas nivelit, tek çdo profet dhe prijës ka vendosmëri. Kurse ata që ndodhen në pikën më të lartë të këtij virtuti të bashkëlindur⁴², janë profetët emrat e të cilëve sapo i përmendëm.

11. A mund të na tregoni se si duhet t'i mbrojmë besimtarët përballë veprimit shkatërrues të frontit të mohimit?

Qysh prej Hz. Ademit e gjer në ditët tona, mohimi ka mbajtur vazhdimisht pozicionin e shkatërrimtarit, kurse besimtarët kanë marrë përsipër vazhdimisht detyrën për të meremetuar dhe rregulluar. Po kështu vazhdon edhe sot. Prandaj edhe i Madhi i Kohës, i cili e ndjente këtë dhimbje gjithmonë e më thellë në ndërgjegje, ka thënë: "Po qe se do të kishte një ekuilibër midis këtyre dy forcave dhe që të dyja do të kishin në dorë të njëjtat mundësi, në frontin tonë do të shihej një fitore e madhe."

Gjithçka që ka fronti përballë, është një veprimitari destruktive. Duke fshikulluar botën ndjesore të njeriut, e ka rrokullisur atë në gropën e epshit; duke nxitur dëshirat dhe kërkesat e njeriut, e ka bërë atë rob të gjérave materiale, të botës materiale. Duke u dhënë lustër postit dhe pozitës, i ka treguar ato para njeriut si shumë tërheqëse, ia ka turbulluar atij shikimin, ka bërë shumë shkatërrime me mjete të thjeshta dhe ia ka prishur ekuilibrin mendor një rinie të tërë. Po qe se të gjitha gjërat do të kryheshin po kaq lehtë edhe në anën tonë, si përgjigje të kaq shumë përpjekjeve, do të arriheshin suksese të mëdha. Mirëpo ne kemi shekuj që s'bëjmë tjetër veçse merremi me meremetimin e një kalaje, një kalaje mjaft të madhe me mure të rrëzuar në të katër anët!

MENDONI SE NË KËTË VEND, MADJE NË TËRË BOTËN ISLAME, JANË TRONDITUR THEMELET E BESIMIT, E BESIMIT MONOTEIST NË NJË ZOT TË VETËM. ALLAHU ËSHTË MOHUAR, PROFETI ËSHTË NËNVLEFTËSUAR, FEJA ËSHTË LËNË ME TË TËRA, KURANI, KY TUFAN DRITE QË KA NDRIÇUAR GJITHË NJERËZIMIN E QË I KA DETYRUAR EDHE KUNDËRSHTARËT TA PRANOJNË MREKULLINË E TIJ, ËSHTË MARRË NËPËR KËMBË, FESË S'I KA MBETUR POHUAJ ASNJË RËNDËSI AS EDHE PRANË NJERËZVE QË KANË BESUAR DHE ÇDO GJË ËSHTË KATANDISUR NË ATË GJENDJE QË DUKET SE S'MUND TË RREGULLOHET MË. JA PRA, NË NJË PERIUDHË TË TILLË, EDHE PUNËT QË DUHEN BËRË JANË SHUMË TË MËDHA, EDHE VLERA E TYRE ËSHTË SHUMË E MADHE. ANA PËRBALLË HEQ NJË GUR NGA POSHTË DHE TËRË MURI SHEMBET, KURSE NE JEMI TË DETYRUAR QË TA NGREMË RISHMI NË KËMBË MURIN GUR PAS GURI DHE, SIDOMOS, TA MBROJMË ATË. MEGJITHATË, KRAHAS KËTYRE, MUND TË THEMİ SE BIE NË SY EDHE DORA E NDIHËMËS DHE E FAVORIT HYJNOR. KJO GJË PO MË KUJTON DIÇKA NË LIDHJE ME PASKALIN. PASKALI KA QENË NJERI I NDJESHËM, POR I PAFAT. SIÇ THOTË NJË MENDIMTAR I YNI, AI "E KA HUMBUR VAPORIN NË ÇASTIN E

⁴¹ Allahu jastafi... (arab.) Allahu zgjedh

⁴² Në origjinal: Haslet.

fundit”! Është afruar gjer në limanin e Hz. Muhamedit (a.s.), por nuk ka mundur ta lëshojë veten në atë prehër drite. Por kjo është temë më vete. Kurse unë kërkoj të përdor për ilustrim një ngjarje që i ka ndodhur atij e që ka lidhje me çështjen për të cilën po flasim.

Paskali tregon vetë se si, ulur në një pajton, po shkonte drejt lumbit Ren. Një çast dhe kuajt kishin këputur frerët, kishin dalë nga kontrolli dhe kishin filluar të vraponin me shpejtësi. Shpëtimi i ishte i pamundur. Pajtoni do të rrokullisej detyrimisht në lumë. Por papritur ndodh diçka. Kuajt shkëputen nga pajtoni dhe fluturojnë në lumë. Në saj të një dore hyjnore, ai dhe pajtoni qëndrojnë mu në buzë të lumbit!

Paskali që pati bërë gjer atë ditë një jetë boshe, pas asaj ngjarjeje mbylljet në një manastir ku e kalon tërë jetën e mbetur duke parë e menduar si një murg.

Sa për ne, ne kemi përjetuar me qindra ndodhi ku kemi parë favorin e asaj dore hyjnore që pati parë vetëm një herë në jetën e tij Paskali. Falenderime të pafund i drejtojmë për këtë Zotit tonë!

Ndërsa ata përpiken ta shkatërrojnë rininë me baret, me diskot, etj., ne u themi të rinjve që të falen, të agjerojnë, të sakrifikojnë disa dëshira të egos; ne u propozojmë atyre disa gjëra që në pamje duken të vështira, si: të jetojnë jo për vete, por, së pari, për mjedisin e tyre dhe të mendojnë, gjithashtu, jo për vete, por për brezat që do të vijnë. Megjithë veprimtarinë antimorale të frontit të mohimit, shohim me miratim dhe kënaqësi se si mijëra të rinj po u dalin për zot me gjithë zemër çështjeve islame, nderit, moralit, figurës së pastër të njeriut. Ashtu siç nuk na besonin dje kur flisnim për ata faktorë negativë që karakterizonin jetën ideologjike e moralo-shoqërore në Rusi e Kinë, faktorë që çuan në shkatërrimin e atij sistemi, ashtu edhe sot po bëhemë dëshmitarë për faktorë që shërbejnë si shkaqe për ndryshime të mëdha. Fronti i mohimit, megjithë institucionet, mjetet dhe mundësitë që ka në dorë për të shkatërruar vlerat më të mira kombëtare të çdo vendi, të trashëgura brez pas brezi, po pëson rënie të shpejtë, kurse ne po ngjitemi me shpejtësi lart. Në një të ardhme të afërt, morali islam do të zëré vendin e merituar.

Në fakt, ne duhet të bëjmë atë që na bie për barrë. Mbrojtja e brezit është diçka që i përket Zotit. Duke shpresuar në mëshirën e Tij të pasosur, lutemi që të na e mbrojë brezin e ri të rritur me një mijë e një mundime dhe të mos i lërë kafshët grabitqare të na hanë zogjtë e porsalindur. Fundja, po që se s'do të na ishte zgjatur dora e favorit të Tij, punët që janë kryer, s'janë të tillë që do të na i rrokte mendja jonë. Po, Ai na ndihmoi e na favorizoi dhe ne e pamë veten në drejtime që nuk i kishim njohur më parë. Vetëm më vonë e patëm kuptuar se pikërisht në ato drejtime ishte dashur të punohej. Lutemi e falemi që ajo ndihmë e ai favor që na u gjendën në fillim, të na shoqërojnë gjatë gjithë punës sonë!

12. A na tregoni për përpjekjet dhe zellin e Profetit dhe myslimanëve të parë për shpëtimin e besimit të të tjerve?

Kjo është një nga specifikat që duhet shpjeguar si një temë krejtësisht më vete, të cilën jam përpjekur edhe më parë ta paraqes në formë të pjesshme, veçanërisht duke u përqendruar në aspektin e sahabeve në lidhje me këtë temë. Në fakt, unë jam nga ata që e pranojnë se dhënia e nja dy shembujve prej sahabeve në çdo bisedë, fjalim dhe shkrim, është shpirti dhejeta e temës përkatëse. Për mua, sahabet janë kriter dhe unë të gjitha konkluzionet i jap në raport me ngjasimin

me ta. Gjatë gjithë jetës sime i pranova si nëpunës trafiku në rrugën e dritës. Dhe besova se në një rrugë ku ecet me simbolet dhe shenjet e tyre, arrihet në portën e njeriut më të madh si intelektual. Dhe, me sa pata mundësi, këtë mendim e bëra synim final të jetës sime. Po qe se duhet që edhe besimtarët t'i vlerësojmë sipas një klasifikimi të tillë, ua kam shprehur gjithmonë shokëve të afërt dhe miqve t'ia hyjnë një klasifikimi të tillë duke e pranuar si kriter afërsinë apo largësinë ndaj tyre. Kush e di se sa herë e kanë rrahur në shpirrat e tyre lexuesit e këtyre rreshtave këtë temë të treguar e të stërtreguar, duke arritur t'i njohin ata në nivel shumë të përparuar. Krahas pranimit të kësaj, meqë u pyeta, po përpinqem të them ca gjëra me urimin që t'i vlejnë çështjes.

Së pari, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), pastaj edhe sahabet, shokët e tij, qysh kur në shpirtra iu tharmua ideja e besimit dhe e fesë, e bënë qëllim dhe ideal të jetës t'u flasin të tjerëve për çështjet fetare, ta fusin fenë dhe besimin në jetë dhe, në këtë rrugë, t'i çojnë njerëzit në shpëtim. Fundja, po qe se nuk ka shërbim ndaj besimit dhe fesë, edhe jeta, edhe qenia në jetë nuk ka kuptim. Si përfaqësues dhe zëvendës të Allahut mbi tokë, ne jemi të detyruar të ndërhyjmë në të gjitha ndodhitë me ndjenjën dhe mendimin fetar. Nëse një ujë rrjedh nga lart poshtë dhe feja na urdhëron ta bëjmë të rrjedhë nga poshtë lart, ne jemi të ngarkuar me përgjegjësinë për t'u përpjekur gjersa të bëhet ashtu siç na urdhëron feja! Ja pra, nëse mundemi ta kuptojmë këtë përgjegjësinë tonë, do të thotë se ekzistanca jone e ka një urtësi dhe jeta jonë e ka një kuptim. Në të kundërt, jeta jonë është e kotë dhe ekzistanca jonë është e panevojshme.

Kjo vetëdije dhe ky mendim ndodheshin te Profeti në nivelin më të lartë. Në disa vende të tij, Kurani, edhe për t'ia tërhequr Profetit vëmendjen, edhe për të na bërë të shohim pozitën e tij të lartë, na parashtronte ajete që fillonin me fjalën pyetëse "feleal'leke, a mos" (Kehf, 6; Shuara, 3). "A mos do ta shkatërrosh veten? A mos do ta vdesësh veten?" Ngrihesh në mëngjes dhe sheh fytyra që s'besojnë, bie të flesh dhe përfytyrimet e tyre të dalin para syve dhe ti, i dëshpëruar nga mungesa e lidhjes dhe komunikimit me njerëzit, mblidhesh kruspull e përpëlitesh në ankth. Ndërkaq, e harron jetën tënde të lartë dhe pothuaj vjen në një gjendje vetëvrasjeje. Ngaqë njerëzit nuk marrin formë sipas këtyre fjalëve të larta e sipas përbajtjes së tyre ndriçuese, rënkon pa pushim, dëshpërohesh dhe përpëlitesh aq sa duket se do të shkrihesh si qiri..." Këto fjalë përshkohen nga kuptimi dhe porosia dhe, njëkohësisht, nga një konsideratë serioze dhe e lartë: "Lërja punën kaderit dhe dorëzoju Allahut dhe mos e mundo aq shumë veten!" Këtu duket sikur kërkohet të thuhet kështu: "O Profet! Ti ke një shpirt të lartë. Në të ardhmen ky shpirt do të kthehet në një burim të tillë që çdo njeri do të vrapijë te ai për të pirë sa të ngopet e për ta mbushur enën e vet. Prandaj, duro në emër të asaj dite të madhe e mos e mundo shumë veten. Ti duhesh. Ti bëj detyrën tënde dhe mos u përzje në punën e Zotit..." Dhe kushedi sa kuptime të tjera shprehin këto ajete, mendime që ne nuk mundemi t'i rrokim, kurse ai mundte...

Edhe nga kjo konsideratë e lartë e Zotit për Profetin, kuptojmë se gjithë halli dhe vuajtja e Profetit ishte t'ua tregonte njerëzve të vërtetat e larta që kishte sjellë. Si një re e ngarkuar me shi, ai ndodhej vazhdimisht i mbushur me këtë hall. Megjithëse ishte si i dehur me shfaqjet e Zotit, unë nuk mund ta përdor këtë figurë për një profet, por po të ishte fjala për ndonjë tjetër, do të thosha: "i dehuri i kësaj dëshire"! Asnjë çështje tjetër nuk afrohej apo ftohej në horizontin e tij veç kësaj kauze të madhe. Prandaj ndodhë që të mos i ndjente aspak fyerjet apo mundimet fizike që i bëheshin. Shpeshherë i pyeste shokët besnikë që i kishte pranë, se ç'ndodhë, dhe përqendrohej në ngjarjen vetëm pse dëgjonte ngashërimet e shokëve dhe për t'i ngushëlluar.

I hidhnin sende të këqija në atë fytyrën që edhe engjëjt druheshin t'ia vështronin, i vinin sende të ndyra në atë kokën që ishte ngjitur në qiejt më të lartë, i vinin gjemba në rrugën nga kalonte pér t'ia shpuar ato këmbë të bekuara ose e gjuanin me gurë... Të gjitha këto ndodhnin, kurse ai jetonte sikur të mos kishte dijeni aspak pér to. E dëgjonte Hz. Omerin të ngashërehej dhe e pyeste: "Pse qan, o Omer?" E shihte Ebu Hurejren të qante i pérthyer më dysh dhe i shoshte: "Ç'të bëri të qash, o Ebu Hurejre?" Ose, kur shihte vajzën e dashur, Fatime, pjesën e shpirtit të vet, t'i dilnin lotë nga sytë, e pyeste pse qante dhe, kur e merrte vesh shkakun, e qetësonte me këto fjalë: "Mos qaj, bija ime, Allahu do ta bëjë të çmuar këtë fe! Mos qaj, se Allahu nuk do ta humbë tét atë!"

Po, Allahu nuk e humbi atë. Ai jetoi gjer më sot në çdo zemër besimtarë si një trëndafil xheneti dhe do të vazhdojë të jetojë edhe pas kësaj. Kështu silleshin edhe shokët e tij besnikë. E vëtmja bashkësi që do të mund ta pranonte dhe bënte udhëzues pér vete çdo njeri dhe çdo shtresë në botë, është bashkësia e sahabave. Ne jemi roje besnikë të portës së tyre. Edhe shpresa jonë është që Zoti të na bashkojë pas ringjalljes me këtë mendim.

Unë e pranoj veten si më mëkatarin e besimtarëve. Megjithëkëtë, po qe se ndonjëri prej tyre e merr mundimin të më shfaqet dhe unë e shoh në ëndërr, të nesërmen nuk më nxë vendi dhe më duket sikur do të fluturoj nga gëzimi.

Meqë e pranoj këtë si një favor të madh, ngrij nga frika dhe s'dua t'ia tregoj askujt. Por ndonjëherë ndodh që, duke e kapërcyer frikën, por prapë, pa e pasur në dorë, ia tregoj ndonjërit prej shokëve të mi të afërt. Dhe i them: "Sot përsëri njëri prej atyre yjeve u shfaq në horizontin e një të pamericuari..." Ja, të tillë janë ata pér ne!

Sahabet, shokët e Profetit, e reflektuan dritën profetike me anë të pasqyrave të zemrave. Ata u bënë pasqyrë e vërtetë e dritës profetike duke e përfaqësuar atë në plot kuptimin e fjalës. Duke u lidhur pa asnje lëshim pas Kryeimamit, e morën atë pishtar të vërtetë që digjë në zemrën e imamit të tyre, e bënë që të digjë edhe në zemrat e veta dhe, pastaj, me ndihmën e Zotit, e mbytën njerëzimin në dritë!

Misioni profetik i profetit Muhamed i mbështetur nga afër dhe me një përkushtim të plotë nga sahabet, shokët e tij, ishte, në atë kohë, një lëvizje kushtuar shpëtimit të njerëzimit, që u përfaqësua me cilësinë e saj më të lartë. Gjërat që kemi parë te ata na krijojnë opinionin se kjo lëvizje mund të realizohet edhe sot. Sepse e dimë se historia është përsëritje e po atyre bëmave. Dhe nuk ka asnje shkak që ajo periudhë të mos përsëritet. Dhe, në dashtë Zotit, do të përsëritet. Opinion i im është se ne po shkojmë hap pas hapi drejt asaj pike!

Është fakt se para fare pak kohe sa mund të themi "dje", ishim të detyruar që të gjithë shembujt t'i jepnim nga sahabet. Kurse sot kemi mundësi të japim shembuj edhe nga periudha jonë, edhe nga e përditshmja. Fundja, të vetëdijshëm apo jo, të gjithë ne i kemi pritur këto ditë. Tanimë na është realizuar dëshira që, duke dhënë shembullin e parë nga shekulli i lumtur dhe të dytin, nga dita jonë, t'i bashkojmë këto dy hallka.

Le ta konkretizoj çështjen me një shembull: një grup shokësh që shumica do t'i kishte zili pér anën ekonomike dhe pozitën, ndërsa nuk e kishin shijuar ende jetën dhe të gjitha të mirat e kësaj bote i kishin ndër këmbë, kishin bërë një listë dhe ma kishin sjellë mua. Ishte një listë emrash me një shënim në fund: "Për dashurinë e Allahut, lutuni pér ne që të biem dëshmorë pér fenë!"

Ja, kjo do të thotë riekzistencë e sahabeve. U luta për një kohë të gjatë për ta. U luta që ta shpenzonin jetën përfundit e fundit ta jepnin me Fjalën e Dëshmisë, që është mënyra më me fitim e vdekjes. Pastaj, pa e parë nëse e meritoja, e shkrova emrin tim në fund të tyre. Dhe, duke i bërë ata ndërmjetës përfundit, iu luta favorit të gjerë të Zotit që të më bënte pjesëtar të arritjes së tyre. Gjendja e atyre të rinjve dhe e mijëra të tjerëve si ta, na bën ziliqarë, na e çon zemrën peshë dhe na premton shumë gjëra!

Kur i shohim ata, na ngjallet shpresa dhe themi se kjo punë do të zërë. Sepse tashmë ka të rinj që mund ta përfaqësojnë atë kuptim të lartë në thellisitet e shpirtrave dhe sipas pozitës dhe vlerës së tij, gjë që është mirësi e pafund e Zotit tonë për ne. Tashmë janë shtuar ata që u rrahin tëmthat kur bien përfundit. Sot ka mijëra të rinj që e ndjejnë në shpirt ankthin e mosbesimit dhe të mosbesimtarëve. Kështu, përballë sahabeve të shkëlqyer që përbëjnë polin e parë, është një brez i ri që ka vendosur ta marrë përsipër kauzën e madhe, të bëjë punë të mëdha siç kanë bërë ata dhe, të frymëzuar nga fryma e Hz. Muhamedit (s.a.s.), që përpilen ta zënë vendin e tyre në shërbim. Zoti mos na i vëntë re të metat e mos na çoftë në zhgënjim!

Duke e përbledhur çështjen, themi se ata u lartësan dhe u ngjitën qiejve me anë të cilësive të larta si vetëmohimi dhe braktisja e të gjitha dëshirave materialo-shpirtërore përfundit. Po që se sytë na kërkojnë në horizont të njëjtat gjëra, do të na duhet të ndajmë me ta të njëjtin mendim dhe të njëjtën gjendje shpirtërore!

13. Si mund të mbrohem nga rreziqet që vijnë prej pasioneve të jetës e të rinisë?

Një prej problemeve më të mëdha të njeriut të sotëm është se ndodhet nën presionin e rinisë. Pasionet kanë vënë nën pushtetin e ndikimit të tyre ndjenjat tona të larta. Dhe sot është seriozisht e vështirë që të vërtetat e larta të përfaqësohen në atë cilësi që i kérkon i Dërguari i Allahut. Ndërkaq, është e vërtetë se edhe lufta në një vijë të tillë ka, në vvetvete, avantazhet e saj. Sa më të vështira të jenë kushtet, aq më i madh është përfitimi, është shpërblimi që vjen prej kësaj lufte.

A s'ishin kushtet tejet të vështira që luftës që përballoi Hz. Hamzai, të cilat e ngjitën atë në nivelin e dëshmorit më të madh dhe të luanit të Allahut? Me thënien “dushmani është i madh, por ne kemi besimin tonë”, pati sulmuar në radhën e parë e që bërë mburojë e gjallë ndaj sulmeve të armiqve duke mos e llogaritur vdekjen.

Mëkatet që na shqetësojnë ne, ishin të pranishme edhe në kohën e sahabeve, pasuesve të Profetit, madje në tërë kompleksitetin e tyre. Gratë kryenin adhurimin rreth Qabes lakuriq, kurse faizi, ankandi, rushfeti, pijet alkoolike, kumari, etj., e gjerryen si krimb shpirtin e shoqërisë. Kurse pasuesit zgjodhën Islamin duke i kthyer shpinën asaj lloj jete. Megjithatë, edhe ata, si njerëz që ishin, bartnin ndjenja, dëshira dhe pasione. Por a s'ishte pikërisht heqja dorë prej tyre që i bënte ata më të mëdhenjtë ndër më të mëdhenjtë? Fakti që në një periudhë të atillë hodhën mënjanë tërë shëmtitë e zgjodhën një jetë krejt të pastër e të ndriçuar përkundër të gjitha vështirësive e rreziqeve, që u vunë në radhë pas Profetit (a.s.), u solli atyre virtute të mëdha dhe, në sajë të këtyre virtuteve të fituara, u bënë, me meritë të plotë, yje ndriçues përfundit pasardhës.

Fatkeqësi dhe humbje morale si të asaj kohe ka edhe në ditët tona. Fundja, edhe konstruktorit të parë të moralit tonë, në një kuvend shpirtëror i patën thënë “njeriu i kohës së fatkeqësive dhe humbjeve”. Edhe atyre që viheshin në radhë pas tij u patën thënë se, nëse një ditë Profeti do t'u bënte zë, do t'u drejtohej po në këtë mënyrë: “*Ejani, o brezat e kohës së fatkeqësive e të humbjeve!*” Sepse, po qe se do të merreshin në dorë një e nga një e do të vlerësoheshin tregu, sokakët, jeta shoqërore e tregtare, familja, individi e shoqëria, si dhe të gjitha njësitë dhe institucionet që krijojnë jetën shoqërore dhe shkollat që kanë marrë për detyrë t'i mbajnë në këmbë ato dhe do të kërkohej të jepej një konkluzion mbi të gjitha këto, e vëtmja fjalë që do të thuhej, do të ishte: “Shumë keq”!

Shkoni ku të doni, nuk do të pengoni t'ju ngjiten në kokë e në trup ca gjëra ndër mëkatet. Është e pamundur të kaloni nga njëra anë në anën tjetër të jetës së shoqërisë pa pësuar disa herë goditje shpirtërore, pa ju tronditur jeta ndjesore. Të jetosh sot si mysliman, është e vështirë sa edhe të ecësh mbi një truall flakësh ose të kalosh detra gjaku e qelbi. Ja pra, ne jemi të bijtë e një kohe të tillë fatkeqësie dhe humbjeje. Egoizmi, dëshirat dhe kompleksi i botës sonë materiale që janë pjesë përbërëse e cilësisë sonë si njerëz, janë si një akrep që ka hapur gëthapët e përpinqet të na kafshojë. Çdo çast ekziston mundësia që një akrep i tillë të na kafshojë e të na helmojë. Bashkë me pranimin e këtyre të gjithave, gjendjen tonë e vlerësojmë në bazë të parimeve të detyrimit e përfitimit, ngushëllohemi e qetësohemi duke menduar për avantazhet që do të na sjellin gjithë këto vështirësi, madje, nga një anë, gëzohemi. Sepse, atëherë kur t'i kemi kapërcyer vështirësitë, edhe fitimin do ta kemi pa aq të madh sa to. Nëse pasuesit e Profetit patën kapërcyer vështirësi të tilla e qenë lartësuar, edhe arritja e një fati të tillë nga njerëzit e sotëm është rezultati që presim nga Mëshira Hyjnore. Në një periudhë kur janë lehtësuar kaq shumë kushtet për të hyrë në mëkat, sigurisht që edhe ne kemi gabime e mëkate të bëra pa dashje. Vetëm se ajo që na bie përsipër, është të qëndrojmë e të mos largohemi nga dera e mëshirës dhe nga pragu i shtëpisë së Zotit. Këtu, me lejen tuaj, dua të përcjell një ndodhi që u bëhet interprete ndjenjave të mia. Në fëmijërinë time kishim një qen që na ruante dhentë dhe nuk na ndahej prej dere. I mahnitur pas besnikërisë së tij, luaja me të, i varesha për qafe dhe i jepja gjithmonë diçka për të ngrënë. Ky kujtim i vegjëlisë më vjen vazhdimisht ndërmend. Dhe, duke hapur duart për t'iu lutur Zotit, duke e ruajtur asociacionin e asaj ndodhie me shpresën time, them: ”Imzot! I drejtohem besnikërisë Tënde që të jesh bujar, mëshirues e falës me mua ashtu siç i tregoja edhe unë miqësi qenit të fëmijërisë sime!”

Këto gjëra mund t'i themi edhe në emër të bashkësisë sonë. Përkundër të gjitha mëkateve dhe rrëshqitjeve, bashkësia jonë po bën një shërbim që po e vazhdon me besnikëri dhe për hir të atij shërbimi Zoti i Mëshirshëm nuk do t'i përzëre ata nga dera e Tij!

Ne i pohojmë dhe i pranojmë të metat tona dhe, njëkohësisht, nisur nga mëshira e pasosur e Tij, i lutemi Zotit të na falë. Pikërisht ky pohim, në një aspekt, quhet pendesë. Dhe Allahu nuk e kthen mbrapsht pendesën e bërë nga zemra të tilla, e pranon atë.

Ato që thamë gjer këtu, në një aspekt, bartin kuptimin e një rapporti mbi gjendjen. Kurse tani dëshiroj të ndalem pak mbi specifikat ndaj të cilave duhet bërë kujdes.

E para: Është e domosdoshme të ecet me shumë kujdes mbi një truall të tillë të rrëshqitshëm e të rrezikshëm me gjithçka. Ashtu si do të duhej ecur mbi një fushë të minuar ose si do të duhej kaluar në zonën e një armiku të pamëshirshëm, ashtu edhe duhet treguar kujdes e syçelësi duke kaluar nëpër mjediset e qyteteve tona.

E dyta: Para se të dalim jashtë, duhet t'i kthjellojmë ndjenjat dhe duhet t'u drejtohem i mjeteve që kanë forcë ndikuese mbi botën tonë ndjesore. Këto mjete, siç mund të jenë leximi, vëzhgimi ose dëgjimi i diçkaje, mund të jenë edhe një vetëlogari e thellë. Nuk duhet dalë jashtë para arritjes së një tensionimi të tillë metafizik.

E treta: Nuk duhet dalë vetëm. Duhet gjetur një shok që do të na e tërhiqte vëmendjen dhe që me porositë e tij do të na e mbante në këmbë botën tonë shpirtërore dhe me të duhet dalë jashtë.

E katërta: Kur të shkojmë e të vijmë e kur të shkojmë në vende ku do të na duhet të rrimë për njëfarë kohe, duhet të bartim me vete, me aq sa janë mundësítë, edhe gjërat që kanë lidhje me jetën tonë e që na shërbijnë si engjëll mbrojtës. Ato do të na shërbijnë si perde, si mburoja ndaj mëkateve dhe atëherë do të ishte e rrallë rënia në mëkat.

E pesta: Pas ndonjë gabimi ose mëkati, duhet vepruar në derën e pendimit. Zemra e besimtarit është zemra ku mëkati rri më pak kohë se në çdo zemër tjetër. Gabimet aty janë si retë kalimtare që na bëhen përkohësish pengesë mes nesh dhe diellit. Vonesa në pendim bëhet shkak për nxitjen e shpirtit po në atë masë. Dhe në atë mes lehtësohen rrugët për të hyrë në marrëdhënie me mëkate të tjera. Prandaj, edhe pa i lënë shesh kësaj, sado të jenë përmasat dhe veçoritë e mëkativit, duhet ardhur në vete, duhet vrapuar e hyrë në sferën e mëshirës së Zotit.

Një pasues vjen në prani të Profetit i goditur rëndë në shpirt dhe i thotë: “O i Dërguari i Allahut! U shkatërrova!” Dhe vazhdon duke i treguar se i kanë shkuar sytë tek një femër ose e ka prekur atë. Para kësaj zemre të thyer pothuajse tronditet vetë rezidenca hyjnore dhe Xhebraili vrapon në ndihmë duke sjellë këtë ajet: “*Fal namaz në të dy skajet e ditës* (mëngjes, drekë dhe pasdite), *si dhe në orët e para të natës* (perëndim i diellit dhe jaci). *Sepse mirësitë i fshijnë mëkabet. Kjo është një kujtesë e bukur për ata që kërkojnë këshilla!*” (Hud,114).

Sidomos ngritja në faljen e natës që i përngjet nurit të botës së varrit, atëherë kur gjumi është më i ëmbël se kurrë dhe vrapimi për t'iu përgjëruar Zotit, duhen vlerësuar si faktorë për t'i pastruar mëkabet në kohën më të shkurtër.

Lutjet dhe përgjërimet në mes të natës të një zemre të mbushur plot frikë e shpresë, sigurisht që do të gjejnë miratim tek Zoti. Mjafton që ato të bëhen me sinqueritet. Ndërsa adhurimi dhe përkulja para Tij në kohët e namazit bëjnë që të falen mëkabet dhe rrëshqitjet mes dy kohëve që i rrinë njeriut si rojë mbi kokë, ne duhet të përpinqemi që të fitojmë pëlqimin e Tij edhe me adhurime të tillë, si namazi i natës dhe ato suplementare.

Po, ndodhemi të rrethuar në njérën anë me mëkate e, në tjetrën anë, me një sërë avantazhesh që do t'i shpërndanin e shkatërronin ato. Me këtë panoramën tonë që i përngjet shumë situatës së sahabave, pasuesve të Profetit, mbajmë në dorë, në të njëjtën kohë, edhe rastin për t'iu afruar atyre. Ndërsa ata ndjenin në zverk frymëmarrjet e revelacionit hyjnor, në qoftë se ne do të arrinim të shpëtonim prej ndikimit të kohës dhe të zinim vendin tonë me një shpirt muhamadan, do të thotë se, me një ményrë, e kemi siguruar shpëtimin. Zoti mos na gënjeftë në këtë shpresën tonë! Amin, ashtu qoftë!

14. Cila është pozita jonë përballë intrigave të kohës së mbrame dhe si mund të mbrohem i prej tyre?

Shekulli i nëntëmbëdhjetë është emri i një periudhe kur vende të ndryshme islame iu nënshtruan pushtimit dhe u shtypën nën hegemoninë e mendësisë dhe botëkuptimit bestyt të perëndimit.

Në të vërtetë, mizorët dhe hipokritët europianë i patën lënë dhe qenë tërhequr më pas fizikisht prej këtyre vendeve, por vetëm pasi patën hedhur e shpërndarë gjithandje si një farë të helmuar, ashtu siç hidhet fara në arë, të gjitha llojet e gjenjesetrave ideore e botëkuptimore. Ja, pra, shekulli që po jetojmë, është një shekull fatkeq, pasi produktet e degjeneruara të atyre farërave kanë hedhur shtat në zemrën tonë dhe, në planin mendor-moral na kanë katandisur në mjeranë e varfanjakë! Shkëndijat e shpërndara prej tyre kanë shkaktuar një zjarr ferri që po djeg e përcëllon jetën e shoqërisë. Këto intriga janë me qindra. Dhe brezi i ditëve tona pyet se ç'qëndrim duhet mbajtur ndaj tyre. Ne na gjëzon qoftë edhe fakti që fillojnë të bëhen pyetje të tilla. Sipas meje, kjo duhet pranuar si simptoma e kapërcimit të një etape dhe duhet vlerësuar.

Fronti i mohimit, së pari, shigjetën e pati hedhur mbi besimin monoteist, pati dashur t'i turbullojë mendjet në lidhje me ekzistencën dhe njësinë e Zotit dhe njëfarë kohe edhe pati arritur sukses. Ky popull qe bërë dëshmitar edhe i periudhave kur mohimi i Zotit qe bërë modë. Në ato periudha, feja qe nënvleftësuar me të tëra dhe konceptet e konsideruara si të shenjta nga feja, i qenë nënshtruar goditjeve, sharjeve e përbuzjeve.

Atëherë qenë bërë përpjekje që lidhja dhe besnikëria e popullit ndaj Kuranit të fshihej sistematikisht nga zemrat dhe vendin e tyre ta zinin libra të tjerë, që emri i lartë i Hz. Muhamedit (a.s.) të shkulej nga gjokset e besimtarëve ku ai kishte ngritur një fron dashurie krejt të veçantë dhe aty të shtresoheshin emra të tjerë, madje, në vend të Qabes, qenë propozuar të tjera vende e orientime dhe kështu, duke i shtyrë brezat në një kaos, ishte dashur të shkëputeshin prej origjinës dhe rrënjos së tyre. Edhe nëse të gjitha këto veprime nuk patën ndikuar në të gjithë popullin, meqë brezat e rinj naivë patën humbur vullnetin dhe aftësinë për t'i kundërvënë atyre, një shumicë e madhe e tyre e patën lëshuar veten në atë rrjedhë e patën marrë fund.

Sa e sa shpirtra të plagosur ka sot për shkak të këtyre intrigave, sa koka të sëmura dhe sa ndërgjegje sterri të zeza! Nuk kanë të llogaritur dëmet e largimit nga feja! Në asnje shekull nuk ka arritur në përmasa të tilla tronditëse numri i njerëzve-armiq të emrave që bartin vetë, armiq gjer atje sa të adhurojnë edhe faraonët, megjithëse emrat që bartin u përkasin personave për hir të të cilëve jemi gati të sakrifikohemi. Në këtë periudhë shikimi u drejtua vetëm kah bota. U bënë të dashura gjërat që nxisin dëshirat trupore dhe kërkuesat materiale. Njerëzit, në vend të përjetësisë, blenë këtë botë kalimtare e të vdekshme, sepse tek ajo ishte përqendruar opinioni dhe mendësia e përgjithshme që ishte sjellë në rend të ditës. Dhe çdokush, në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo, ishte futur në një garë të tillë. Ata që ecnin në rrugën e përjetësisë, përbuzeshin, kurse të tjerët respektoheshin. Dhe të gjitha këto ishin nga një intrigë më vete që e largonin njeriun nga feja...

Ja pra, brezi ynë u detyrua të kalonte nëpër një urë të tillë të vështirë. Një urë e tillë në anët e së cilës qenë të varura si karrem femra, pijë, bixhoz, ryshfet, faiz, etj. Të rinxjtë mund të shpëtonin prej një grepit, por binin në grepin tjetër. Kurse të zgjedhurit që mund të kalonin pa u penguar kund, ishin më pak se çmund të merret me mend, shumë më pak se më e pakta...

Nga të bihet në një gropë, prej andej edhe do të jetë dalja dhe shpëtimi. E pra, fakti që Pishtari Gjigant i kohës (Bediuzzaman Said Nursi), që ishte njëri prej atyre që e patën rrrokur më herët këtë të vërtetë, filloi nga meremetimi i pikave ku qenë bërë shkatërrime, duhet të jetë konkretizimi i

kësaj të vërtete. Armiqtë patën dashur të ndezin një zjarr, kurse Providenca Hyjnore dëshiroi dhe urdhëroi të shuhej zjarri i intrigës së ndezur prej tyre. Fitimtari është Allahu, kështu që zjarrit të intrigës i është zënë fryma pikërisht në vrimën prej nga qe përvjedhur në besimin. Sa për intrigat lidhur me aktet dhe veprimet, për shkëndijat lidhur me mëkatet, dashtë Zoti, edhe ne do të përpinqemi ta shuajmë atë zjarr me përfimet e nxjerra nga mësimet e marra prej shprehjeve të ndritshme të Kuranit e të të Dërguarit të Allahut e prej veprave të studiuara. Vetëm se s'ka dyshim që në këtë fushë kemi nevojë të padiskutueshme për njerëzit tanë, për mbështetjen e xhematit, bashkësisë tonë. Sepse, kur intrigat të na hidhen sipër si një ushtri armike, është mjaft e vështirë t'i përballojmë ato individualisht, madje, e pamundur. Dhe s'duhet të harrojmë që mëshira e Zotit është gjithmonë bashkë me bashkësinë.

15. Në lidhje me profesionin tonë, kemi patur një ideal që e kemi dashur shumë. Hidhërimi i humbjes së tij ndikon në aspektin tonë shoqëror. Si mund t'i bëhem pengesë kësaj dukurie?

Me këtë pyetje, shoku ynë i bëhet interpret një çështjeje që mund t'u bjerë në krye shumicës së njerëzve. Dhe shpreh me një gjuhë të sinqertë atë ç'i ka ndodhur vetë atij, si dhe ndikimin negativ që i është shfaqur.

Me ajetin "*Mos pandeh njeriu se do të shtjerë në dorë gjithçka që dëshiron?*" (Nexhm, 24), Kurani e prek edhe këtë specifikë. Njeriu nuk duhet të jetë posaçërisht ambicioz, i pangopur, tepër kërkues e tepër i dhënë, i pasionuar pas diçkaje. Edhe kjo botë, edhe bota e pastajme, Allahut i përkasin. Disa herë, humbjet në këtë botë bëhen shkak për fitime në atë botë. Zoti të merr këtu e të jep atje. Ndërkëq, ne nuk mund ta dimë se ç'do të na japë si kundërvlerë të atyre që na ka marrë dhe se me ç'surpriza do të përballemi.

Në kaptinën "Dua", Profetit i thuhet drejtpërdrejt duke ia bërë të ditur se bota e pastajme është më e dobishme se kjo e para. Atëherë, kur e fundit qenekj më e dobishme se e fillimit, e pse duhet të mërzitemi për humbjet? A nuk duhet të falenderojmë e të gëzohemi duke menduar fitimin e nesërm?

Dhe tani le ta shqyrtojmë këtë jetën tonë. Jashtë çdo diskutimi, në kokë të secilit i kanë rënë jo një, por disa gjëra dhe që të gjitha e mbështesin konkluzionin e mësipërm. Ndërsa në fillim thyhem më dysh prej hidhërimit të gjérave të humbura, pastaj, nga habia kur shohim se ç'favor i madh hyjnor paska qenë ajo humbje, na zihet fjala në grykë e na duket sikur do të kapërdijmë gjuhën! Disa herë Zoti na çon me detyrim diku. Nga ky ndryshim vendi dhe largimi të detyruar, të padëshiruar prej nesh, nga ndarja prej gjendjes së mëparshme, prej të afërmve e miqve, neve në fillim mund të na vijë shumë zor. Por pas këtij ndryshimi të detyruar, Zoti mund të na ketë rezervuar favore, dhurata e fitore të tillë, saqë, po ta kishim ditur këtë qysh në krye, do të shkonim atje jo me detyrim, por me vrap, madje këmbë e duar!

Konkretizimin e çështjes e shoh të tepërt. Sepse e di që, ndërsa unë po them këto fjalë, ju, duke u kthyer me përfytyrim në të shkuarën tuaj, jeni duke gjetur shumë shembuj të ngjashëm e duke i gjallëruar në fantazi...

Thuhet se "e dobishmja është ajo që ndodhet në zgjedhjen e Zotit!" Duhet që të jemi dakord me atë që ka "prerë" dhe ka miratuar Zoti. Kjo është një shprehje e tillë kënaqësie para Zotit, e cila bart brenda saj shumë hollë kuptimet e adhurimit, nënshtrimit, sinqeritetit dhe principalitetit.

I Dërguari i Allahut na ka mësuar një lutje për ta kënduar në mëngjes e mbrëmje: "*Radînâ bil'lahi rabben...*"⁴³ "Jemi të kënaqur me Allahun, Zotin tonë, me Muhamedin, profetin tonë dhe Islamin, fenë tonë!"

Meqë jemi të kënaqur me të gjitha këto, u bindemi e u nënshtrohemti atyre. Atëherë edhe ne, duhet që me të gjithë qenien tonë të jemi dakord me Zotin dhe me atë që pëlqen Ai! Po, me një sjellje e qëndrim të tillë ne humbim shumë pak, por shumë gjëra fitojmë. Edhe shoku ynë që pyet, le të qetësohet. Të gjithë ne kemi shumë gjëra që nuk ndodhin ashtu siç duam në fillim, por që më pas mbetemi të kënaqur që s'kanë ndodhur. Më e bukura dhe më e mira e të gjithave është ajo që bën Allahu! Jo dëshira jonë, por e Zotit, jo kërkesa jonë, por e Zotit...

Ja, pra, kjo është edhe e fshehta në shpirtin e të qenit rob i Zotit! Veçanërisht jemi kah shohim se Ai, atë që do, e bën të vyer, atë që do, e bën të poshtër. Sa njerëz të vyer të së djeshmes ka që sot janë ca mjeranë, ndërkokë që sa mjeranë e të varfëri ka që sot janë secili si një sulltan...

Ajo që ne e shohim të largët e të paarritshme, në sytë e Allahut është shumë e afërt. Ai sheh gjëra të tilla që na i tregon edhe ne në të ardhmen, sa që po të mund ta shihnim sot atë të nesërmë e ndryshme nga ç'e mendojmë ne, rrjedha e kërkesave dhe e dëshirave tona do të ndërronte menjëherë drejtim.

Duro me një durim të bukur! Besoji Allahut dhe mbështetu tek Ai! E vetmja monedhë e vlefshme në botë e në përjetësi është fitimi i pëlqimit të Tij! Kërkoje Zotin dhe përpiku ta gjesh Atë! E kur ta gjesh, bjer në sexhde, vëre ballin në tokë dhe faladero sa të jesh gjallë!

16. Shumë mëkate të bëra, megjithëse kanë kaluar vite, nuk na hiqen aspak nga mendja, për më tepër, bëhen nxitës për të njëjtat mëkate. Sot rrugët janë pushtuar prej pamjesh që të kujtojnë kësi lloj mëkatesh. Nuk dimë se ç'duhet bërë. Vetëm lutemi të biem dëshmorë, duke gjetur kështu, rrugën e pastrimit prej mëkateve.

Kjo nuk është pyetje, por pohim i një zemre të sinqertë. Është shprehja e anktheve të një zemre që është ngritur e revoltuar në këmbë në rrugën për t'iu afuar sahabeve, shokëve të Profetit. Ne kemi marrë vendim të mbetemi brenda kësaj shoqërie, mes këtyre njerëzve në kushtet kur rruga e tregu mbushen e derdhen prej mëkateve. Me këtë rast, ju lutem të më lejoni të ritregoj këtu një ndjenjën time që e kam treguar edhe herë tjetër mes këtyre bisedave.

Kur për së pari vizitova të Dërguarin e Allahut, duke shkuar për në Varrin e Tij⁴⁴, më dukej sikur do të më ikte mendja. Më bëhej sikur do të takohesha me atë vetë. Shihja majtas e djathtas e e kërkoja për ta parë. Veten ma kishte mbështjellë ndjenja e të shtënit të plotë ndaj Tij duke mos

⁴³ dhe vazhdimi: ... ve bi-l-Islam-i dinen ve bi-Muhamedin Resulen.

⁴⁴ Në original: Ravza-i Tahire, Kopshti i Bleruar.

dashur të di për asgjë tjetër, madje duke qenë i vendosur për të kundërshtuar edhe ftesën për në parajsë sikur të hapeshin dyert e saj e të ftokesha brenda. Po deshët, kësaj mund t'i thoni "t'i bëhesh ashik fshatit të dikujt".

Por unë kam një porosi për shokët. Po qe se një ditë do ta braktis këtë vend e do të shkoj atje, këtë do ta bëj për përfitime personale. Le të më kapin mua atëherë për jake e lë të më sjellin zvarrë prapë këtu! Në mos qoftë kështu, para Zotit jam fajtor ndaj jush...

Ja, pra, dy fytyrat e veçanta të kësaj çështjeje. Nga një anë malli i paduruar për dheun e Profetit dhe, nga ana tjetër, domosdoshmëria për të përballuar detyrën që më takon këtu. E para është krejt personale, kurse e dyta ka të bëjë me fatin e një kombi, madje të tërë botës islame...

Që të gjithë ne, një e nga një, para një zgjedhjeje të njëjtë ndodhemi. Edhe ju, të paktën po aq sa unë, jeni të dashuruar pas atyre anëve. Megjithatë e quani veten të detyruar të mbeteni këtu. Sepse këtu ka rënë flamuri për tokë, brezi këtu ka nisur të shkatërrrohet dhe çdo gjë këtu ka mbaruar. Nëse diçka ka për të nisur nga e para, që këtu do të nisë. Edhe ne do të vuajmë, do të fliojmë ndjenjat e përfitimeve materiale e shpirtërore dhe këtu do të mbetemi.

Po, e pranoj, mëkatet na i zënë rrugët dhe ne ndjejmë se si na plagoset zemra për çdo çast. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, qëllimet i kemi të shëndosha e të pastra. Eshtë vetëm një mendim që na e stolis zemrën, t'i vëmë supet fesë së Zotit tonë, ta shtrojmë të Dërguarin e Allahut në zemrat e rinisë e të brezit tonë si dhe, duke qenë të vendosur qysh në krye për të pranuar të gjitha të këqijat që mund të na bien mbi krye në këtë rrugë, të jemi të vendosur për të qëndruar këtu. Pikërisht për të gjitha këto ne zgjedhim të mbetemi mes njerëzish e të ndajmë me ta vuajtjet e tyre, të tërhiqemi në male duke hequr dorë prej gjithçkaje dhe, duke u mbyllur në një qoshe, të bëjmë dhikër. Do të rrimë mes njerëzish e do të shtypemi herë pas here nën zinxhirët e shoqërisë, por, megjithatë, do të vazhdojmë të mbetemi po atje. Sepse jemi të detyruar të punojmë këtu, madje të dënuar...

17. Ç'na këshilloni për t'iu ridrejtuar idealit duke e ndaluar lëshimin e mëtejshëm të tensionimit tonë metafizik?

Për një besimtar, tensionimi metafizik është një element shumë i rëndësishëm. Tensionimi metafizik, të cilit, në një kuptim, do t'i thoshim qëndresë në atë çka është pozitive e bojkot ndaj negatives, bart, në njérën anë, kuptimet e vënies në punë të njësive të shërbimit, e ngritjes së një mekanizmi dhe e mbajtjes së tij vazhdimisht në gjendje pune dhe, në anën tjetër, kuptimin e hyrjes, përballë frontit të mëkatit e të nxitjes për mëkat, në një qëndresë të vazhdueshme e këmbëngulëse. Shprehur ndryshe, tensionimi metafizik do të thotë që, duke u shtrënguar fort rrëth Allahut e të Dërguarit të Tij, si dhe sistemit të prurë prej të Dërguarit të Tij, të ikësh prej mohimit e herezisë dhe mohuesit e heretikut si prej gjarprit. Edhe një hadith, porosi profetike, e shpjegon këtë. Janë tri llo natyrash. Te sekush që të ndodhen ato, ai njeri e ka shijuar shijen e besimit: t'i duash Allahun dhe të Dërguarin mbi çdo gjë tjetër, të ndjesh dashuri për njerëzit si rrjedhojë e dashurisë për Allahun dhe ta konsiderosh rikthimin në herezi pasi ta kesh gjetur një herë fenë, të shëmtuar sikur të hidheshe në zjarr.

Ti do të jesh "dashurues", kurse Allahu dhe i Dërguari, të "dashuruar". Njerëzit do t'i duash vetëm për hir të Zotit. Këto janë aspekti pozitiv i çështjes. Por është edhe ai aspekti tjetër pozitiv pse përbën një qëndrim kundërshtues ndaj një dukurie negative, domosdoshmëria e përcaktimit të një qëndrimi ndaj rrugës së mohimit dhe mohuesit. Po, besimtari i vërtetë, sa ç'e ka dashurinë për besimin, po aq i vendosur duhet të jetë për të mos hyrë në rrugë të shtrembër dhe duhet ta ketë të plotë tensionimin metafizik që të mund të mbetet besimtar. Por ç'e do që ruajtja e tensionimit është shumë më e vështirë se arritja e tij. Prandaj edhe vendosmëria e qëndrueshmëria në këtë çështje janë nga një parakusht më vete. Tensionimi vende-vende mund të lëshohet për shkak të dukurisë së të mësuarit e të përshtatjes. Njeriu familjarizohet me çështjen për të cilën lufton, me kauzën e tij. Kurse disa herë futen në mes gjëra të tillë, si egoizmi, ambicia, pangopësia, dashuria për post, pasioni për qetësi e komoditet, i shuajnë dashurinë dhe kënaqësinë e shërbimit, e degjenerojnë shpirtin dhe e paralizojnë vullnetin. Dikush që një kohë ka vrapuar natë e ditë për kauzën e të drejtës, nëse më vonë, sa herë që të thirret, ikën nga shërbimi duke nxjerrë nga një pretekst të veçantë, do të thotë se e ka lëshuar veten e ka nisur të marrë erë. Mirëpo një çështje e tillë që kërkon një tensionim metafizik shumë serioz, nuk mund të sigurohet me njerëz që e kanë humbur tensionin dhe e kanë lëshuar veten.

Në të vërtetë, shokët tanë, ashtu si në çdo çështje tjetër, edhe këtu janë shumë të kujdeshëm. Sidomos ka sa e sa të tillë që janë të denjë për t'i puthur në ballë, të cilët çdo çast jadin shembuj tensionimi metafizik në atë formë që do t'u bëhej shembull shokëve të tyre. Njërin prej këtyre sidomos, nuk e harroj dot kurrë. Një ditë i pata thënë të qëndronte në shtëpi dy a tri ditë e të bënte këtë e atë punë. Përgjigjja që më dha, që tekstuallisht kështu: "Mirëpo unë, pas detyrës së fundit, nuk mund të rri më në shtëpi..."

Ja, kjo kërkon moslëshimin e tensionimit. Vetëm me këtë tensionim mund t'i arrijmë ne të Dërguarin e Allahut dhe miqtë e tij të zgjedhur.

Kur sëmuremi, mjekët na jadin ca këshilla dhe kërkojnë t'u bindemi atyre dhe porosive të tyre pa kusht. Edhe po të mos na pëlqejë, i gjelltisim hapet që na kanë dhënë e i bëjmë gjilpërat. Ja pra, duhet që të tregohemi të ndjeshëm në këtë çështje të paktën po aq sa ç'tregohemi në zbatimin e fjalës së mjekëve! Në mënyrë që tensionimi të ruhet!

Dhe tani po përpinqem të parashtroj disa veçanti që mund të këshillohen lidhur me çështjen në fjalë.

E para: Të mos mbetesh vetëm. Delen që ndahet nga tufa, e ha ujku! Edhe fundi i një shoku të veçuar prej xhematit, bashkësisë së vet dhe dikujt që rri larg miqve, është copëtimi dhe gjelltitja e tij prej një djalli egoistik. Fillimet nisin me mërzitjen për diçka që s'mundet ta bëjë vetë. Në fakt, kjo është një gjë e mirë, por s'është e mjaftueshme dhe nuk ka vazhdueshmëri. Më pas, sapo të nisë të nënveftësojë bëmat e shokëve, me këtë qëndrim që përparon, nis në fillim shkallë-shkallë e pastaj plotësisht, të mohojë idealin e kauzës dhe të pretendojë se punët e bëra janë të panevojshme. Ja, pra, një kandidat i mjerë për t'u shkatërruar. Po nuk u riparuan qysh në fillim vëtmia dhe mbetja larg prej shokëve që e kanë sjellë në këtë gjendje, as mund të mendohet që ai të shpëtojë prej këtij fundi të keq. E në është kështu, dyert që gjithsesi çojnë në një përfundim të tillë, duhen mbajtur mbyllur qysh në krye të herës.

E dyta: Në planin informativ dhe intuitiv⁴⁵ vazhdimisht duhen kërkuar rrugë rrinovimi dhe në këtë specifikë duhet treguar këmbëngulje. Zoti na e ka shpalosur gjithësinë para sysh si një libër dhe pastaj na ka dërguar libër dhe profetë për të na e mësuar atë. Pastaj, mijëra dijetarë e njerëz të urtë të përgatitur pas tyre, kanë qëndruar rreth të njëjtës gjë dhe janë vënë t'i trajtojnë që të dyja, librin dhe gjithësinë sipas aftësive, mundësive dhe natyrave të veta dhe, duke kaluar lule më lule si bletët, kanë ngjyer në hojet plot mjaltë shërues të intuitës që të afron tek Zoti. Të gjitha këto ndodhi duhen vlerësuar në formën e domosdoshmërisë së urtësisë hyjnore të lidhura me një qëllim dhe synim të caktuar dhe duhen trajtuar me kujdes e korrektesë në mënyrë që të mundim të flasim për një qëndrim tonin në përputhje me urtësinë hyjnore. Një njeri që nuk e rregullon hapin me këtë ecuri të natyrshme dhe që, duke marrë pjesë në emër të intuitës hyjnore në procesin e rrinovimit që ndodh çdo çast në gjithësi, nuk end të njëjtën pëlhirë, dalëngadalë e humb vitalitetin informativ dhe, me një shpejtësi të papritur, hyn menjëherë në periudhën e dekompozimit duke nisur të bjerë erë. E kështu, pas ca kohe bëhet që të mos vlejë për asgjë.

E treta: Mbështetja ideore⁴⁶, ajo që themi që gjithmonë të mendojmë për vdekjen dhe ta ruajmë tensionimin tonë metafizik, është një prej faktorëve të rëndësishëm. Të vdesësh ende pa vdekur, është një emërtim tjetër i arritjes së jetës së vërtetë. Dëshirat tona që s'dinë të ngopen e të marrin fund, mund të priten e të hidhen tutje vetëm duke kujtuar vdekjen. Sidomos mendimi se të gjithë miqtë tanë po na presin në anën tjetër të varrit, sidomos besimi se lumturia dhe fatbardhësia e vërtetë ndodhen në skajin tjetër të korridorit të varrit...

Fundja, a nuk është bashkimi me miqtë dhe soditja e xhenetit dhe e Bukurisë Hyjnore pika e fundit që e zbuluron idealin e njeriut të kauzës dhe ideali i tij fundor? E në është kështu, duhet të bëhem si kuaj të shpejtë arabë në rrugën që na çon në atë rezultat final e duhet të vazhdojmë në rrugën tonë pa pushuar, gjersa të këputemi e të biem pa frysë përtokë...

Po, si një kalë i shpejtë arab... Sepse ai s'njeh lodhje, nuk nxjerr justifikime. Vrapon gjer në pikën e fundit dhe aty vdes. Por vdekja e tij është e justifikuar. Unë e dua shumë atë kalë për këtë veçori të tij dhe kërkoi që çdo burrë i kauzës t'i ngjajë atij.

E katërtë: Duhet të zgjedhim për vete një shok që patjetër të na e heqë veshin duke na bërë një të mirë kur të na shohë se e kemi lëshuar pak veten. Edhe kjo është një prej rrugëve. Një gjë e tillë, në pamje të parë, mund t'i vijë rëndë egos sonë, vetëm se s'ka aspak dyshim se në jetën tonë fetare ka për të dhënë rezultate shumë pozitive e të rëndësishme.

Miku i mirë është si çezma e Hizrit. Sapo të ndjeni pak lëshim në vetvete dhe lëkundje në zemër, madje edhe mungesë emocioni, menjëherë vraponi për tek ai, ia tregoni hallin dhe i thoni t'ju flasë dhe të mos keni aspak dyshim se ai mik do t'ju kapë prej dore, do t'ju kalojë nëpër labirintet dhe vorbullat e ndryshme të jetës dhe do t'ju nxjerrë përsëri në një mjedis të ndriçuar. Nga jashtë, në fjalët e tij mund të ndjeni një thartësirë apo një rrudhje të brendshme, por i rëndësishëm është rezultati i punës. Pasi të keni duruar bisturinë e parë, prerjet e saj të mëtejshme, të dhimbshme njëqind herë më shumë, do t'ju shpëtojnë, në fakt, për çdo çast që kalon, prej therjeve të plagëve që ju shkaktojnë ankth dhe vuajtja juaj shpirtërore, në një hop, do të ndërrojë vend me një kënaqësi shpirtërore. Personalisht, dikur iu drejtova për këtë qëllim një shoku që më pati ndenjur para e mori

⁴⁵ Në original: marifet; është fjalë për intuitën metafizike, aftësinë shpirtërore për ta ndjerë Zotin. Kjo lloj intuite që është një dukuri metafizike e një koncept mistik, nuk është identike me intuitën e psikologjisë materialiste.

⁴⁶ Në original: Rabita-i mevt.

mësime prej meje. Dhe ai më tha ca gjëra prej të cilave jo vetëm që s'pashë asnë të keq, por, përkundrazi, përfitova prej tyre.

Edhe për ju nuk ka asnë pengesë që t'i drejtoheni të njëjtës zgjidhje. Mjafton që çështja të trajtohet në kuadrin e sinqeritetit e thjeshtësisë.

E pesta: Të parët tanë janë shprehur në formën më të saktë e bindëse për idenë se hekuri që përdoret, nuk zë ndryshk. Ky konstatim thellësish filozofik dhe absolutisht i drejtë është i vlefshëm edhe për njeriun që i është kushtuar një kauze të caktuar. Prandaj edhe e shohim të dobishme që ruajtjen e tensionimit metafizik si një rrugë më vete ta trajtojmë në këtë temë.

Njeriu, psikologjikisht, është i lidhur më afër me punën ose aktivitetin brenda të cilit ndodhet. Gjërat që bëjnë të tjerët, edhe sikur të janë më të rëndësishme se të vetat, i interesojnë tërthorazi. Ja, pra, kjo dobësi që vërehet tek njeriu, duhet përdorur mirë. Çdo shok që i është kushtuar këtij shërbimi, duhet t'i dalë për zot në nivelin e vet, duke e kapur edhe ai nga një skaj i dhënë një çështje të caktuar dhe kjo metodë duhet përgjithësuar.

18. Thuhet se shokët e Profetit, fëmijët dhe gratë e tyre, kur kishin për të qarë për dëshmorët e vet, më parë qanin për Hz. Hamzain. A mund të na e thoni shkakun?

Ashtu pati ndodhur për një kohë të gjatë. Ashtu e patën komentuar dhe interpretuar ndjeshmërinë e Profetit në këtë çështje.

Vendi i Hz. Hamzait mes hashimitëve, ishte vendi i një burri dhe trimi të vërtetë. Ai qe shfaqur mes tyre si një rrufe e ashtu qe larguar. Dhe pas vetes nuk pati lënë kënd që t'i trashëgonte brezin. Ashtu siç pati bërë një jetë të posaçme vetëm për të, po ashtu edhe ikjen e bëri në një mënyrë të posaçme vetëm për të. Ai iku pa lënë pas askënd. Dhe si përgjigje ndaj këtij realiteti, zuri një vend të tillë në zemrën e të gjithë njerëzve që e njohën, ashtu edhe në zemrën tonë, saqë do të ishim gati, në më lejofshi të shprehem kështu, të quheshim jo më bij të tij, por t'i bëheshim roje në portë e t'i puthnim këmbët!

Hyrja e tij në Islam qe, në të njëjtën kohë, edhe fillimi i periudhës së mbarësisë për myslimanët. Profeti i Dy Botëve e donte shumë dhe krenohej me të. Një radhë, në një prej ditëve kur pijet alkoolike ende nuk ishin ndaluar, Hz. Hamzai kishte pirë e ishte dehur. Dhe i Dërguari i Allahut, që i kishte shkuar ndoshta për ta qortuar për shkak të një gabimi që ai kishte bërë, e kishte parë në atë gjendje si dhe kishte dëgjuar ca marrëzi që ai i kishte nxjerrë prej goje nën ndikimin e alkoolit. Por Profeti ishte kthyer pa i bërë asnë lloj qortimi. Ndoshta i Dërguari i Allahut kishte frikë se mos ai rrëshqiste edhe më keq. Ndoshta i dinte që më parë shërbimet që kishte për të kryer Hamzai për Islamin...

Në luftën e vështirë të Uhudit, Hz. Hamzai ra dëshmor në një mënyrë që i shkonte vetëm atij. Në asnë vend,asnë gaziu, fitimtari, nuk i ka rënë në pjesë një trimëri e tillë!

Me ç'na thonë historianët, atë ditë ai kishte vrarë plot tridhjetë e tri vetë dhe pastaj kishte rënë dëshmor. Mendoni si e sulmojnë idhujtarët trupin e tij dhe e bëjnë copë-copë. E motra, Safije, i hidhet sipër, qan me të madhe dhe, ndoshta, në anën tjetër, përpinqet t'ia mbledhë copat e trupit që

ia kanë këputur e hedhur andej-këtej. Ndërkaq, nga njëra anë gjendja e Hz. Hamzait e nga ana tjetër gjendja e Safijes, nënës së Zubejrit dhe hallës së Profetit, e preknin shumë këtë të fundit e ia bënин zemrën copë. Nga myslimanët nuk kishte mbetur njeri pa marrë plagë. Myslimanët kishin dhënë gjer më gjashtëdhjetë e nëntë dëshmorë. Gjatë kthimit për në Medine, secili derdhte lotë për të afërmit e vet. Qahej për të vrarët, qahej për të plagosurit dhe në qill ngjiteshin klithmat e vajit për të plagosurit që vdisnin pasi ktheheshin në shtëpi. Në atë mjedis vajtimesh ishte dikush që ishte harruar e për të cilin nuk kishte njeri që të derdhte lot. Ishte më fisniku i dëshmorëve, ishte kryedëshmori, por s'kishte kush ta qante! Ja, pra, kjo pamje e preku edhe një herë tjetër thellë të Dërguarin e Allahut. Fjalët që nisen t'i derdheshin prej buzëve, ishin si rënkimet e një zemre të bërë copë-copë: "Oh, si s'ka njeri që të qajë për Hamzain!..." Kur i dëgjoi këto fjalë Sa'd b. Ubade, sikur e goditi dikush në kokë. Shkoi me vrap e i mbledhi gratë medinase. Dhe u tha: "Qani një herë Hamzain, pastaj të vdekurit tuaj!" Pastaj kjo u kthyte në zakon. Ç'është e vërteta, ky zakon s'arriti gjer në ditët tona, sepse një ditë u pre. Ç'e do që edhe sikur të gjithë myslimanët ta qanin Hz. Hamzain, para të vdekurve të vet, gjer në kiamet, prapë se prapë kjo do të kishte qenë pak për luanin e Allahut...

Dashuria që ndjejmë ne për Hz. Hamzain, nuk rrjedh prej personit të tij, por prej dashurisë së të tjerëve ndaj tij. I Dërguari i Allahut e donte, edhe ne e duam. Atë e do Zoti dhe emri i tij, "Esedullah, Luani i Allahut", është i shkruar në qill; prandaj edhe ne e duam.

Përveç këtyre, personaliteti i Hz. Hamzait bartte një kuptim të veçantë si pasojë e afërsisë së tij ndaj të Dërguarit të Allahut, gjë që është jashtë horizontit tonë të të kuptuarit. Shikimi ynë nuk shkon dot gjer atje. I Dërguari i Allahut qe sjellë ndryshe edhe në lidhje me Xhaferin. Kur kishte vdekur ky sahabi, pasues e shok i Profetit, për të cilin ky thoshte "me anën e jashtme dhe moralin më ngjet mua", kishte shkuar, i kishte mbledhur rreth vetes fëmijët e tij, i kishte marrë në prehër dhe kishte qarë mbi krye të tyre! Edhe tek Xhaferi kishte diçka si rrjedhojë e afërsisë me të Dërguarin e Allahut, gjë që ne përsëri nuk jemi në gjendje ta kuptojmë.

Ndoshta ndjeshmëria e treguar në këtë çështje nga i Dërguari i Allahut, sipas shikimit të Zotit, ka qenë shprehje e marrjes së një pozicioni. E shihni, ka gjithë ata pasues të rënë dëshmorë në Uhud. Ka, por, me ç'kanë vëzhguar shumë njerëz të mëdhenj, të urtë e të lartësuar shpirtërisht, të merituar për zbulimin para tyre të së fshehtës, kush të ketë mbetur në vështirësi e të ketë thirrur emrin e Hamzait, ky i është shfaqur menjëherë aty me kalin dhe shpatën në dorë. Kjo është diçka e posaçme vetëm për të.

Mund të ketë shumë e shumë trima që kanë dhënë ose kanë për të dhënë jetën më pas në po ato kushte të rënda, që janë bërë ose kanë për t'u bërë shoshë nga plumbat. Por kurrsesi nuk mund të krahasohen me ata që kanë luftuar nënisje të kësaj pune, në kushte shumë të rënda, si dhe në mjedisin e ndritshëm të të Dërguarit të Allahut. Vendi i Hz. Hamzait është i veçantë edhe midis tyre! Në këtë mes, mund të dalin edhe të tillë të cilët do të donin ta interpretonin këtë çështje si rrjedhojë e një afërsie të natyrshme, por një interpretim i tillë është i dobët aq sa s'është për t'i dhënë rëndësi.

19. A mund të na jepni njohuri të hollësishme mbi Gurin e Zi?

Është një gur i lumtur. Në çdo punë të Zotit ka një urtësi. Qabeja është një ndërtesë dhe ne në namaz drejtohemë kah ajo. Por kahja jonë e vërtetë, ashtu siç thotë edhe ajeti “*Ejne ma tuvel’lu fe themme vexhhullah*”, është Allahu! Domethënë ne drejtohemë kah miratimi, kah pëlqimi i Allahut.

Disa vendeve Zoti u ka falur bekim e shenjtëri, si faltorja e Jerusalemit, *Mesxhid-i Aksa*, faltorja e Mekës, *Mesxhid-i Haram*, varri i Profetit, *Ravda-i Tahire*. Po, dheu që mban në gjithë Dërguarin e Allahut, është i shenjtë e i bekuar. Sipas dëshmisë së mijëra dëshmitarëve, ata që e kanë përdorur atë dhë për qëllime mjekimi, kanë gjetur shërim. Edhe vendbanimi ku ndodhet ai varr, është i shenjtë e i bekuar.

Allahu është i zoti i mallit dhe e administron atë si të dojë. Ashtu siç e ka bërë njeriu superior mbi të gjitha gjallesat, po ashtu edhe Profetin e Dy Botëve e ka vënë para engjëjve dhe e ka bërë superior ndaj tyre. Ai bën si të dojë. Është në dorën e Tij edhe të bëjë të nderuar e të vyer, edhe të bëjë të ulët e të përbuzur. Ja, pra, Ai e ka bërë të vyer një gur, i cili është pranuar si i shenjtë e i bekuar nga të gjithë njerëzit. Ajo që na takon ne, nuk është të dimë për një vend ose send të caktuar se pasqyrë të ç’bukurie e të ç’enigme e ka bërë Zoti atë, por të tregojmë respekt ndaj vendeve e gjëra të cilat Ai i ka konsideruar si të shenjta e të bekuara.

Sipas disa rrëfimeve të përcjella gojë më gojë gjer në ditët tona, historia e gurit për të cilin po bëjmë fjalë, nis me ndërtimin e Qabes prej Hz. Ibrahimit. Ky e ka prurë këtë gur nga maja Ebu Kubejs dhe e ka përdorur fillimisht si skelë gjatë ngritjes së mureve të Qabes. Ja pra, ky gur ku ka shkelur këmba e Hz. Ibrahimit, Mikut të sinqertë të Zotit, është bërë i vyer me shenjtërinë që Ai i ka dhuruar.

Ka edhe rrëfime sipas të cilave ai ka ardhur nga xheneti. Ndoshta është një meteor ose një gur i rënë nga qielli. Ky gur është quajtur i vyer meqë ka ardhur nga një botë e lartë e posaçme për engjëjt. Por cilado që të jetë cilësia e prejardhjes, nuk ndikon mbi gjendjen e sotme të tij. Sido që të jetë, ai është për ne një gur i shenjtë. I themi gur, sepse nuk mund ta emërtojmë me ndonjë fjalë tjetër. Po të ishte gjetur një fjalë tjetër më e përshtatshme për ta shprehur cilësinë e tij, me atë do ta emërtonim. Kjo është një çështje etike dhe edukate.

Kohë pas kohe nga guri janë shkëputur copëra që janë dërguar në vendbanime të tjera nga ana e disa sunduesve. Pjesa e mbetur në trajtën dhe madhësinë e sotme, qëndron në një qoshe të Qabes dhe, në dashtë Zoti, do të qëndrojë atje gjer në kiamet.

Tek ky gur ka enigma të caktuara. Te ai qëndrojnë fshehir urtësi të holla që ne nuk i dimë. Profeti ynë bën të ditur se ai gur ditën e kiametit do të dëshmojë. Si ka për të ndodhur kjo? Sot këtë çështje mund të mos e vërtetojmë me anë të analizave shkencore. Teknika e ditëve të sotme mund të mos jetë e mjaftueshme për këtë. Mirëpo ka mrekulli të tillë të ngjashme që i kemi parë, të cilat e mbështesin mendimin tonë. Për shembull, ashtu siç është një mrekulli të folurit e njeriut, i realizuar me kombinimin e gjëra të ngurta e jo të gjalla, po ashtu është një mrekulli edhe dëshmimi i Gurit të Zi. Parimisht kështu është, por ambientimi, të mësuarit, ka bërë që gjërat të na duken të zakonshme, për pasojë, ta harrojmë këtë mrekulli tek njeriu. Ashtu siç ekziston tek njeriu aftësia e kujtesës dhe ashtu siç ruhen në kujtesën e tij mijëra informacione, ashtu është edhe krejt normale që, në sajë të krijimit të Zotit, një cilësi apo situatë e tillë të jetë e pranishme edhe te Guri i Zi. Ka mundësi që ai, si mijëra shirita videoje, të regjistrojë zërat dhe portretet e atyre që e vizitojnë dhe këto regjistrime mund të marrin vlerën e dëshmive në botën tjetër.

Por për ne nuk ka rëndësi se si qëndron puna në thelb. Edhe sikur në vend të tij të vihej një copë dërrasë të cilës t'i jepej e njëjtë vlerë, edhe atë do ta respektonim në të njëjtën mënyrë. Sepse rezultatin e një pune ne e mbështesim gjithmonë tek Zoti ynë dhe atë që presim, e presim vetëm prej Mëshirës së gjerë të Tij.

Një radhë, duke e puthur Gurin e Zi, Hz. Omeri thotë: "O gur, unë e di se ti je një gur që s'mund të sjellësh as dëm, as edhe dobi. Pra, kurrë nuk do të të kisha puthur sikur të mos kisha parë të Dërguarin e Allahut duke të puthur". Thuhet se Hz. Aliu që i ndodhej pas, i pëshpërit: "O Omer! Po t'i dije enigmat që fshihen tek ai, nuk do të flisje kështu si tani!"

Të drejtën e çdo gjëje Allahu e di!

20. A thuhet "Bismil'lah..." kur bëhet lutje? Si duhet të bëhet lutja?

Nuk ka ndonjë rregull të mbështetur mbi një urdhër që lutjet të nisin me "Bismil'lah...". Ne jemi të urdhëruar të bëjmë "Bismil'lah" kur nisim të këndojmë Kuran. Megjithatë, kam mendimin se nuk ka ndonjë pengesë që edhe lutjet të nisin kështu. Në fakt, meqë në të përgjithshmen e rregullit, sipas të cilit çdo punë e dobishme duhet nisur me "Bismil'lah", hyn, gjithsesi, edhe një punë e dobishme si lutja, mundemi të themi se nisja me "Bismil'lah" në lutje është sunet, këshillë dhe traditë e mirë.

Sa për mënyrën se si duhet bërë lutja, ato çka na janë këshilluar për këtë gjë, shkurtimisht janë këto:

E para: Ta falënderojmë dhe lartësojmë Zotin me një dëshirë që buron prej zemre ose, siç themi shqip, me tërë zemrën, nga thellësitë e zemrës!⁴⁷

Ja, për shembull, mund të themi kështu: "Zoti im, Ti je krijuesi i qiejve e i tokës! Ti e di se ç'kam në zemër! Ti ma ke shtruar në zemër besimin dhe sigurinë! Ti ma mbush zemrën me dëshirë e ma përgatit qysh tani xhenetin tim! Prapë Ti e bën bilbilin të këndojet, lulen të çelë ngjyra-ngjyra e të lulëzojë!", etj. Numërimi i gjërvave që janë e ndodhin në natyrë, mrekullitë e panumërtë që shohim në gjithësi, duke ia atribuuar që të gjitha Zotit me një stil ku të ndihet mahnitja dhe përulja e thellë ndaj Krijuesit, këto pra, janë falenderim e lartësim i Zotit, gjë të cilën e shohim vazhdimisht në lutjet e të Dërguarit të Allahut.

E dyta: Ta përmendim Profetin tonë duke iu lutar Zotit për t'i falur atij mëshirë e paqe. T'i dërgojmë atij përshtendetje. Për këtë, në terminologjinë fetare ka formulime të caktuara. Njëra prej këtyre dhe më e shkurtra, është: "*Alejhi selam!*" Kuptimi i kësaj është kështu: "Paqja (shpëtimi) qoftë mbi Të!" Kjo shkruhet shkurt dhe në kllapa menjëherë pas emrit të tij, (a.s.). Kurse formulimi tjeter, por më i gjatë është ky: "*Sal'lallahu alejhi ue sel'lem!*" "Pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Të!" Kjo shkruhet shkurt me iniciale kështu: (s.a.s.).

Kjo është e njëjtë si të përshtendesnim, duke trokitur në një portë, të zotin e asaj porte, atë që mban çelësat e saj. Lutja nga zemra për Profetin tonë nga të gjithë myslimanët dhe sa herë që ta përmendim emrin e tij, do të thotë krijimi i një atmosfere nderimi e respekti të thellë për të dhe një

⁴⁷ Adoptimet për shqipen të këtyre fragmenteve që këtu e poshtë, janë të përkthyesit.

lutje e tillë e bërë sinqerisht, pa asnje dyshim që do të pranohet. Njëkohësisht, shoqërimi i lutjes sonë që i drejtojmë Zotit me një qëllim të caktuar, me përshëndetjen për Profetin e nderuar, do të thotë vënie e asaj lutjeje nën garanci.

E treta: Të bëhet lutja pa ndjerë dhe shfaqur lëkundje as sa grimca se ajo ka për t'u pranuar në mënyrë absolute prej Zotit si dhe, me kushtin e pandarë të lutjes, duke e bërë atë me përgjërim të thellë e me pamje të përulur, për shembull, krejt si të ndodheshe në mes të detit pasi të të jetë mbytur anija, i kapur vetëm në një copë dërrase, duke e pasur krejtësisht të qartë se s'ke asnje shpëtim përveç ndihmës së Zotit, me një nënshtrim absolut ndaj Tij... Kështu i duhet drejtuar Zotit dhe kjo duhet të jetë fryma e lutjes, principalitet dhe sinqeritet...

Të mendosh se lutja nuk të është pranuar, është kategorikisht e gabuar. Po qe se lutja është bërë sipas kushteve të saj, absolutisht pranohet. Vetëm se cilësia dhe niveli i pranimit mund të mos jenë të njëjta me atë që e mendojmë ne. Disa herë, meqë ajo çka kërkojmë nuk është për të mirën tonë, gjë që s'mund ta dimë që më parë, Zoti na fal jo atë që kërkojmë, por atë që në fakt nuk e kërkojmë. Dhe disa herë, lutja jonë pranohet për llogari të jetës sonë të pastajme. Prandaj, është shumë e rëndësishme të bëhet lutje me mendimin se lutjet e bëra do të pranohen në mënyrë absolute!

E katërtë: Lutja duhet përfunduar përsëri me përshëndetje për Profetin (a.s.).

Lutja është shprehje e një adhurimi të kulluar, e frysës së nënshtimit të robit ndaj Zotit. E thënë ndryshe, robi, duke njohur dobësinë, varférinë dhe pamundësinë e vet, i drejtohet portës së Zotit që zotëron fuqi, mundësi dhe pasuri të pafundme, drejtpërdrejt, pa ndërmjetësi dhe i kérkon diçka.

Dhe një tjetër specifikë e rëndësishme mbi të cilën duhet qëndruar me këmbëngulje, është kjo:

Nëse këmbëngulet disa herë, me anë të lutjes, shkaqet elementare bien (mënjanohen) dhe Zoti e pranon lutjen. Sepse edhe të gjitha shkaqet, gjithashtu, janë në dorën e Tij të fuqishme. Ai zotëron fuqinë për të krijuar çdo gjë dhe në trajtën që dëshiron. Mjafton që lutja të bëhet brenda një vetëdijeje të tillë dhe të kihen kujdes momentet e duhura për një lutje të rregullt.

21. Si duhet vlerësuar këshilla e Profetit për t'i rrahur gratë?

Nuk ekziston ndonjë këshillë e të Dërguarit të Allahut (a.s.) për t'i rrahur gratë. Ato çka ka thënë ai në hutben e tij të lamtumirës, janë të njohura për të gjithë. Kurse kjo pyetje, në fakt, ka lidhje me suren *Nisâ* të Kur'anit. Çka thuhet në ajetin-argument të asaj kaptine e çka u këshillohet burrave, janë si më poshtë:

E para: Puna e parë që duhet të bëjnë burrat ndaj grave që dyshohen për mosbindje, paturpësi dhe kundërshtim, është t'i këshillojnë ato.

Gratë ndodhen në dorën tuaj, bëjnë ato punë që doni ju, kryejnë vazhdimin e brezit; edhe ju, si udhërrëfyes e prijës të vërtetë për to, i këshilloni, i orientoni dhe përpinquni t'i lartësoni ato në qellin e të qenit njeri. Ato kanë një pjesë dobësish dhe prirjesh. Në lidhje me të, ju vazhdimisht do të bëheni mbështetje për to dhe do t'u tregoni rrugën e drejtë. Ndoshta ato do të duan të përdorin mundësitë apo rastet që kanë në dorë, por detyra e parë që ju bie është t'i afroni te Zoti.

E dyta: Vendi ku gruaja është superiore e ku e vë poshtë burrin, është dhoma e gjumit. Nëse në dhomën e gjumit gruaja arrin t'i imponohet burrit, ky i fundit nuk mundet më ta bëjë gruan t'ia dëgjojë fjalën jo aty, por as edhe në faqe të tjera të jetës. Ja pra, nëse aty ku gruaja është zotëruese, burri i jep hakun vullnetit të gruas pa kaluar masën e edukatës, pa i vënë në dijeni për ato çka bën, njerëzit e shtëpisë apo të tjerët jashtë, si dhe duke ruajtur intimitetin e çështjes, i jep hakun, pra, dhe nuk del i mundur atje, ardhja e gruas në udhë psikologjikisht do të jetë më e lehtë. Vetëm se në këtë moment ku duhet sjellë hollë, duhet ruajtur nga kalimi në ekstreme. Sepse është e pamundur të arrihet rezultati i pritur në secilin prej tyre, si në qëndrimin tepër të butë, ashtu edhe në qëndrimin tepër të ashpër. Burri nuk duhet të largohet nga dhoma, nuk duhet të sajobjë një shtrat tjetër, ndoshta, duke fjetur në po atë shtrat, do t'i kthejë shpinën gruas e do të mbajë distancë. Fundja, dhënia e hakut të vullnetit me zgjuarsinë e atij momenti do të bëhet i qartë. Kështu, burri që e ka vënë poshtë gruan me armën e saj, ka arritur të mos i japë rast që të përdorë mundësitë e saj specifike dhe shfaqjeve egoiste të saj u ka dhënë përgjigje me egon e vet.

Vetëm se duhet të kujtojmë që specifikat e përshkruara në ajet, i përbahen një sistematike të caktuar. Shkurt, në fillim niset me këshillë. Nëse nga këshilla nuk del asnjë dobi, atëherë provohet të braktiset gruaja në shtrat.

E treta: Disa herë, të gjitha këto përpjekje s'japin fitim. Gruaja vazhdon të ruajë qëndrimin e keq të saj. Ja pra, në këtë moment pranohet si etapë e tretë një rrahje e lehtë brenda parimeve të caktuara dhe me kusht që të mos i lihet hapësirë ndonjë delikti.

Ja pra, duke u marrë parasysh këto tri etapa, kështu duhet parë kjo çështje, ndryshe, rrahja me të parën qoftë duke e konsideruar këtë në dobi, qoftë në dëm të saj, është mungesë drejtpeshimi. Në radhë të parë, rrahja nuk është parim. Në periudhën e Medinës, burrat shkojnë tek Profeti dhe i ankohen për sjelljen e keqe të grave. Dhe ai u thotë: "U bini lehtë, pa u shkaktuar dhimbje!" Pas njëfarë kohe, dhomat e bashkëshorteve të Profetit mbushen me gra që ankohen se janë rrahur prej burrave. Gratë e Profetit i parashtronin atij gjendjen. Atëherë Profeti shkon në faltore, i mbledh shokët e tij dhe u thotë: "Dëgjova se i keni rrahur gratë. Pas kësaj, gratë nuk do të rriven më!" Dhe e myll çështjen. Profeti, duke u dhënë burrave leje, kishte përgatitur kushtet për shfaqjen e ankesës dhe kur ajo ishte shfaqur, kishte thënë: "Nuk do t'i rrihni!"

Janë shumë hadithe, porosi profetike lidhur me ndalimin e rrahjes së grave. Këto porosi pothuajse kanë shkoqitur dhe sqaruar specifikat që ajeti i ka kaluar shkurt. Veçanërisht, rrahjen e gruas si një kafshë ditën dhe, pastaj afrimin tek ajo natën e kanë dënuar me një gjuhë të ashpër. Qëndrimi në mëngjes i dikujt që ka qenë i detyruar t'i këpusë natën të gjitha lidhjet, nuk është parë aspak me sy të mirë.

Rrahja është mënyrë të vepruari, leja e së cilës jepet si zgjidhja më e fundit dhe si rezultat i një drejtimi të detyruar. Ashtu siç e bëmë të qartë edhe më lart, rrahja përdoret atje ku rruga e parë dhe e dytë nuk sjellin dobi. Rrahja mund të praktikohet te ato gra që s'vijnë në rrugë ndryshe dhe të cilave, natyra që kanë, u jep mundësi të korrigohen vetëm me të rrahur. Megjithatë, kjo ka kufizimet e veta. Nuk duhet t'u shkaktohen shumë dhimbje dhe në asnjë mënyrë nuk do të goditet në fytyrë. I Dërguari i Allahut urdhëron: "Ruhuni nga goditja në fytyrë!"

Fytyra është pasqyra më e shkëlqyer që përfaqëson mëshirën dhe bamirësinë e Zotit. Në fytyrë ka vijëzime që i përkasin këtij kuptimi, prandaj nuk duhet goditur. Qëllimi i goditjes, në vetvete, është pikërisht ngacmimi, zgjimi dhe vënia në veprim e krenarisë së gruas dhe respektit të saj për

vetveten. Për të arritur këtë, duhet përdorur mjeti mundësishët më i lehtë dhe në trajtën e tij minimale. Kur po shkruhen këto radhë, unë jam pesëdhjetë e ca vjeç. Dhe ende e kujtoj si atë ditë kur mësuesi i shkollës filllore ma tërroqi lehtë veshin duke më thënë: "Edhe ti?" Dhe duke e kujtar këshillën që pata marrë nga ai edukator, e ndjej të njëjtë si atë ditë!

Thamë se rrahja e gruas për ta korriguar atë, është zgjidhja e fundit. Dhe shtuam se në asnë mënyrë nuk duhet të jetë e dhimbshme. Në këtë moment duhet ta bëjmë të qartë këtë gjë: Në rrahjet jashtë mendimit për korrigjim dhe me dhimbje, burri bëhet përgjegjës para Zotit dhe sjellje të tillë nëasnë mënyrë nuk janë të lejueshme!

Ashtu siç mendojmë se me anë të këshillës do ta rregullojmë, e këshillojmë dhe përdorim të gjitha rrugët e këshillës, ashtu siç e bojkotojmë duke ndarë shtratin, por pa ia thyer krenarinë dhe pa e turpëruar, me mendimin vetëm për ta korriguar, ashtu edhe do ta përdorim rrahjen e lehtë nëse mendojmë se gruaja do të korrigohet dhe veprimi ynë do t'ia arrijë qëllimit. Ndryshe, rrahja si kafshë me pretekstin se sillet keq e ngre krye, është një veprim injorant dhe i papjekur, pa ndonjë kuptim, pa pasur ndonjë qëllim dhe synim të caktuar, i cili e bën përgjegjës e e turpëron njeriun para Zotit. Kjo është e vlefshme edhe për të gjitha trajtat e tjera të edukimit. Për shembull, një mësues nuk mund ta rrahë nxënësin përtej qëllimit të korrigjimit dhe edukimit, përndryshe, në ato kushte, edhe ai bëhet përgjegjës.

Tani po ju pyes unë ju: Cili njeri që ka logjikë mund ta kundërshtojë këtë rrahje të konkluduar pas hetimit shkallë-shkallë të mënyrave e mjeteve të tjera? Dhe nëse ndër njëqind gra, një rrahje e tillë e njërsë bën ndikim pozitiv dhe e sjell në rrugë atë grua, përsë do të duhej që feja islame ta pengonte një zgjidhje të tillë? Kjo është një metodë edukimi. Duke thënë "Goditini!", Profeti këto kritere ka patur parasysh. Edhe kur ka thënë "Mos i goditni!", ka thënë për ta mbrojtur gruan ndaj rrahjeve të bëra me tortura, dhimbje, mundime e mbi ndjenjën e hakmarrjes.

Një specifikë që mund të na shkojë në mendje lidhur me këtë subjekt, është edhe kjo: Burri e rreh gruan nëse ajo i largohet me neveri ose kundërshton; po nëse burri sillet kështu, pse gruaja nuk e rreh?

Burri është përgjegjës. Ajeti Kuranor thotë: "*Burrat janë përgjegjës për gratë...*" (Kurani, Nisa: 34) Dhe vazhdon duke dhënë arsyen: "...*ngase Allahu ka graduuar disa mbi disa të tjerë...*" (Po aty). Në pikë të caktuara, Allahu ka bërë eprorë disa ndaj disa të tjerëve. Në shumë pikë, burrat kanë epërsi ndaj grave. Mirëpo kjo epërsi duhet vlerësuar si epërsia e disa organeve mbi të tjerat në një trup të vetëm. Për shembull, nëse në këtë organizëm burri është si syri, gruaja është si veshi; ose, nëse burri është truri, gruaja është zemra. Ja pra, një marrëdhënie e tillë serioze ekziston mes tyre. Por bashkë me pranimin e një veçantie të tillë, nuk mund të mohojmë as epërsinë e burrit ndaj gruas në kuptimin absolut.

Burri mund ta kalojë gjithë vitin me punë. Disa herë bën edhe punët më të rënda. Në aspektin fizik dhe psikologjik, gjithmonë është më i fuqishëm. Edhe bota perëndimore, në punët më të rënda, burrat përdor. Për punën në miniera gjithmonë burrat zgjidhen.

Kurse gruaja është e detyruar që disa ditë të muajit të mbetet jashtë rrëthit. Në lehoni nuk mund të bëhet aktive disa herë gjer në dy muaj. Në aspektin fizik e të vullnetit, është e dobët. Nuk mund të ndodhet çdo kohë në çdo pjesë të shoqërisë. Në disa situata, duke humbur amanetin më të shenjtë, mund të vijë në gjendje që të mos mundet të shohë njeri ndër sy, prandaj është e detyruar të jetë

shumë e kujdeshme. Po s'pati njeri të afërt që ta shoqërojë, nuk mund të udhëtojë në vende të largëta.

Po qe se do të merreshin parasysh të gjitha këto, të tilla si këto që na duket e tepërt t'i përmendim, si dhe situata që janë të njohura për të gjithë, epërsia e burrit mbi gruan del sheshit si një e vërtetë e pamohueshme. Krahas kësaj, fakti që shoqëria ka nevojë për të dy sekset, është i qartë pa pasur nevojë për ndonjë shpjegim. Me parandjenjën e saj dhe ndjenjën e dhembshurisë që bart në vetvete, gruaja është shumë eprore ndaj burrit. Prandaj kujdesin për fëmijën e merr përsipër nëna. Sepse kjo nuk është një punë që mund ta bëjë ose ta nxjerrë në krye burri. Ndërkaq, burri është i qëndrueshëm ndaj erozionit të dukurive. Ai është i aftë për të përballuar edhe punët më të rënda.

Kur fëmija nis të qajë mu në mesnatë, disa herë babai ndërron edhe dhomën. Kurse nëna bën të kundërtën. Nëse është në një dhomë tjetër, kur dëgjon të qarën e fëmijës, vrapon menjëherë në dhomën e tij. Ndoshta disa herë i qëndron gjer në mëngjes mbi krye. Për fëmijën ajo bart një dhembshuri të marrë. Madje për këtë ka një tregim hiperbolik. Djali i keq e kishte prerë e bërë copa-copa t'ëmën. Kur kishte dashur t'i fuste një thikë edhe në zemër, kishte prerë edhe dorën e vet. Dhe kishte thirrur: "Nënë!" Dhe nëna, ashtu copë-copë nga thikat e tij, i ishte përgjigjur me dhembshuri: "O birl!" dhe i ishte hedhur mbi dorën e prerë.

Ky është një sajim letrar, por askush të mos ketë dyshim se, nëse fëmija, sado i keq që të jetë, edhe i tillë si ai i tregimit, nëse do t'i binte ndonjë e keqe mbi kokë dhe do të thërriste pér ndihmë, prapë nëna do të ishte ajo që do t'i përgjigjej që me thirrjen e parë! Ja pra, me këtë ndjenjë është gruaja eprore mbi burrin. Kur kjo përparësi përdoret me vend, bëhet pretekst pér dobi të mëdha!

Gruaja rrit brezin. Me një edukim të mirë, i ngjit ata në majat e njerëzimit. Burri, një pjesë të madhe të jetës e kalon jashtë. Kurse gruaja dridhet mbi krye të fëmijës nga mëngjesi në darkë dhe i tregon atij rrugët që të çojnë në të qenët njeri.

Trimat rriten nga nënët. Njerëzit e mëdhenj, ata me të cilët krenohet njerëzimi, gjithëpo rriten prej nënave. Nëse gruaja me aftësitë e saj të posaçme vetëm pér të dhe, nga ana tjetër, burri me mundësitë, edhe ato të posaçme vetëm pér të, bashkohen në rrugën e jetës, nga ky bashkim trupëzohet një familje ku përjetohet atmosfera e xhenetit dhe një shoqëri njerëzish të virtytshëm.

Burri pa gruan është i mangët, po ashtu edhe gruaja pa burrin. Prandaj edhe në xhenet, ku çdo gjë është në cilësinë e saj më të përsosur, Hz. Havaja është krijuar menjëherë pas Hz. Ademit. Po qe se do të ishte ajo që do të ishte krijuar e para, pa dyshim që Hz. Ademi do të krijohej menjëherë pas saj. Sepse që të dy nuk mund të bënin njëri pa tjetrin.

Gruaja është e ngarkuar me përgjegjësinë pér të marrë përsipër punët e brendshme të shtëpisë, kurse burri punët jashtë saj. Ndërsa punët e burrit kanë anën e tyre të vështirë, këtë jemi të detyruar ta themi edhe pér gruan. Mirëpo, fitimet dhe detyrimet materiale i përkasin burrit, ai është caktuar përgjegjës mbi gruan dhe familjen dhe të gjitha këto e rëndojnë akoma më tepër detyrën e tij. Sigurimi i nevojave materiale të gruas dhe fëmijëve i janë ngarkuar burrit.

Të drejtat e gruas që propozohen sot nga feministët, në fakt, do të thonë që të merret gruaja prej pozitës së saj të lartë, të vihet nën këmbë e të poshtërohet. Si shëtitja verës lakuriq dhe dimrit mbështjellë me pallto e gëzofe, edhe përpjekja pér ta mashkullorizuar femrën, i njëjtë shembull idiotësie është. Gruaja është sultaneshë, është e madhe, është zonjë pér sa kohë qëndron në vendin

e saj. Edhe burri, për sa kohë që nuk e kalon kufirin, është i vyer e i denjë për respekt. Ata që kërkojnë t'u ndërrojnë vendet gruas e burrit, i Dërguari i Allahut i mallkon, sepse kanë hyrë në përplasje me krijimin. Mendoni se në ç'gjendje mund të sillet njeriu nëse do t'u ndërroheshin vendet organeve: veshët të viheshin te gjunjët, hunda në mes të barkut, sytë në fund të këmbëve... Edhe përpjekja për ta bërë gruan si burrë dhe burrin si grua, në të njëjtën gjendje do t'i sillte ata. Gruaja është e bukur dhe natyrale për sa kohë është grua, po ashtu edhe burri. Përpjekjet për të kundërtën, është si t'u shpallësh luftë natyrës dhe krijimit.

22. Në ditët tona është i përhapur shpjegimi i Islamit me çështje përkatëse të shkencës dhe teknikës. Si e shihni këtë?

Po, në ditët tona, marrim në dorë degë të ndryshme të shkencës dhe, duke i shndërruar ato nga një lente më vete, i përdorim për të parë materien dhe dukuritë, madje edhe çështje fetare; edhe në tregim a shpjegim, i qëndrojmë po të njëjtës metodë. Për shembull, duke thënë Providenca Hyjnore ekziston, shprehemi se shkenca e fizikës, si tematikë, me iks fusha trajtimi argumenton ekzistencën e Zotit. Kimia, konstitucionin enigmatik dhe veçoritë e saj, me iks ligj dhe iks rrugë, vë gishtin në të njëjtën pikë. Astrofizika, me iks çështje shpall ekzistencën e Providencës Hyjnore... e të tjera si këto.

Disa herë, duke i vënë parasysh të gjitha këto së bashku, me dukuritë që zhvillohen brenda gjithësisë, në makro dhe mikroplan, bëjmë kërkime të argumenteve rrëth ekzistencës dhe Njësisë së Tij.

Është një libër me titull Mjekësia është altar i besimit⁴⁸. Ky emër mua më vjen shumë tonik. Nuk mund të mendohet që një njeri të marrë arsim mjekësor dhe të mos i besojë Zotit. Po ashtu, në atë altar lexohen vazhdimesht çështje rrëth besimit.

Anatomia e njeriut është krijuar në një nivel cilësor marramendës të tillë që nga çdo anë që ta shihni njeriun, përballet harmonisë që do të ndeshni, do të kapërceni vetveten dhe do të thoni: Allahu Ekber, Allahu është më i Madhi! E një altar i tillë është mjekësia!

Në ditët tona, përgjithësisht, përpinqemi ta shpjegojmë fenë tonë duke iu drejtuar shkencave të ndryshme. Duke parë Kuranin dhe duke u përpjekur t'i bëjmë të tjerët që ta shohin, i përdorim këto shkenca si mjete në synimin për të treguar mrekullinë e tij. Për shembull, etapat embriologjike që kalon fetusi, të gjitha këto pohohen në Kuran sipas specifikës së provuar sot me radhë dhe që do të provohet në të ardhmen. Si ka ndodhur që këto etapa të zbuluara e të provuara me teknikën e përparuar bashkëkohore e me ndihmën e rrezeve roentgen, të jenë zbuluar e provuar katërmëdhjetë shekuj më parë nga një person i paarsimuar? Kjo është e pamundur t'i ngarkohet një njeriu. Po qe kështu, Kurani nuk mund të jetë fjalë e profetit. Pas gjithë këtyre që u thanë, arrijmë në këtë përfundim: Kuran është fjala e Allahut. Provimi se Kurani është fjala e Allahut, do të thotë, në të njëjtën kohë, pranimi i profetësisë së atij që e shpalli atë. Pas kësaj, është e mundur që të trajtohet në një radhë të tillë pothuaj çdo çështje që i përket besimit.

⁴⁸ Në origjinal: El-Tib Mihrab ul-imán (arab.)

Ngaqë në subjektin e provimit të mrekullisë së Kur'anit u përqendruam si çështje më vete dhe me shpjegime, nuk dua të zgjatem më shumë me shembuj. Çështja që dua të tregoj këtu, është kjo:

Ne u drejtohemë shkencave të ndryshme dhe përpinqemi të tregojmë fenë tonë me anë të tyre, sepse konstruksioni i kokës së njeriut ndodhet sot i mbështetur në këtë pikë. Fronti përballë dhe mendimi materialist vazhdon të përpinqet t'i përdorë çështjet përkatëse të shkencës dhe teknikës nga një objekt më vete mohimi dhe blasfemie. Duke marrë si shkak këtë mashtrim, jemi të detyruar që njeriut tonë synxirë e mendjeturbulluar t'i provojmë se shkenca dhe teknika nuk janë antagonistë dhe armiq të fesë dukë përdorur të njëjtat objekte. Thënë ndryshe, si përgjigje ndaj rënies në mohim të materialistëve të tillë si Marks, Engelsi dhe Lenini pas shqyrtimit dhe vlerësimit të materies, konkludimi ynë në besim pas të njëjtë proces, na është kthyer në një detyrim të vërtetë. Personalisht, ashtu siç nuk shoh ndonjë të keqe në kundërsulme të këtilla, besoj madje, në domosdoshmërinë e vetaftësimit të kuadrove besimtarë të ditëve të sotme në atë nivel që do të mund t'i trajtonin çështje të tilla në mënyrë shumë më komode. Sepse ajetet e Kur'anit, vende-vende, duke na kapur për dore na ngjisnin qiejve, na shëtisin nëpër yje, galaktikave e sistemeve, na vënë të vëzhgojmë dhe, dimensionet e gjithësisë na bëjnë të njojur madhështinë tronditëse të mbretërimit të Providencës Hyjnore. Pastaj na shëtisin mes njerëzve. Na tërheqin vëmendjen rrëth organeve të njeriut dhe këtë udhëtim tejet të gjatë e çojnë gjer në botën e molekulave. Disa herë thonë se dijetarët do të jenë njerëzit më respektues ndaj Allahut dhe, me deklarata të ngjashme si kjo, i nxisin dituritë si dhe vënë gishtin në shumë e shumë çështje teorike e shkencore, bashkëbiseduesve u këshillojnë të vrashin mendjen e të kërkojnë. Ç'e do se është e domosdoshme që si kusht i parë, duhet të kihet parasysh që trajtimi i specifikave të kësaj tematike të jetë në përputhje me shpirtin e Kur'anit. Përndryshe do të thotë të korrigjosh (revizionosh) Kur'anin në emër të Kur'anit. Në këtë mes e shohim me dobi të tërheqim vëmendjen në një a dy specifika në pikëpamje të metodës:

E para, po të ngrihemë e të flasim për të vërtetat përkatëse të Islamit duke shfrytëzuar si mjet për të treguar diturinë tonë tema të tilla të cilat duhet t'i përdoren vetëm si mjete argumentimi, çdo gjë ndërron dhe asgjë nga ato që themi nuk vepron më mbi bashkëbiseduesin. Këto të vërteta të dala nga goja jonë të qarta e të bukura, i humbin ndriçimin dhe bukurinë në raport me qëllimin e fshehtë në zemër dhe na kthehen prapë të nxira sterrë. Ndërsa do të duhej që biseda jonë të synonte bindjen, nëse do të kishte për qëllim heshtjen (e bashkëbiseduesit), për çka do të përpinqeshim të thoshim ca gjëra, kurrë nuk do të ushtronim dot ndikim, pasi, me qëllimin tonë të mbapshtë, do të kishim bllokuar rrugët për të hyrë në zemrën e bashkëbiseduesit. Kurse në të vërtetë, kur të kemi vepruar me qëllim të mirë e drejtë, edhe po s'dalluam gjë ne vetë, mes dëgjuesve ata që ndjejnë interes për temën, do të kenë marrë pjesën e vet e do të kenë përfituar. Sepse bartim qëllimin për të treguar jo veten, por vetë të vërtetën. Madje, disa herë, ndodh që një bisedë e juaja për të cilën mendoni se nuk mundët të flisnit në përshtatje me përmasat e çështjes përkatëse, të ketë qenë më me ndikim dhe më me përfitim nga një bisedë tjeter po e juaja në të cilën besoni se përdorët një gjuhë të jashtëzakonshme, qartësisht të bukur⁴⁹. Domethënë së në trajtimin e këtyre tematikave synimi dhe qëllimi më i parë duhet të jenë fitimi i miratimit të Providencës Hyjnore, si dhe parashtrimi sipas nivelit të bashkëbiseduesit.

E dyta, duke menduar se çdokush flet për shkencën dhe teknikën, pushtohemi nga ndonjë kompleks dhe, me flatrat e kësaj ndjenje, i futemi zellit për të shpjeguar tematikën Islame, gjë që kategorikisht s'është e drejtë. Pale kur, duke bërë sikur jemi të dyshimtë për çështjet tona, me një

⁴⁹ Në origjinal: Takat-i lisanije (arab.)

nxitim nëpërkëmbës⁵⁰ vënë si qëllim që, me trajtimin e këtyre temave, t'u japim vlerë dhe forcë atyre çështjeve, gjë që është shprehje e mungesës së respektit ndaj të vërtetave që kemi pranuar. Sidomos pranimi për bazë i thënieve të shkencës e teknikës e pastaj vërtetimi i çështjeve tona me anë të tyre, është diçka që s'do të lejohej në asnje mënyrë.

Po të dëshironi, mund të bëjmë një përbledhje të tillë:

Shkencat janë, secila më vete, identiteti i një mjeti, i një fshese për të fshirë pluhurin dhe dheun e rënë mbi të vërteta potenciale⁵¹ në ndërgjegjet tona. Ndryshe, Zoti na ruajtë, po të fillonim të lëviznim duke marrë si pikënisje që shkencat tregojnë drejt e të përqiqeshim t'ua përshtasnim ajetet dhe porositë profetike atyre, për pasojë, aty ku nuk do të arrihej përshtatja, edhe ne vetë, edhe bashkëbiseduesi ynë, do të binim në dyshim dhe lëkundje. Kurse pikënisja jonë duhet të jetë e tillë:

Deklaratat e Allahut dhe të të Dërguarit janë të drejta. Edhe shkencat konsiderohen të drejta për sa kohë u përshtaten këtyre deklaratave, si dhe janë të gabuara për aq sa stonojnë. Në të njëjtën kohë, qoftë edhe pjesa e drejtë e shkencave, nuk përbën themel për të mbajtur në këmbë të vërtetat besimore. Në çështjet besimore ato mund të pranohen vetëm në cilësinë e një subjekti që jep një mendim ose të bën të mendohesh. Sa për subjektin që na i shtron në ndërgjegje dhe na i bën të prekshme të vërtetat besimore, ajo është dora udhërrëfyese e Zotit Tonë. Të presësh nga shkencat konkluzion të realizuar ose që do të realizohet me dorën e Providencës Hyjnore, është një goditje e tillë vdekjeprurëse në emër të jetës sonë shpirtërore, saqë i nënshtruari ndaj kësaj goditjeje zor të shpëtojë, sepse ai një jetë të tërë do të mbledhë argumente nga gjithësia dhe do të përpinqet t'i bisedojë këto në emër të Allahut e, në këtë mes pa i rënë në të, vetë do të mbetet vetëm një natyralist dhe vetëm një i apasionuar pas natyrës. Do të vështrojë kah ujërat, do të vështrojë kah pranvera, por në fakt, në ndërgjegjen e tij nuk do të gjendet as edhe shenja mikroskopike e një mugullimi⁵², e një blerimi. Ndoshta qoftë edhe një herë të vetme gjatë gjithë jetës nuk do të ndjejë në ndërgjegjen e vet përtej argumenteve dhe plotësisht praninë e Providencës Hyjnore. Në pamje, do të shpëtojë nga pasioni i natyralizmit, ama gjer në fund të jetës do të vazhdojë si një natyralist.

Për këtë arsy shkencat duhet t'i shohim pa prioritet. Dhe njeriu duhet t'i shohë me sy argumentet përkatëse të të gjithë shkencave: Ju jeni vetëm një fshesë. Kur shejtani vende-vende të më ketë shtënë pasigurinë, do t'ju marr e do të pastroj dheun e pluhurin. Sepse të vërtetat brenda meje janë aq me rrënijë, aq të thella dhe aq përshkëditëse, saqë jo ata si ju që ia thoni këngës në errësirë, por as ata që e legendarizojnë këtë çështje mes valles së dritave, nuk do të mund t'i shtojnë ndriçimit në ndërgjegjen time një dritë tjetër, qoftë edhe një molekulë!

Besimtari është i tillë me besimin në zemër e jo me grumbullin e njohurive në kokë. Për këtë shkak njeriu, pasi të ketë dalë në largësinë ku mund të ketë depërtuar me argumente objektive ose subjektive⁵³, po s'u zhvesh nga aparençat dhe cilësitë e tyre, nuk mund të hedhë qoftë edhe një hap në emër të përparimit; në këtë moment, do t'i hedhë diku në një vend pas shpine pothuaj të gjitha këto dhe drejtpërsëdrejti, nën spektrin ndriçues të Kur'anit, do të ecë në udhën e ndritshme të zemrës e të ndërgjegjes së vet, që të mundë të arrijë atë ndriçim që e kërkoi për një kohë të gjatë.

Një mendimtar perëndimor thotë: Që t'i besoja Zotit denjësisht, e ndjeva të domosdoshme t'i hidhja pas të gjitha librat që pata lexuar! Pa dyshim, libri i gjithësisë, libri i cilësive personale të njeriut

⁵⁰ Në origjinal: Tehâluk (arab.)

⁵¹ Në origjinal: Meknî (arab.)

⁵² Në origjinal: Filiz verme (turq.) dalje filizi, mugullim

⁵³ Në origjinal: Afâkî/enfusi (arab.)

dhe librat që bëjnë zbërthimin e këtyre, kanë secili nga një vend të vetin. Por, në fakt, pasi këta ta kenë plotësuar detyrën e vet, njeriu duhet të zhvishet prej tyre dhe duhet të mbetet kokë më kokë m besimin e vet. Të gjitha këto që treguan, janë çështje që mbështeten në njëfarë përvoje. Atyre që nuk janë të thelluar në to me përvojë ndërgjegjeje, këto thëniet tonë mund t'u duken teorike. Mirëpo shpirtrat më të ndriçuar që kanë marrë krahë në atmosferën e dëshirës pasionante për Zotin e tyre, e kuptojnë fare mirë se ç'duam të themi...

23. Pse Kurani bën fjalë për njerëz si Ebu Lehebi? A mund ta sqaroni urtësinë e kësaj? Si përshtatet kjo me stilin e Kuranit?

Ebu Lehebi, megjithëse i dalë në një vend të afërt me familjen Profetike, është një njeri i pafat e kokëngjeshur që s'ka mundur të përfitojë nga ajo drithë. Emri i tij i vërtetë është Abdyluzzâ.

Përbajtja e kaptinës Kuranore me të njëjtin emër, është kjo:

Iu thafshin të dy duart Ebu Lehebit! Dhe i janë tharë!

Nuk i sollën dobi pasuria dhe fitimet.

Do të digjet ai në një zjarr që flakëron.

Ashtu edhe gruaja e tij si drubartëse,

me një litar të përdredhur në qafë!

(Mesed,1-5)⁵⁴

Ashtu është! Ai e përdori vullnetin e tij gjithmonë për të keq! Shtroi ferra në rrugën nga do të kalonte Profeti dhe ndezi zjarre në rrugët që çonin në Qabe. Natyrisht që edhe ndëshkimin nga lloji i veprës do ta ketë e do të hidhet në zjarr. Fundja, ashtu është quajtur ai, "ebu leheb", i ati i zjarrit. Ky njeri i ngulur përballë luftës dhe përpjekjeve për ta përhapur dhe lartësuar fenë Islame, gjatë gjithë jetës së vet do të ngrejë pusi dhe do të thurë intrigë. Dhe ashtu bëri. Por çdo gjë që bëri, shterpi i mbeti!

Megjithëse e gjithë pasuria e Beni Umejes i kaloi atij dhe e shoqja, Ummi Xhemil, ishte shumë e pasur, e gjithë kjo pasuri dhe ato çka pati fituar, kurrë nuk i sollën Ebu Lehebit ndonjë dobi! Atë s'e shpëtuan dot as të bijtë, kurse ai krenohej aq shumë me ta!...

Ai nuk pati marrë pjesë në luftën e Bedrit. Kur pati mbërritur në Mekë lajmi i fitores së myslimanëve, pati kaluar një krizë nervore. Lajmëtari fliste për një ndodhi të papritur e thoshte që myslimanëve u ndihmonin ushtarë të çuditshëm. Mes atyre që dëgjonin këto fjalë, ishte edhe Ebu Rafiu, që e kishte fshehur besimin gjer atë ditë. Sapo dëgjoi këto fjalë, nuk duroi dot dhe tha: "Për Zotin, këta janë engjëj!" Këto fjalë e tërbuan Ebu Lehebin që iu drejtua me shpejtësi Ebu Rafiut, iu hodh sipër, e shtriu për tokë dhe po e shkelte me këmbë. Ebu Rafiu ishte skllavi i Hz. Abbasit. Zonja e Hz. Abbasit, Ummi Fadil, erdhi me vrapi dhe e qëlloi menjëherë në kokë Ebu Lehebin me shkopin

⁵⁴ Ky interpretim është i përkthyesit.

që mbante në dorë duke i thënë: "A po rreh një skllav pse s'e ka të zotin, more?" Ebu Lehebi nuk i ktheu dot fjalë gruas së të vëllait. Me kokën që i rridhte gjak, shkoi në shtëpi dhe nuk mundi më të dilte jashtë. Për shkak të kësaj goditjeje apo për një shkak tjetër, e kapi sëmundja e quajtur "Adese" nga vendasit, e konsideruar më e rrezikshme se murtaja. Kishte pasuri, kishte djem, por asgjë s'i vlente më. Shtatë ditë u përpëlit në shtrat. I vetëm. Kur vdiq, në krye s'i ndodhej askush, askush! Në dhomë nuk u fut kush as për të marrë kufomën. Më në fund, njerëzve të vet u erdhi turp. Pajtuan me pagesë ca beduinë në shkretëtirë që e morën kufomën e qelbur, e hodhën në një gropë dhe e mbuluan me gurë.

Megjithëse Ebu Lehebi ishte farefis me Profetin (a.s.), jo vetëm që s'përfitoi nga ajo dritë e të bëhej njeri, por përkundrazi, u bë armiku më i tërbuar i tij. Prandaj edhe e prisnin ndëshkime shumë të rënda edhe në këtë botë, edhe pas vdekjes. Një popull i tërë e pa se si u ndëshkua ai në këtë botë, kurse tani ai ndodhet në botën tjetër para ndëshkimeve të tjera...

E shoqja, prej fisit Beni Ummeje, ishte grua me prejardhje fisnike dhe e pasur. Armiqësia kundër të Dërguarit të Allahut i jepte një kënaqësi pothuajse sadiste. Pati marrë pjesë në shumicën e veprimeve të poshtra të organizuara kundër Profetit, prej të cilave ndjente kënaqësi të madhe. Po ashtu, ndjente kënaqësi të madhe të bartte ferra e driza e t'i shtronte në udhët nga kalonte i Dërguarit i Allahut, të bartte dru për t'i shtruar po nëpër rrugë e për t'i ndezur me qëllim që të digjej Ai. Në të vërtetë, ishte e dhënë pas dukjes aq sa të përdorte një tufë të tërë shërbëtorësh. Mirëpo marazi që kishte ndaj Profetit, e nxiste në atë mënyrë që ajo grua krenare, duke nëpërkëmbur krenarinë e vet, bënte ato punë që u përkisnin shërbëtorëve! Ajo, që përbuzte edhe gjerdanët duke e quajtur ulje t'i vinte në qafë, për ironi të fatit varte në qafë litarë për të ngarkuar në shpinë dru e ferra. Edhe ndëshkimin për punët e saj, nga i njëjtë lloj do ta hiqte. Sepse Kurani ashtu thoshte!

Ebu Lehebi ishte inatçor, kokëngjeshur. Për të, Ebu Xehli thoshte: "Kujdes, mos e nxehni, se po kaloi në anën tjetër, askush nuk e kthen më dot!" Dhe këtu kishte të drejtë. Mirëpo Ebu Lehebi e përdori këtë kokëngjeshje kundër të Dërguarit të Allahut! E shpenzoi në armiqësinë kundër Tij! U bënë një me të shoqen dhe i bekuan idhujt që ndodheshin në Qabe. I quajtën Lat, i quajtën Menat. Por për një gjë nuk bënë as edhe përpjekjen më të vogël, të ndaleshin një herë e të përpinqeshin për ta kuptuar njeriun që ishte rritur aty, mes tyre! Ata kurrë nuk e ndjenë të nevojshme të përfitonin nga ai person i zgjedhur, i dërguar si mëshirë për botët!

Ebu Lehebi i bëri vetëm të këqija të Dërguarit të Allahut. Edhe sikur të jetonte sa bota, prapëserapë të njëjtën gjë kishte ndërmend të bënte. Ai u bashkua me të tillët si Ebu Xehli në bojkotin trevjeçar kundër myslimanëve. Myslimanët i patën kaluar këta tre vjet duke u përleshur me vdekjen. Sa e sa fëmijë dhe pleq patën vdekur nga uria! Por në ndërgjegjen e Ebu Lehebit këto kurrsesi nuk patën zgjuar ndjenjën e mëshirës. Në këtë periudhë pati vdekur Hz. Hatixhja e hidhëruar dhe e rënë shpirtërisht për padrejtësitë dhe dhunën e ushtruar ndaj myslimanëve. Pati vdekur, gjithashtu, edhe i ungji i Profetit, Ebu Talibi, ai që e pati ndihmuar aq shumë e që i pati dalë për zot. Kurse e kundërtë e këtij, ungji tjetër, Ebu Lehebi, pati qenë përpjekur ta asgjësonte.

Ndërsa njerëz nga më të largëtit si fis patën ardhur herët e qenë përpjekur të rikrijonin lidhje gjaku e afërsie, Ebu Lehebi e pati quajtur për detyrë të kundërtën, të lagohej prej tij. Ç'i verbër ishte që nuk mundej ta shihte diellin - burim drite që i kishte lindur pranë dhe lartësohej?

Dhe tani, a nuk është e drejtë që Kurani thotë për të "iu thafshin duart"? Po të mos i thuhen kështu, a nuk do të merrej nëpër këmbë e drejta e miliarda njerëzve që besojnë? Si mund të mendohet kështu për Kuranin plot shprehje urtësie e drejtësie?

E para: Për shumë vetë që i kanë bërë të këqija Islamit, kanë zbritur ajete të hapura apo të mbyllura. Veli b. Mugire ka qenë njëri syresh. Për të Kurani përdor shprehjen: "I daltë shpirti, ç'vendim që mori!" Ai qe babai i Halid b. Velidit. Por dhe një prej armiqve të pamëshirshëm të të Dërguarit të Allahut. Me vete mendohej se ç'shpifje të hidhte për të dhe lëkundëj e vinte vërdallë: poet t'i thoshte, apo falltar, apo magjistar... Dhe mori vendim t'u thoshte Kuranit magji dhe Muhamedit magjistar. Edhe në Kuran, si përgjigje për këtë vendim të tij, Zoti u shpreh: "I daltë shpirti, ç'vendim të keq që mori!" Dhe sa e sa mohues të tjerë u goditën e u kërcënuan. Në këto kushte, po qe se për Ebu Lehebin do të bëhej përashtim, a nuk do të binte në kundërshtim kjo, me cilësinë gjithënjerëzore të Kuranit? Sigurisht që po. Sepse, kur dënohej Veli b. Mugireja, po të mos dënohej edhe Ebu Lehebi, dëshmitarët e kësaj pune a nuk do të mbërtheheshin nga pandehma se një njeri që kishte kryer aq shumë akte armiqësie kundër Profetit mbrohej vetëm se kishte afërsi familjare me të? Ja pra, Kuran nuk i la shteg kësaj dhe edhe Ebu Lehebin u futi në kategorinë e idhujtarëve të tjerë.

E dyta: Kjo kaptinë zbriti në Mekë. Kurse Ebu Lehebi vdiq menjëherë pas luftës së Bedrit, që i takon periudhës së Medinës, atëherë kur Profeti me myslimanët tashmë kishin emigruar dhe ishin vendosur aty. Domethënë se Kurani lajmëronte një të fshehtë, një ngjarje që do të ndodhët në të ardhmen: Ebu Lehebi do të vdiste si qafir, si mohues e po ashtu, edhe e shoqja. Dhe ndodhi krejt ashtu siç thoshte Kurani, u vërtetuan fjalët e Tij! Ashtu siç kishte ndodhur me të Dërguarin e Allahut, i cili para luftës së Bedrit u kishte treguar myslimanëve vendet ku kishin për t'u vratë idhujtarët e duke i cilësuar ata me emër dhe, pastaj, kur kjo ishte vërtetuar një për një, e kishte rritur shumë fuqinë shpirtërore të myslimanëve, ashtu edhe vdekja e Ebu Lehebit në të njëjtat kushte që paralajmëronte Kurani, e shton te fuqinë shpirtërore të myslimanëve e sikur i paralajmëronte ata të kishin kujdes. Çdo gjë që të thoshte Kurani, do të vërtetohej. Ishte premtuar qysh më parë fitorja e Bedrit dhe ajo kishte për të ndodhur. Në një periudhë kur numri i armiqve që rrëthonin një grusht myslimanësh ishte i panumërt, këto raste të forcimit shpirtëror të tyre nuk ishin aspak për t'u nënveftësuar. Përkundrazi, nisur nga rezultati i tyre pozitiv, në një pamje ishin kusht dhe të domosdoshme.

Disa herë, zgjimi dhe ardhja në vete që prodhohen tek njeriu prej një kokëçarjeje të vogël apo fatkeqësie, i përftojnë gjëra të tilla jetës shpirtërore, që, sikur të hapej perdja e të shiheshin ato çka kishin për t'u fituar, çdo njeri do ta kërkonte me gjithë zemër e me padurim ardhjen e asaj kokëçarjeje apo fatkeqësie! Përfitimet e pastajme e zbresin në zero atë fatkeqësi. Ja pra, edhe sikur të mos thuhen gjë - që bëhej në emër të njerëzimit - për njerëzit, humbja e ardhme e të cilëve kishte marrë formë të prerë, kjo nuk kishte për të ndikuar në përfundimin as sa grimca. Ç'kishte për t'u bërë ishte bërë dhe fundi i keq i tyre ishte i paracaktuar.

Ç'është e vërteta, këtu përmenden vetëm dy a tri vetë bashkë me përfundimin e keq të tyre dhe, nëse në pamje të parë duket se përmenden me një shprehje krenarithyese për njerëzimin, po qe se do të kihet parasysh që kjo gjë kishte për të forcuar shpirtërisht miliona njerëz që kishin për t'u bërë më të vetëdijshëm e të ndërgjegjshëm për qenien e tyre si njeri, po të kihet parasysh, më së pakti, se kjo gjë do të shërbente si pretekst për t'u ruajtur të mos binin në përfundimin e tyre, gjëja e parë që të vjen ndërmend është se vendin e mbresës jo të pëlqyeshme do ta zinin urtësi të tjera. Atëherë do

të kuptohej se sa e nevojshme ka qenë për besimtarët, nga aspekti psikologjik e pedagogjik, përmendja në Kur'an e Ebu Lehebit e njerëzve të ngashëm me të.

E treta: Si të fundit, mund të shtojmë edhe këtë që ky ndikim psikologjik, ashtu siç shkaktoi një zgjim, siç e thamë, në pjesën besimtare të shoqërisë së atëhershme, nisi edhe të prodhonte lëkundje në frontin e mohimit. Blasfemia e tyre absolute, duke u shndërruar në dyshim, ua lehtësoi hyrjen në rrugën e ndritshme dhe, bindjet që në fillim u ndodheshin vetëm në trajtë të burgosur në ndërgjegje, të nxjerra në shesh nën presionin e lëkundjeve, gjetën shtigjet për të hyrë në mendje dhe zemër e, më vonë, patën nisur të duken edhe rezultatet e para. Më pas, sa e sa vetë zhveshën rrobën e zezë të blasfemisë dhe veshën mantelin e bukur të besimit e u vunë në rrugën e orientimit. Dhe kjo, për besimin dhe njerëzimin, nuk ishte një përfitim i vogël.

Ja pra, nxjerra e rezultateve të tilla të mëdha me anë të përmendjes së fundit të dhimbshme të disa njerëzve, është një aftësi shprehëse e mrekullueshme, e tillë që përbën karakteristikën e pohimeve plot urtësi të Kur'anit e që i ka hije vetëm e vetëm Atij; arritja e rezultateve të tilla nuk i ka takuar gjer më sot asnjë fjale! Kjo është një model i mrekullueshëm thellësie e gjërësie që mund të përngjasohej me krijimin e mijëra dallgëve në oqean duke hedhur në të vetëm një gur të vogël! Po, prej asaj dite e gjer më sot këto dallgëzime rezonojnë në zemrën e mijëra e mijëra, madje të miliona njerëzve. Po, Kurani është reveluar me një stil shprehës të nivelit të lartë siç është, për shembull, me anë të forcës tërheqëse dhe nxitëse të frikësimit dhe dëshirimit, lajmërimi i vdekjes në blasfemi i një njeriu, gjë që, në të njëjtën kohë, është pretekst që miliona njerëz të hyjnë në udhë të drejtë. Dhe kjo është mjaft në përshtatje me shprehjen ligjëruese e oratorike të Kur'anit, është me vend. Është vetë urtësia!

24. Tema e haremit te osmanët është bërë një nga temat më të kritikuara. A mund të na ndriçonni rreth kësaj çështjeje?

Te ne, dhoma e gjumit është një gjë shumë e madhe dhe e shenjtë. Atje tharmohet soji dhe zhvillohet. Atje formohet familja me intimitetin e saj më të posaçëm. Prandaj ndodh që tek ne, dhoma e gjumit nuk hapet dhe në të nuk ftohen miq apo vizitorë. Jo të huajt, por aty nuk mund të hyjnë kur të duan as pjesëtarët e tjerë të shtëpisë. Dhoma e gjumit është aq intime dhe e posaçme, saqë, sipas edukatës që kemi marrë, sikur të na ftojë dikush ku kemi shkuar si mik, të flemë në dhomën e tij bashkëshortore si shenjë respekti dhe bujarie për ne, nuk pranojmë. Pse, si është puna? Edhe dhoma bashkëshortore e gjumit është, fundja, një dhomë gjumi si të gjitha dhomat e gjumit. Mirëpo, ja që tek ne çdo gjë është kaq shumë e ndryshme dhe kështu është zhvilluar. Në këtë kuptim, haremi nuk është diçka e posaçme vetëm për osmanët. Në të gjitha shtëpitë tona ka nga një harem të tillë. Prandaj, njeriu që i qëllon me gurë etërit për këtë shkak, gabon shenjë se, në vend që të qëllojë aty ku duhet, i bie kokës së vet!

Haremi te osmanët bart një kuptim disi më privat. Për shembull, haremi nuk është i hapur për këdo, si në shumë pallate, ndërtesa apo ndërtesarët e haremit janë të rrethuara me mure. Ja, pallati Topkapi është një ndërtesa e madhe e hapur vetëm për disa, kurse e mbyllur ndaj botës së jashtme me qëllim për të mbrojtur intimitetin e posaçëm të atyshëm, ku gratë dhe skllavet e pallatit mbretëror mund të jetonin dhe dëfreheshin të qeta dhe në mënyrë legjitime. Synimi i një rregullimi të tillë ka qenë që në vështrimet e zonjave dhe skllaveve të pallatit të mos binte ndonjë gjë e

papërshtatshme dhe të mbroheshin nga ndikimet e jashtme. Gratë, përgjithësish, femrat e haremët jetonin dhe dëfreheshin brenda mjedisit të haremët dhe sipas kritereve dhe normave islame. Ato nuk shihnin jashtë, kurse nga meshkujt, shihnin vetëm burrat dhe të afërmit e tyre të gjakut. Në fakt, kjo vidente edhe për burrat e pallatit. Edhe ata, pas atyre mureve të lartë, mjaftoheshin me shijet dhe kënaqësitë legjitime. Nëse jetesa pas mureve ishte jetë kalaje, ata ndanin të njëjtën jetë me bashkëshortet e tyre. Ja ku është harem, shkonë e shiheni! Po qe se këtë kritikojnë, do të thotë se nuk dinë se ç'kritikojnë.

Por po qe se kritikojnë praninë e shumë grave në harem, edhe për këtë kemi se ç'të themi.

Po, ka patur sulltanë osmanë që janë martuar me dy apo tri gra. Kurse ne as kemi ç'të themi, as mund të themi! Njeriu perëndimor dhe mendimi i tij nuk janë as parim, as gjithçka! Dikur ashtu e kanë menduar. Tani martesën me shumë gra e quajnë poligami dhe një gjë të turpshme. Kurse nesër do ta quajnë turp të sotmen!

Pastaj, kush duhet ta ketë thënë fjalën mbi këtë çështje, e ka thënë. Zoti i ka dhënë leje burrit të martohet gjer me katër gra, po qe se i plotëson kushtet përkatëse. Ata që e kanë përdorur këtë leje, nuk janë vetëm sulltanët osmanë, le t'i kritikojnë. Me dy-tri apo më shumë gra janë martuar Profeti, sahabet, njerëz të mëdhenj të fesë dhe shumë njerëz të tjerë, që falnin natën gjer në dyqind rekate namaz e që e patën kaluar jetën me adhurim. Kjo do të thotë se askush s'ka të drejtë ta marrë nëpër gojë këtë çështje që e ka lejuar feja. Meqë këtë çështje e kam trajtuar edhe në diskutimin mbi martesën e Profetit me shumë gra⁵⁵, po mjaftohem me kaq. Por po u desh, këtë konkluzion fetar mendoj ta analizoj si një çështje më vete.

Njëra prej specifikave të rrokura posaçërisht dhe të kritikuara kur bëhet fjalë për haremët, është tema e skllaveve ose robinjave. Pandeh se urtësinë e lënies hapur të institucionit të skllavërisë nga Islami e kam parashtruar me hollësi me rastin e dhënies së përgjigjes për një pyetje rreth skllavërisë dhe qëndrimit të Islamit ndaj saj.⁵⁶ Prandaj, këtu do të kaloj duke dhënë vetëm një mendim të shkurtër.

Skllavet për të cilat bëhet fjalë këtu, ishin robinja lufte. Myslimanët i merrnin nëpër shtëpitë e tyre, i edukonin, u tregonin rrugët që çonin në përsosmërinë njerëzore dhe i mbronin si t'i kishin miq të shtrenjtë. Krahë plotësimi të nevojave të tyre materiale, kujdeseshin edhe për nevojat moralo-shpirtërore. Po të bëheshin myslimanë, shpesh i linin të lira të largoheshin. Po të donin, mund të bashkëjetonin me to dhe atëherë, skllavja e bërë me fëmijë, quhej nënë fëmije, fitonte mundësinë për t'u çliruar dhe çlirohej me një nga mënyrat e njohura. Edhe bashkëjetesa ose, më saktë, marrëdhënia seksuale me to kishte kushtet e veta. Personi mund të hynte në marrëdhënie vetëm me skllaven e vet. Skllavja nuk duhet të ishte (të ndodhej) e martuar. Mbi të nuk duhet të kishte pronësi edhe dikush tjetër.

Nëse çështja duhet trajtuar brenda etikës së saj, skllavja ishte një mall, kurse zotëria e çlironte nga ky aspekt duke ia ngritur vlerën shoqërore. Ai e bënte atë një qenie me vlerë. Ndërkohë, edhe ia hapte dyert që e çonin në liri. Pa mendoni, veç kësaj, ato merreshin në pallat dhe respektoheshin me një respekt shumë më të madh se në shtëpitë e veta të mëparshme! Cili njeri me mend në kokë mund ta kundërshtojë këtë?

⁵⁵ Shih Lëkundjet që solli shekulli, vëllimi i parë.

⁵⁶ Shih po aty.

Ne po e shohim se si janë trajtuar e si trajtohen robërit në ditët tona. Ata mbyllen si një kope kafshësh në ahure, trajtohen në mënyrë të pështirë, kurse nga vuajtjet dhe klithmat e tyre, keqtrajtuesit e tyre ndjejnë kënaqësi sadiste. Të gjithë i dimë krimet masive kundër njerëzimit që ka kryer Perëndimi. Prandaj, kur i krahasojmë sjelljet dhe veprimet e tyre kriminale e antinjerëzore me realitetet që ata i kritikojnë, nuk rrimë dot pa thënë se ata nuk e kuptojnë se ç'është njerëzore dhe prandaj nuk e kuptojnë dot as sjelljen njerëzore të Islamit dhe urdhrin e Islamit për sjellje njerëzore! Por edhe nëse kjo lloj injorance i ka hije njeriut perëndimor nga koka gjer në këmbë, unë s'e gjej dot te ajo pjesë e tyre që zgjatet gjer te ne. Prandaj edhe mbeten i habitur!

Kur ata marrin robëri luftë nga ne, ne ç'do të bëjmë? Apo do t'ua kthejmë prapë me qëllim që të riarmatosen e të na kthehen prapë? Apo do të themi se ata le të marrin robëri sa të duan, se ne s'na lejon botëkuptimi ynë bujar? Po a s'do të ishte ky gjykim një kokëtrashësi e tepërt? Dhe në qoftë se ndaj anës tjetër nuk duhen bërë veprime ndëshkuese, pse duhet luftuar? Pse të vritten mijëra njerëz? Pse të mbeten gra të veja e fëmijë jetimë? Meqë shkohet në luftë duke i marrë parasysh pasojat qysh në fillim, do të thotë se secili i ka pranuar pasojat qysh në fillim. Dhe njëra prej këtyre pasojave është rënia rob. Po qe se trajtimi i robërvë bëhet sipas parimeve islame, a s'është më njerëzore? Siç marrin ata robëri prej nesh, edhe ne do të marrim prej tyre. Po ç'do t'i bëjmë robërit që do të marrim prej tyre? A do t'i lëshojmë apo do t'i vrasim? Jo, do t'i ndajmë mes myslimanëve. Në këtë mënyrë, atmosfera shpirtërore në shtëpitë e myslimanëve do t'i zbusë ata ndaj Islamit. Do të krijohen miqësi individuale dhe pa u shtrënguar aspak, pas një kohe, të gjithë ata do të shkrihen para këtij trajtimi dhe do të futen në Islam. Atëherë do të dalë në shesh burrëria dhe bujaria e myslimanëve. Myslimani do të kërkojë rrugët për ta shpëtuar nga robëria vëllain që ka zgjedhur fenë e tij. Vlera e çlirimt të sklevërve në Islam do të veprojë mbi myslimanin, nga njëra anë, si faktor nxitës, nga ana tjetër, si kundërshtëpërblym për mëkatet e kryera, edhe robërit do të fitojnë lirinë me rrugë të shumta që s'do të kenë të prerë.

Ne i trajtojmë robërit njerëzisht dhe përpinqemi t'i edukojmë ata në rrugën që shkon për te vlerat njerëzore. Ne i ndihmojmë ata për ruajtjen e ekuilibrit botë-përjetësi. Ne bëjmë gjithçka që na vjen ndoresh për hyrjen e tyre në Islam dhe i mbrojmë. Fundja, këto janë gjërat që bëheshin në pallat. Nga njëra anë, robinjat edukoheshin me cilësi njerëzore, nga ana tjetër trajtoheshin si zonja. Sa shembuj mund të tregohen për robinja që kanë tentuar të ikin nga pallati? Është e pamundur!

Veç kësaj, le të shohim në histori se ç'gjëra ka përfshirë një sjellje dhe trajtim i tillë. Në literaturën islame, ka një emërtim: *mevali*, ish-skllav i bërë zotëri e që ka arritur në shkallët më të larta të pozitës intelektuale e shtetërore. Mes tyre ka personalitetë gjeniale që do të kujtohen dhe përmenden kurdoherë me respekt të lartë.

Usame b. Zejd (r.a.) të cilin Profeti e donte aq shumë sa s'e ndante nga nipërit, qe caktuar komandant i një ushtrie të përgatitur kundër Bizantit. Mes ushtarëve ishin edhe personalitetë të tillë si Ebu Bekri dhe Omeri. Kurse Usame ishte vetëm një 18-vjeçar nga libertët. Edhe i ati, Zejd b. Harithe, pati komanduar ushtrinë islame në Mu'te dhe pati rënë dëshmor.

Nafiu që pati përgatitur një personalitet të tillë si imam Malikun, ishte nga libertët. Skllaves së vet shumë të dashur, Merxhane, Abdullah b. Omeri ia pati dhënë lirinë i nxituar dhe i entuziazmuar nga ajeti kuranor që u thoshte myslimanëve se nuk do të mund të arrinin devacionin e vërtetë nëse nuk dhuronin gjënë më të dashur. Abdullai e donte shumë atë, por, me dëshirën për të arritur devacionin e vërtetë, e liroi për hir të Allahut. Ja, kjo Merxhane u martua pastaj me dikë dhe nga martesa e tyre lindi Nafiu. Abdullah b. Omeri e donte shumë Nafiun, e merrte pranë dhe e

përkedhelte. Pastaj e edukoi duke e ngjitur në majat e diturisë. Si njëri prej yjeve më të shkëlqyer të botës islame, Nafiu ishte një mevali.

Imam Adhami, Mesruku, Tavus b. Kejsan dhe sa e sa të tjerë qenë mevali. Madje, në kohë të emevive, dy dijetarë që, duke biseduar mes njëri-tjetrit, po përmendnin dhe numëronin dijetarët, vunë re se vetëm i pesëdhjetenjëti doli se s'ishte mevali.

Po qe se në ato pallate qenkëshin përgatitur njerëz të tillë dhe janë përgatitur, ejani të gjithë së bashku të heqim dorë nga liria, të përgatitemi atje si robër dhe pastaj ta rifitojmë lirinë.

Në të gjitha këto që treguan, nuk ka ndonjë pikë ku njeriu që është njeri mund të gjejë shkak për kritikë. Mjafton që të mos jetë i kufizuar e i detyruar pér të vepruar ndryshe!

25. A është i përshtatshëm Islami pér t'u dhënë zgjidhje të gjitha çështjeve?

Po, sepse ka mundësi dhe e mban premtimin. Një fjalë e thënë dje prej nesh, është si të pohohet sot nga çdokush. Perëndimi, me ndodhitë mashtruese gjithnjë të reja, është një argument i hapur i kësaj.

Kush mund ta njohë sistemin funksional të një fabrike më mirë se ai që e projektoi dhe e ndërtoi? Edhe pér mënyrën e përdorimit të aparatit më të vogël elektronik, i drejtuhemi pér këshillë dikujt që di. Kush të jetë krijuesi i njeriut, do të jetë ai që do të dijë më mirë mënyrën e jetesës së tij qoftë si individ, qoftë si shoqëri. Njeriun e ka krijuar Allahu. Pér pasojë, sistemi më i vlefshëm pér njeriun do të jetë sistemi i dërguar prej Tij.

Ky realitet sot pranohet prej të gjithëve, sepse të gjitha sistemet e propozuara nga njeriu, kanë falimentuar. Sukseset e përkohshme nuk u kanë mjaftuar pér t'u siguruar vazhdimësinë. Ja, nga sistemet njerëzore më të njohura të përshkruara nga historia si feudalizmi, kapitalizmi, socializmi dhe komunizmi, janë shembur e asgjësuar njëri pas tjetrit duke lënë pas vetes një sërë rënkimësh e klithmash. Kurse Islami ka arritur në ditët e sotme pa humbur asgjë nga baza e tij që nga dita e themelimit.

Perëndimi është i vetëdijshëm pér këtë realitet. Udhëzuesit dhe këshilltarët e dërguar prej nesh janë pritur e priten me miratim në shumë vende të botës perëndimore.

Auditoret kishtare janë shndërruar pothuajse në vende ku i shërbehet Islamit. Bota po i përgatitet përsëpari një marrëveshjeje Islame. Është mjaft i përhapur opinioni se problemeve të pazgjidhshme të sotme mund t'u jepet rrugë vetëm me Islamin.

Virtyt është ai që ta pohojë e pranojnë edhe armiqëtë. E ja, sot është arritur ai moment kur duket se edhe dushmanët, në deklaratat e tyre e kanë pranuar këtë të vërtetë. Sot në Europë ka shumë njerëz që e kanë pranuar Islamin por, pér shkak të dyshimit ndaj ambientit, nuk e shfaqin këtë gjë. Dhe shumica e tyre janë anëtarët e kishës.

Pastaj, pér t'u dhënë shembuj të identifikuar pyetjeve të tillë si kjo, duhen marrë e numëruar çështjet një e nga një e duhet treguar se si i ka zgjidhur Islami ato. Dhe kjo do të mund të bëhej vetëm me vepra prej disa vëllimesh. Sigurisht që është e pamundur brenda një intervali pyetje-përgjigjesh analiza e thelluar e një tematike të tillë. Veçanërisht ata duhet të tregojnë se cilën çështje nuk e zgjidhi

Islami që edhe ne t'i japim përgjigje asaj. Meqë pyetja u bë në përgjithësi, edhe përgjigja jonë do të jetë e përgjithshme. Në fakt, më shumë fjalë se kaq për përgjigjen e një çështjeje të pranuar në mënyrë të pakundërshtueshme prej të gjithëve, do të jenë të ngarkuara edhe me shpenzime, edhe me kotësira. Kurse Islami kurrë s'e pëlqen punën më shpenzim dhe kotësi.

26. Ç'është xhihadi? Flitet për xhihadin e madh e të vogël. A mund t'i përkufizoni dhe shpjegoni?

Xhihad është një fjalë arabe që do të thotë, në përgjithësi, *punë, zell, përpjekje duke përballuar çdo lloj pengese e vështirësie*. Por, bashkë me Islamin, kjo fjalë mori një kuptim krejt të veçantë e të përcaktuar: *lufthë në rrugën e Allahut*. Sot, kur thuhet xhihad, nënkuqtohet vetëm kjo.

Ashtu siç do të shpjegohet më tutje, sipas një shprehjeje që i dedikohet Profetit, xhihadi është ndarë në dy lloje: xhihadi i madh dhe xhihadi i vogël. Por ne, para se të kalojmë në trajtimin e kësaj ndarjeje, duam të qëndrojmë pak mbi rëndësinë e xhihadit.

Nuk ka detyrë më të madhe në botë se xhihadi. Po të kishte, me atë detyrë do t'i kishte ngarkuar Allahu profetët, të dërguarit e vet. Njerëzit e ngarkuar nga Zoti me këtë detyrë, janë më të nderuarit e njerëzve, kurse engjëjt që ua kanë sjellë dhe përcjellë atyre këtë detyrë, janë më të nderuarit e engjëeve. Para së gjithash, duhet menduar se robtë më të zgjedhur të Allahut, qofshin profetë ose të urtë e prijës, nga Hz. Ademi e gjer më sot, në masë të madhe kanë arritur të bëhen të tillë (të zgjedhurit e Allahut) nën hijen e shpatave dhe në sajë të vetëllogarisë.

Xhihadi është akti i arritjes së njeriut në esencën e vet ose akti për t'i bërë njerëzit e tjerë që të arrijnë në esencën e vet. Nga një aspekt, xhihadi është synimi final i krijimit të njeriut. Pikërisht për këtë, në lartësinë e Allahut, xhihadi është shumë i rëndësishëm dhe ka një vlerë shumë të çmuar e të shenjtë.

Mes njerëzve që rrinë të térhequr nga xhihadi pa pasur asnjë justifikim dhe njerëzve që bëjnë xhihad pa pushim, që e shpenzojnë jetën ose vdesin në xhihad, ka dallime shumë të thella, që është e pamundur të mbyllen me akte të tjera. Në ajetin kuranor që e shpreh këtë ide, thuhet kështu:

"Nga myslimanët, me përjashtim të atyre që janë të justifikuar, ata që rrinë nuk janë të barabartë me ata që bëjnë xhihad në rrugën e Allahut me mallrat dhe jetën e tyre. Ata që bëjnë xhihad me pasurinë dhe jetën e tyre, Allahu i bëri eprorë në nivel ndaj atyre që rrinë. Vërtet, Allahu u ka premiuar të gjithëve bukurira (xhenet), por muxhahidët (ata që bëjnë xhihad) i ka bërë eprorë ndaj atyre që rrinë, me një shpërbirim të madh!" (Nisa, 95)

Ai që lufton në rrugën e Allahut dhe ai që e bën rrugë të vetën tregimin dhe shpjegimin e kauzës së vet, në asnjë mënyrë s'mund të konsiderohen në të njëjtin nivel. Këtë mund ta sqarojmë me një shembull të thjeshtuar.

Profetësia është një dhuratë, një profesion, një detyrë e dhënë nga Allahu njerëzve të zgjedhur. Puna e tyre është të flasin për Allahun dhe ta kumtojnë fenë që kanë sjellë. Kjo detyrë është domosdoshmëri dhe kundërvlerë e detyrës profetike. Janë shumë lloje profesionesh dhe shumë detyra që i bën të domosdoshme një profesion i caktuar. Berberi, marangozi, këpucari, etj. kanë një

synim dhe qëllim që e kanë pranuar si pikë finale. Prandaj, vendin ku ndodhen e vlerësojnë sipas synimit dhe ashtu i japid vlerë. Në të njëjtën kohë, nuk duhet harruar se secili prej këtyre profesioneve bart nga një vlerë të caktuar sipas vlerës së rezultatit ku kërkojnë të arrijnë. Morën si shembull këtu profesione dhe detyra të thjeshta, por këto konkluzione qëndrojnë të tilla edhe për profesione dhe detyra të tjera më të larta, si, p.sh., për deputetin, kryeministrin apo presidentin. Edhe këta vlerësohen sipas pikës finale ku do të arrijnë si rezultat. Mendoni tani, ju, gjendjen e një njeriu sipas pikëfillimit dhe përfundimit në lidhje me diçka. Fillimi i njeriut është një pikë ujë (spermë) i ndyrë që, zakonisht, po të na bjerë mbi rroba, jemi të detyruar ta pastrojmë, kurse fundi, një kufomë e dënuar të qelbet. A s'janë këto fillimi dhe fundi i njeriut? Ja pra, pavarësisht nga profesioni, pika finale ku arrijnë njerëzit është kjo. Kurse profesioni i profetësisë nuk është aspak i tillë. Edhe ata kanë një ideal dhe një pikë finale të atij idealit. Vetëm se ajo nuk është, si te të tjerët, një pikë dekompozimi dhe qelbjeje. Synimi i paracakuar në profesionin profetik është ky: ta bëjnë të njobur Allahun, t'i japid mundësi njerëzimit që, duke e njobur Atë, ta arrijnë përjetësinë, ta bëjnë njeriun që, ndërsa kur vjen në këtë botë përvijon një grafik zbritës, të rikthehet duke përvjuar një grafik ngjitet për të arritur te Allahu, ta bëjnë njeriun të tregojë shfaqje përjetësie në këtë botë të vdekshme, të luajë me ngjyrat e kalimit nga e paqena në ekzistencë dhe, me mendimet e veta, të jetë një ylber që premton përjetësi. Ja pra, njeriu ka ardhur në këtë jetë si kandidat për një përjetësi të tillë dhe ata që e realizojnë tek njeriu këtë mendim, këtë ndjenjë dhe këtë të vërtetë të entitetit të tij, janë vetëm profetët të cilët bartin kuptimin e profetësisë dhe e çojnë në vend detyrën profetike.

Për rrjedhojë, profesioni i profetësisë është, për Allahun, profesioni më i pastër e më i shenjtë, prandaj dhe Allahu, pas Individualitetit Hyjnor, ka tërhequr vëmendjen mbi detyrën profetike. Ja pra, edhe detyra më e shenjtë e një profesioni të tillë të shenjtë, është xhihadi. Meqë çdo profesion vlerësohet sipas përfundimit dhe pikës ku do të arrijë dhe meqë gjëja që i jep vlerë atij profesioni është përfundimi që do të arrijë, atëherë edhe mënyra e veprimit si pretekst dhe mjet për të arritur te pika ku kërkon të arrijë ky profesion i shenjtë, do të jetë një punë e shenjtë po në atë nivel.

Gjithashtu, është në rëndësinë e xhihadit që gjendja e xhematit, bashkësisë që ka dhënë fjalën dhe besën për xhihad, përshkruhet kështu në Kur'an:

"Pa dyshim, ata që të japid besën ty, po ia japid Allahut. Dora e Allahut është mbi dorën e tyre. Kush e prish betimin, e prish për të keqe të vet. Dhe kush tregon besnikëri në fjalën e dhënë Allahut, do të marrë shpërblim të madh!" (Fet'h, 10)

Ngjarja që tregohet si shkak për zbritjen e këtij ajeti, është shkurtimisht kështu:

Profeti u kishte dhënë myslimanëve lajmin e mirë se do të shkonin në Mekë për ta bërë Qaben tavaf. Të gjithë ishin të emocionuar dhe të entuziazmuar. Kishte vite që digjeshin nga malli për këtë. Si të mos ndodhë kështu me ta, kur ne, madje, me një apo dy herë të vajtur atje, dashurohem pas atyre vendeve dhe digjemi nga malli për to?! Sepse Meka është vendlindja e Kryeprofetit, kurse vendi ku ndodhet Qabja, është vendbanimi i parë mbi tokë. Sipas shprehjes së Nafiut, Qabja është "vendi ku bëjnë tavaf të shenjtë". Është vendi ku bëjnë tavaf engjëjt dhe shenjtorët nga sipërfaqja e tokës gjer në sidretul munteha. Ja pra, myslimanët e prisnin me një dëshirë të papërmblajtur që të shkonin në atë vend ku ishin lindur dhe rritur, në atë vend që digjeshin nga dëshira për ta parë, që ta bënin Qaben tavaf dhe, pastaj të ktheheshin në Medine. Mirëpo kur arriten në Hudejbije, u përballën me një ngjarje krejt të papritur. Politeistët e Mekës shpallën se nuk do t'i lejonin myslimanët ta bënin Qaben tavaf dhe, po të këmbëngulnin, do të luftonin me ta. Kjo ngjarje e papritur u erdhi si një goditje shumë e rëndë myslimanëve. Askush nuk donte t'u besonte fjalëve që

dëgjonte. Një veprim të tillë ata e shihnin si një goditje kundër nderit të Islamit. Ndjenjat ishin fryrë, emocioni kishte arritur në pikën më të lartë dhe zemërimi kishte krijuar një tensionim të jashtëzakonshëm. Askush nuk ia vinte veshin tjetrit. Ja, mu në një situatë të tillë, Profeti i ftoi myslimanët t'i jepnin besën. Të gjithë e morën veten dhe u vunë në radhë t'i jepnin besën Profetit. Çdo sahabe i jepte fjalën Profetit se do t'i mbetej besnik gjer në fund, pavarësisht nga kushtet dhe propozimet. Kjo fjalë besnikërie dhe dhënia e besës Profetit me këtë kuptim, regjistroheshin në Kur'an dhe aty flitej për nivelin e afërsisë ndaj Zotit që fitonin myslimanët me këto veprime. Edhe kjo, gjithashtu, ishte një shfaqje tjetër e vlerës që i jepej xhihadit.

Në një ajet, thuhet kështu:

"Allahu ka blerë nga besimtarët mallrat dhe jetën e tyre me xhenet, sepse ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. Ky është një premtim i Allahut në Teurat, Ungjill dhe Kuran. Kush është ai që e sjell në vend fjalën e dhënë më shumë se Allahu? Atëherë, gëzohuni për këtë shkëmbim që keni bërë me Të! Ja, ky është shpëtimi i madh!" (Tevbe, 111)

Njerëzit që ia shesin Allahut frymën, trupin dhe pasurinë materiale, fitojnë si shpërblim xhenetin dhe pëlqimin e Zotit. Duke folur për këtë, Kurani përdor shprehjen "allishverish", "dhënë e marrë". Ky është një përfitim aq i madh sa e lartëson njeriun në nivelin e bashkëbiseduesit apo partnerit të Zotit.

Në një hadith, porosi të tij, Profeti thotë kështu: "Sa do të dëshiroja që, në rrugë të Allahut, të vritesha, pastaj të ringallesha, pastaj të vritesha, pastaj të ringallesha, ..." Kushedi sa herë do ta përsërishte këtë gjë Profeti po të mos pengohej nga përsëritja e fjalëve! Në fakt, esenciale është ideja e përjetësisë, gjë që do të thotë dëshira për t'u vrarë dhe për t'u ringjallur pastaj në jetën tjetër. Mendoni se këtë e kërkon Kryeprofeti. Vlerën e xhihadit ne e mësojmë vetëm nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. I Dërguari i Madh thotë: "Ai që qoftë edhe një ditë të vetme shërbën në rrugë të Allahut dhe për Allahun, në roje të rreziqeve me sy të pafjetur dhe që vrojton nga vendvroatimi një rrezik të mundshëm, do të thotë se ka bërë punën më të dobishme në botë!"

Vini re! Po qe se njeriu që vetëm një ditë rri në një të çarë të "mureve rrethuese" në roje të rreziqeve që mund t'i vijnë vendit nga jashtë dhe përpinqet ta mbyllë atë të çarë, thotë dhe betohet se ka bërë një punë më të dobishme se Qabja, nuk është gjenjeshtar. Sepse, kur thuhet "punën më të dobishme në botë", përfshihet edhe Qabja.

Në një hadith, porosi tjetër, Profeti thotë: "Çdo akt merr fund me vdekjen e njeriut, përveç veprimitarisë së atij që bën xhihad në rrugën e Allahut. Veprimitaria e tij jep fryte gjer në kiamet. Edhe në varr, Allahu e bën atë ta ndjejë veten të sigurt nga hetimi i varrit që është një intrigë dhe provë!"

Janë qindra ajete dhe hadithe që flasin mbi vlerat dhe rëndësinë e xhihadit. Por, meqë s'është kjo tema e bisedës sonë, po mjaftohemi me ato që thamë.

Xhjadi është përpjekja e njeriut për të arritur në esencën e vet duke përdorur forcat e veta, duke e sforuar veten dhe duke u vënë gjoksin gjërvave që e pengojnë rrjedhën e jetës. Ky quhet xhjadi i madh. Kurse përpjekja për t'i bërë të tjerët që të arrijnë në esencën e vet, quhet xhjadi i vogël.

Ndërsa po kthehej nga një luftë ku i ishte treguar vendi armikut dhe ku shpatat ishin ngjyer në të kuq me gjakun e armikut, Profeti u pati thënë shokëve: "Po kthehem nga xhjadi i vogël për në

xhihadin e madh!" Dhe pyetjes së shokëve se ç'ishte xhihadi i madh, u qe përgjigjur: "Lufta me vetveten".

Kjo shprehje përmban, në të vërtetë, dy fytyrat e një të vërtete. Në të dyja anët, ajo çka kërkohet është pastrimi i njerëzimit, purifikimi i tij, fitimi i gjendjes së kredituar para Allahut, prandaj dhe si xhihadi i madh, ashtu dhe i vogli, i shërbejnë bashkërisht të njëjtë qëllim.

Në fund të fundit, a nuk është ky shndërrim cilësor i njerëzimit qëllimi i dërgimit të profetëve? Kjo specifikë trajtohet kështu në Kuran: "*Me të vërtetë, nga mesi juaj ju dërguam një Resul (të dërguar, përfaqësues, profet) që t'ju lexojë ajetet tonë, t'ju pastrojë, t'ju sjellë librin dhe urtësinë e t'ju mësojë ato që s'dini!*" (Bakara, 151)

Profetët janë dërguar për t'ua hapur njerëzve perden e fytyrës dhe për t'u dhënë mundësi që t'i lexojnë ajetet e Zotit. Kështu, pengesat në zemrat e tyre do të shemben, mënyra e vështrimit ndaj materies dhe dukurive do të ndryshojë plotësisht. Ditët e kaluara nga njerëzit si të shurdhër e të verbër, në sajë të dritës së sjellë nga profetët, do të fitojnë kuptim dhe vlerë. Sigurisht, leximi dhe kuptimi i ajeteve (argumenteve) të krijimit vetëm me ata është bërë i mundur.

Është profeti ai që i pastron njerëzit dhe u jep mundësi të arrijnë esencën e vet. Sepse njerëzit kanë nevojë të përpunohen, ashtu si mineralet. Ata duhet të treten në një potë në mënyrë që të ndahen dhe pastrohen prej skorjeve. Pa dyshim, kjo është dhe cilësia e pëlqyer nga Zoti. Ndërkëq, arritja e kësaj gjendjeje është e mundur vetëm me orientimin e profetëve. Është krejt e pamundur që njeriu të arrijë cilësinë e arit apo argjendit të pastër pa hyrë e u tretur në potën e tyre.

Një cilësi tjeter që tërheq vëmendjen në ajet, është fakti që profeti do t'u mësojë njerëzve Librin dhe urtësinë. Nëse Libri është Kurani, dhe ashtu është, urtësia është diçka tjeter. Ajo është sunneti i Profetit.

Veç këtyre, profeti do t'u mësojë dhe praktikojë njerëzve gjërat që s'i kanë ditur gjer atëherë. Por këtu nuk u drejtohet vetëm njerëzve të asaj dite. Të gjithë njerëzit që do të vijnë gjer në kiamet do të mësojnë shumë gjëra nga profetët.

Në emër të jetës personale, rruget që çojnë në purifikimin e zemrës ne i mësojmë nga i dërguari i Allahut, profeti Muhamed. Shumë gjëra na ka mësuar ne Profeti. Në çdo fushë të jetës, njerëzimi ka mësuar prej tij shumë çështje për të cilat s'ia ka prerë dot mendja dhe edhe në të ardhmen, duke shpëtuar nga errësira e injorancës në sajë të dritës së sjellë prej tij, me shkallët e tij do t'u ngjitet majave të dijes, shkencës dhe teknikës.

Profesioni i profetësisë është profesioni që merr përsipër t'i kristalizojë njerëzit, t'i maturojë, t'i çojë në esencën e vet dhe t'i sjellë në gjendjen e pëlqyer nga Zoti dhe që ua lë të njëjtën barrë si trashëgim burrave të kauzës që vijnë pas tij. Dhe arritja e këtij rezultati është e mundur vetëm me anë të xhihadit.

Detyra e xhihadit ka të njëjtin kuptim me detyrën e dëshmimit të së vërtetës. Në gjykatë, për të përcaktuar se kush ka të drejtë, dëgjohen dëshmitarë, dëshmia e të cilëve merret parasysh gjatë marrjes së vendimit. Ja, pra, edhe ata që bëjnë xhihad, në gjyqin e mohuesve dëshmojnë kundër tyre me zë të lartë e të kthjellët duke thënë "Allahu ekziston"! Ajeti në vazhdim na e tregon këtë të vërtetë në të gjithë qartësinë e vet: "*Allahu, engjëjt dhe dijetarët e vendosur në drejtësi kanë dëshmuar se nuk ka zot tjetër veç Tij. Po, nuk ka zot tjetër veç Allahut, zotërueshit të fuqisë dhe urtësisë!*" (Al-i Imran, 18)

Allahu (xh.xh.) dëshmon për ekzistencën e vet. Atë e dëgjojnë vetëm ata që kanë arritur përsosmërinë e ndërgjegjes. Atë çka mund të dëgjojnë ata në ndërgjegjet, është e pamundur ta shprehin librat!

Edhe engjëjt janë dëshmitarë të ekzistencës së Allahut. Engjëjt janë krijuar nga një entitet i kulluar. Natyra e tyre është e papërzier, është krejt e kthjellët. Shejtani, djalli, nuk ka mundur t'u fusë brenda mohim dhe perversitet. Struktura e tyre origjinale nuk është prishur. Ata janë si pasqyrë; sapo të shohësh në ta, menjëherë duken shfaqjet e Zotit.

Edhe dijetarët dëshmojnë për ekzistencën e Zotit. Edhe sikur gjithë bota ta mohojnë Allahun, këto tre dëshmi janë të mjaftueshme për ta provuar ekzistencën e Tij!

Po, kështu është, sepse ne e dëgjojmë këtë të vërtetë me të gjithë lakuriqësinë dhe madhështinë e vet në ndërgjegjet tona. Dhe e dëgjojmë pa kërkuar asnjë provë tjetër. Kjo dëshmi është e mjaftueshme edhe për banorët e botës së lartë. Po qe se shurdhët dhe qorrat në tokë nuk e dëgjojnë dot zhurmën në gjithësi dhe nuk e kuptojnë dot artin hyjnor, për këtë mjafton dëshmia e dijetarëve.

Dëshmuesit e Allahut do të shkojnë gjer në vendet më të errëta dhe, në gjyqet e ngritura kundër mohimit të Allahut, do të bërtasin me gjithë zërin e tyre të kthjellët duke thënë: "Ne jemi dëshmuesit e Allahut!"

Ja pra, edhe profetët me cilësinë e tyre të lartë kanë ardhur për ta kryer këtë detyrë të lartë dëshmie!

"Dhe dërguam Ne profetë si përgëzues dhe paralajmërues që, pas tyre, njerëzit të mos kenë ndonjë pretekst kundër Allahut. Allahu është i denjë dhe i urtë. Allahu dëshmon për atë që të zbriti ty se e zbriti me diturinë e Tij. Edhe engjëjt dëshmojnë për këtë. Allahu mjafton si dëshmitar!" (Nisa, 165-166)

Brenda çdo kombi ka lindur një profet për t'ua ndriçuar mendjet. Epokat rrrotullohen krejt si toka dhe në çdo epokë shfaqet një profet si një trëndafil që çel. Çdo epokë që vjen, vjen si një kohë e errët dhe çdo profet e ndriçon kohën e vet. I fundit ka ardhur profeti ynë që i ka ndriçuar të gjitha kohërat. Allahu i bën zë kështu atij në Kuran: "*O i Dërguar! Pa dyshim, Ne të dërguam ty dëshmues, përgëzues dhe paralajmërues!*" (Fet'h, 8)

Ajeti në original është kështu: "*Inna erselname shahiden ve mubeshshiran ve nedhiran*". Me të vërtetë, ne të dërguam ty dëshmues dhe përgëzues dhe paralajmërues!⁵⁷

Profeti Muhamed është dërguar si dëshmues i ekzistencës së Allahut për njerëzimin. Pas tij është bashkësia e dëshmuesve të tjerë. Edhe ata do të dëshmojnë para gjithë njerëzimit se Allahu ekziston. Siç thotë hadithi, porosia profetike, në ditën e ringjalljes, dëshmia e bashkësisë së tij do t'i shpëtojë profetët e tjerë nga përgjegjësia.

Profeti është njeriu që i përgëzon besimtarët përrugën e mbarë, ndërkaq që i paralajmëron për pasojat e rruqës së keqe. Ja, pra, fryma e xhihadit është e fshehur në këtë të vërtetë. Dhe ja, për ta çuar në vend këtë detyrë të lartë janë dërguar profetët. Njëri pas tjetrit do të lindin si diej, do të ndriçojnë, pastaj do të perëndojnë dhe njerëzimi nuk do të shohë errësirë. Nuk do të mbetet asnjë ndërgjegje që të mos i jetë njoftuar e vërteta dhe nuk do të mbetet asnjë derë e asnjë dritare e

⁵⁷ Përshtatja e këtij paragrafi është e përkthyesit.

pahapur ndaj të vërtetës. E vërteta dhe e drejta do të hyjë në çdo shtëpi dhe çdo njeri do të përfitojë prej tyre.

Prandaj ndodh që pothuaj në mendjen e të gjithë njerëzve që kanë jetuar në periudhën nga profeti i parë gjer te i fundit si dhe që do të jetojnë gjer në kiamet, ka një ide sado të turbullt mbi profetësinë. Ç'është e vërteta, ata që kanë jetuar në periudhën e boshllékut midis dy profetëve, në përgjithësi kanë shkarë në rrugë të gabuar, në mendime dhe botëkuptime perverse. Megjithëkëtë, nuk ka mbetur shtëpi ku të mos ketë hyrë kuptimi i profetësisë si institucion. Edhe fryma dhe mendimi i xihadit që sot e bën të ndjehet veten hapur apo mbyllur në ndërgjegjetona, s'është gjë tjetër veç ndikimit të frymëmarrjeve të tyre të pastra, sepse çdo profet i ardhur pas tjetrit ia përkushtoi jetën rrugës së Allahut për ta përhapur të vërtetën duke u bërë me të madh e të vogël përfaqësuesi më i patëmetë i xihadit.

Xihad i vogël nuk është vetëm forma e xihadit e kryer në frontin e luftës me armë. Një botëkuptim i tillë e ngushton horizontin e xihadit. Kurse spektri i xihadit është i gjërë nga lindja në perëndim. Herë një fjalë, herë një e heshtur, herë vetëm një thartim ftyre, herë një buzëqeshje, herë largim nga ai kuvend ose pjesëmarrje vetëm në atë kuvend, shkurt, çdo veprim dashurie apo zemërimi i kryer për pëlgim të Zotit futet në këtë lloj xihadit. Gjithashtu, çdo përpjekje e nisur në një truall të tillë dhe e zhvilluar më tej në çdo fushë të jetës e në çdo pjesë të shoqërisë për përmirësimin e saj është xihad. Xihad i kryer në një kuadër të gjërë duke filluar nga familja, farefisi i afërt e i largët, fqinji dhe qyteti e duke u zgjatur e zgjeruar, kështu, në të gjithë botën, është xihad i vogël.

Në një kuptim, ky xihad është material. Kurse xihad i madh që e përbën frontin jomaterial (moralo-shpirteror), është xihad me vetveten, me botën e brendshme të njeriut. Kur kryhen që të dy krahas dhe menjëherë, ruhet ekuilibri. Në të kundërt, kur njëri nga këta të dy mbetet mangut ose mungan, ekuilibri te e vërteta prishet.

Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe xihadin e të dy formave ne e mësojmë nga i Dërguari i Allahut. Në fakt, ne ende nuk e kemi bërë dot filozofinë e biografisë së Profetit. Ai e përhapi të vërtetën dhe e kreu këtë detyrë në mënyrë sistematike duke e mbështetur mbi rregulla të zbatueshme gjer në kiamet. Në jetën e nderuar të Profetit nuk mund të vërehet as edhe një veprim i vetëm spontan i lënë në rrjedhën e vet. Ai ishte njeriu i planit dhe programit. Ndoshta nuk i sistemonte gjérat në linjën e kuptimit të njeriut të sotëm, por dukej sikur ecte mbi një vijë, mbi një sistem të përgatitur qysh më parë. Në fakt, kjo ishte një ndër provat dhe argumentet e profetësisë së tij. Në të njëjtën kohë, është edhe shembulli më i bukur i pajisjes me moralin e Allahut!

Në periudhat e para të profetësisë, Profeti i falte namazet vazhdimisht në Qabe. Jo vetëm përvlerën e namazit të falur atje. Me këtë, ndoshta ndiqte shumë qëllime. Ndoshta atë ditë kjo ishte rruga dhe mënyra e vetme për ta treguar të vërtetën dhe të drejtën.

Ai donte t'u tregonte ca gjëra të rinxve. Mirëpo ishte pothuaj e pamundur të shkonte pranë tyre e t'u fliste. Sepse tek të gjithë të rinxjtë shfaqeshin veprime të tepruara për shkak të pasioneve të rinisë. Po qe se i Dërguari i Allahut do të futej mes tyre, mund të përballej me shumë sjellje të papërshtatshme. Prandaj shkonte në Qabe për të treguar praktikisht lidhjen me Zotin. Kjo sjellje e tij ngallte kureshtje tek të rinxjtë. Shkonin dhe e pyesnin se çfarë bënte. Dhe atëherë ai gjente rastin t'u fliste për kauzën e tij. Prandaj Profeti parapëlqente të falte namaz në Qabe.

Ndërsa falte namaz, Profeti u nënshtrohej sulmeve të ndryshme. Kurse po të falej në shtëpi, asgjë prej këtyre s'do të ndodhë. Kjo do të thotë se pavarësisht nga të gjitha shqetësimet, falja e namazit atje kishte një kuptim. Sa herë e patën sulmuar, sa herë i patën hedhur sipër gjëra të ndyra dhe sa herë patën dashur ta vrisnin!

Një herë, Ebu Xehli pati shkuar në Qabe me një gur në dorë dhe njerëzve që e patën pyetur se ç'kërkonte të bënte, u qe përgjigjur se "kur Muhamedi të binte në sexhde, do ta qëllonte në kokë dhe do ta vriste". Pastaj, kur Profeti pati rënë në sexhde, Ebu Xehli pati ngritur dorën ta qëllonte, por dora i pati ngrirë në ajër, pati nisur të dridhej si ndër ethe dhe ftyra i qe zbardhur si gëlqere. Dhe kur e patën pyetur të pranishmit se ç'i kishte ndodhur, u qe përgjigjur se "mes tij dhe Muhamedit kishte hyrë një kuçedër që për pak sa s'e kishte gjelltitur"!

Një herë tjeter, Ukbe b. Ebi Muajt pati shkuar në Qabe kur Profeti po falte namaz dhe pati nisur t'ia shtrëngonte kokën me lidhësen e çallmës. Ndërkaq, Ebu Bekri që e kishte marrë vesh ç'po ndodhë, pati arritur në vendin e ngjarjes dhe e pati shpëtar Profetin nga ai kriminel. Ebu Bekri pati thënë: "A mos doni ta vrisni njeriun vetëm pse thotë që Zoti i tij është Allahu?" Kështu pati thënë edhe dikush shekuj më parë në kohën e profetit Musa kur këtij i qenë hedhur sipër për ta mbytur. Pastaj Kurani e pati bërë ajet këtë shprehje. Ebu Bekri nuk ishte i fortë fizikisht, por forca e besimit e bënte atë të pamposhtshëm!

Po të mos ishte mbrojtja e posaçme, Profeti mund të vritej në një nga sulmet që i bëheshin gjatë namazit dhe sexhdes. Por Allahu e pati siguruar mbrojtjen e tij. Profeti falte namaz në Qabe duke e marrë në sy vdekjen, gjë që do të thotë se veprimi i ij bartte një rëndësi jetësore.

Hz. Ebu Bekri pati bërë një strehë të posaçme para shtëpisë dhe aty këndonte Kur'an me zë të lartë. Shpejt, aty nisen të mblidheshin dëgjues vullnetarë që shtoheshin vazhdimisht, aq sa erdhë një ditë që politeistët zunë të shqetësoheshin. Por Ebu Bekri e dinte dhe besonte se vitaliteti i individit dhe i shoqërisë ishte i mundur vetëm me xhihad dhe se ata që e braktisin xhihadin ishin të dënuar të prisheshin e të merrnin erë. Në të njëjtën kohë, edhe hyrja nën mbrojtjen e Allahut bëhej e mundur duke ia vënë shpatullat fesë së Allahut. Këtë të vërtetë e shprehin ajetet si "Po ta ndihmoni ju fenë e Allahut, edhe Allahu ju ndihmon ju!" (Muhammed, 7)

Gjer nën ngritjen e qytet-shtetit të Medines, myslimanët përdorën si mënyrë xhihadi hixhretin, emigrimin për hir të besimit dhe fesë, por pasi u ngrit qytet-shteti i Medinës, në kushtet e reja, myslimanët duhej të përdornin një mënyrë tjetër xhihadi, lufta me armë.

Gjersa iu dha leja për të luftuar me armë, myslimanët bënë qëndresë pasive. Ana që sulmonte ishte vetëm ana e mohimit, kurse myslimanët ishin viktimat e tyre. Kështu vazhdoi edhe për njëfarë kohe pas hixhretit në Medine. Më në fund zbriti ajeti që u jepte leje myslimanëve për xhihadin material, në përgjithësi, dhe luftën e armatosur, në veçanti. Ajeti thoshte kështu:

"Myslimanëve që i ishin nënshtruar padrejtësisë dhe dhunës, iu dha leje për të luftuar. Nuk ka dyshim se Allahu ka mundësi t'i ndihmojë. Ata u përzunë nga vatani dhe shtëpitë vetëm pse thanë Allahu është Zoti ynë... Allahu ndihmon ata që i ndihmojnë fesë së Tij. Pa dyshim, Allahu është i plotfuqishëm!" (Haxh, 39-40)

Pas një kohe, leja për të luftuar u kthye në urdhër për të luftuar. Tashmë myslimanët ishin të detyruar të luftonin me shpata. Dhe, duke shkuar për nënë Bedër, myslimanët shkonin të gjëzuar e plot hare thuajse kishin marrë ftesë nga xheneti e po shkonin atje.

Kështu, çdo ditë që kalonte, fuqia e myslimanëve shtohej dhe fitoret e arritura dëgjoheshin në të gjitha fiset përreth. Ndërkaq, fitoret e myslimanëve i dëshpëronin mohuesit. Kështu ndodh edhe sot.

Xhihadi vazhdonte në formën e hallkave të një zinxhiri që ndjekin njëra-tjetrën dhe myslimanët e gjenin forcën dhe vitalitetin vazhdimisht në xhihad. Ata e dinin se atë minutë që ta braktisin xhihadin, do të vdisnin. Po, besimtari është si pema: mbetet e gjallë përsa kohë mund të japë fruta; kur të mos japë më fruta, do të thotë se ka vdekur!

Janë rrugë të ndryshme që çojnë te Allahu dhe numri i tyre është sa numri i frysmeve njerëzore, frysmeve të krijesave të Tij. Allahu i ndihmon ata që luftojnë në rrugën e Tij. Allahu ua nxjerr para atyre të gjitha rrugët e dobishme e të bekuara dhe i mbron nga të gjitha rrugët e të keqes.

Ruga e Allahut është Sirati Mustakim. Është rruga e drejtpeshimit dhe maturisë. Njeriu që zë rrugën e quajtur Sirati Mustakim, është i matur si në arsyetim, ndëshkim dhe epsh, ashtu dhe në xhihad dhe adhurim. Dhe kjo do të thotë që Allahu ta ketë orientuar atë njeri në rrugën e Tij!

Xhihadi i vogël është realizimi praktik i urdhavrave të fesë, është kryerja nga njeriu e asaj që pritet prej tij. Kurse xhihadi i madh është realizimi nga njeriu i veprimeve praktike në mënyrë të vetëdijshme, me sinqeritet dhe principialitet, duke luftuar vazhdimisht me vetveten. Shpallja e luftës kundër të gjitha ndjenjave dëmtuese dhe shkatërruese siurrejtja, përbuzja, smira, egoizmi, krenaria, vetëpëlqimi, respekti i posaçëm për vetveten, etj., është xhihadi më i vështirë, prandaj dhe është quajtur xhihadi i madh.

Ne e quajmë këtë edhe xhihad morallo-shpirtëror. Kjo është rruga e Profetit dhe e sahabeve, shokëve të tij. Ata bënë një jetë të lidhur ngushtë me Zotin. Ziqret dhe adhurimet e tyre ishin aq shumë, saqë ata që i shihnin, pandehnin se ata s'bën gjë tjetër veç adhurimit. Por çështja qëndronte krejt ndryshe, sepse ata e jetonin jetën si një të tërë.

Ata ishin shndërruar pothuaj në esencë dhe përmbledhje të sinqeritetit dhe principialitetit. Çdo punë që bën, e bën duke marrë për kriter pëllqimin e Allahut.

Ka ajete dhe hadithe që i marrin në konsideratë së bashku xhihadin e madh me xhihadin e vogël. E tillë është sureja "Nasr". Në këtë sure të shkurtër thuhet kështu: "Kur ta shohësh se erdhi ndihma e Allahut dhe se njerëzit po hyjnë tufa-tufa në fenë e Allahut, falenderoje Zotin tënd dhe kërko falje prej Tij, se Ai i pranon pendimet me të tepërt!"

Me të vërtetë, kur erdhi ndihma e Allahut dhe fitorja, njerëzit hynë tufa-tufa në fenë e Allahut. Në sajë të xhihadit të vogël, të urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes, si dhe në sajë të shpjegimit të së vërtetës, pengesat e mënjanuan, u asgjësuan dhe njerëzit filluan të hyjnë në fenë islame.

Për këtë arsy, ata që pandehin se bëjnë xhihad duke bërë dialektikë majtas e djathtas kinse për t'ua parashtruar çështjen njerëzve, ata që nuk e kontrollojnë se sa i zbatojnë ato që thonë, s'bëjnë gjë tjetër veçse vrasin kohën dhe gjenjejnë vetveten.

Si përfundim, temën mund ta përmbledhim kështu:

Nëse xhihadi i vogël dhe xhihadi i madh trajtohen veç e veç, në njërin ka vetëm llafazanëri, dialektikë dhe anarki, kurse në tjetrin, vetëm misticizëm, meskinitet, dembelizëm dhe përgjumësi.

Kurse xhihadi i vërtetë arrihet duke i ndërthurur të dy llojet e xhihadit. Ky është botëkuptimi mbi xhihadin i Profetit dhe i sahabeve, shokëve të tij.

Edhe te prijësit e mëdhenj e të vërtetë të përgatitur nga Islami, shihet e njëjta vetëdije xhihadi. Asnjëri prej tyre nuk e ka trajtuar xhihadin në mënyrë të njëanshme. Ata nuk e kanë lënë për asnjë çast përpjekjen për ta përhapur të vërtetën edhe kur janë ndodhur pas hekurave dhe i kanë kaluar edhe netët po aq të ndriçuara sa dhe ditët. Ata nuk e kanë zbehur kurrë lidhjen me Zotin, kurrë nuk e kanë lënë mënjanë zemrën, sado të gjerë ta kenë pasur shërbimin dhe detyrën. Kështu, Zoti është bërë për ta syri që u sheh dhe dora që u prek dhe kanë arritur, kështu, në mijëra duke e begatuar njëri-tjetrin.

Po qe se njeriu i sotëm dëshiron të bëjë një xhihad që do ta kënaqte Zotin, dhe kështu duhet të ndodhë, krahas shpjegimit dhe përhapjes së të vërtetës, duhet t'i marrë nën kontroll dëshirat e të kalojë në një vetëllogari serioze. Ndryshe, mundësia për vetëgënjim është shumë e madhe dhe gjërat që ka për të bërë s'do të kenë dobi as për veten e tij, as për të tjerët.

Njeriu i xhihadit duhet të jetë aq njeri i zemrës, i sinqertë dhe principal, sa ta parapëlqejë Allahun ndaj çdo gjëje tjetër. Atëherë, lufta dhe përpjekja e tij do të jenë të dobishme. Në vend që duke u bërë të tjerëve filozofi, t'u përcjellë një sërë informacionesh të padobishme, ai duhet të përpinqet të shtresojë ndër mendje dhe zemra sa të jetë e mundur më shumë sinqeritet, bonsens dhe vetëdijen për t'u bërë njeri i zemrës.

Xhihadi është një ekuilibër fitoreje të brendshme e të jashtme. Arritja e njeriut në esencën e vet është xhihad i madh. Kurse veprimi për t'i bërë të tjerët të arrijnë në esencën e vet është xhihad i vogël. Kur këto dy lloje xhihadesh të ndahen dhe veçohen nga njëri-tjetri, xhihadi del së qeni xhihad; në njërin lind meskinitet, kurse në tjetrin, anarki. Mirëpo ne presim lindjen e një shpirti muhamedan, gjë që, si kudo tjetër, është e mundur duke e ndjekur profetin Muhamed, të Dërguarin e Allahut!

Ç'lumturi për ata që, sa për shpëtimin e vet, kërkojnë rrugë edhe për shpëtimin e të tjerëve. Dhe ç'lumturi për ata që, duke u përpjekur për t'i shpëtuar të tjerët, nuk e harrojnë as veten!